

EUROPA

BOTIM I 'SHTËPIA E EUROPËS' & INSTITUTIT TE STUDIMEVE NDERKOMBETARE
VITI I GJASHTË I BOTIMIT NR. 18 / 2020



ADAM ZAGAJEWSKI — ALBA ÇELA — ASTRIT BEQIRAJ — CONSTANZE STELZENMÜLLER
CZESŁAW MIŁOSZ — FRANS TIMMERMANS — GENT SHKULLAKU — ISMAIL KADARE
IVAN KRASTEV — JACEK CZAPUTOWICZ — LEDION KRISAFI — ŁUKASZ KAMINSKI
OLGA TOKARCZUK — PRZEMYSŁAW GASZTOLD — SANDRO KNEZOVIC
VLADIMIR MEDJAK — WISŁAWA SZYMBORSKA — YLLI RAKIPI — ZBIGNIEW HERBERT

EUROPA

Speciale

<i>Jacek Çaputoviç</i>	5	Tek Polonia, Shqipëria ka një aleat të vendosur, një përkrahës të përkushtuar dhe një mik të vërtetë
<i>Ledion Krisafi</i>	11	Shqipëria dhe Polonia: Arritjet dhe potencialet
<i>Lukasz Kamiński</i>	17	Represioni komunist në Poloni
<i>Przemysław Gasztold</i>	20	Duke sfiduar totalitarizmin dhe komunizmin

Çfarë ndodh në qytet

<i>Alba Çela</i>	25	Hapja e negociatave - mos pretendoni ta injoroni listën e gjatë të kushteve!
	26	Një krizë tani, dhe një krizë më e gjatë që pritet të vijë
	28	Nga Republikë në lagje, një shoqëri në ikje
	29	Si të përmirësohet ekonomia? Gënjeshtrat nuk funksionojnë
	30	Qeveria shqiptare në Botën e Çudirave
<i>Albert Rakipi</i>	31	Shqipëria dhe Kosova: Nga Lufta e Ftohtë tek një agjendë strategjike

Europa

<i>Vladimir Medjak</i>	35	Metodologjia e re për çeljen e negociatave me Bashkimin Europian
<i>Sandro Knezović</i>	39	Presidenca europiane e Kroacisë: për një Europë influenciale
	42	Emmanuel Macron mbi pozicionin e brishtë të Europës në një botë armiqësore
	49	E dashur Europë
<i>Frans Timmermans</i>	52	Letra ime e dashurisë për Britaninë: marrëdhëniet familjare nuk mund të shkëputen
<i>Ivan Krastev</i>	54	Shtatë mësimet nga Koronavirusi
<i>Constanze Stelzenmüller</i>	56	Fantazmat e së shkuarës kërcënojnë të ardhmen e përbashkët të Europës

Letërsi dhe arte

	58	Poezi nga: Adam Zagajewski, Czesław Miłosz, Wisława Szymborska, Zbigniew Herbert
<i>Ismail Kadare</i>	59	Koha e shkrimeve
<i>Olga Tokarczuk</i>	70	Grazhdi në Bardo
<i>Ylli Rakipi</i>	78	Imitimi i një tjetër moshe

Në kopertinë: Foto nga Gent Shkullaku, pamje nga qendra e Tiranës gjatë izolimit të qytetarëve për shkak të COVID-19




Ministry
of Foreign Affairs
Republic of Poland

Botimi i këtij numri të revistës Europa u bë i mundur falë mbështetjes së Ministrisë së Jashtme të Polonisë. Përbajtja e botimit është përgjegjësi e plotë e Institutit të Studimeve Ndërkombëtare dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Ministrisë së Jashtme të Polonisë.

Identitete Shqiptare: Mite dhe histori

Stephanie Schwandner-Sievers dhe Bernd J. Fischer



BOTIM I **AİS**


aiis@aiis-albania.org

ISBN: 978-9928-195-33-3

Çmimi: 1200 lekë

Historia e Shqipërisë përshkohet nga mite dhe tregime mitologjike që shpesh iu shërbejnë qëllimeve politike, që nga përshkrimi i "themeluesit legjendar të kombit", Skënderbeut e deri te bëmat e UÇK-së në luftën e kohëve të fundit në Kosovë. Shkrimet, në librin Identitete shqiptare, nga një grup studiuesish të kombësive dhe disiplinave të ndryshme, si edhe nga specialistë jo-akademikë, zbërthejnë mitet mbizotëruese politike apo historiografike rreth të kaluarës dhe të tashmes së Shqipërisë, duke hedhur dritë mbi mënyrat se si mitet shqiptare kanë filluar të justifikojnë dhe të drejtojnë dhunën, të mbështesin pushtetin politik dhe të ushqejnë kohezionin e brendshëm. Libri Identitete Shqiptare fuqinë, që kanë akoma mitet edhe sot, pasi ato proceset politike dhe shoqërore në Shqipërinë pas-totalitare, të goditur nga kriza.





TEK POLONIA, SHQIPËRIA KA NJË ALEAT
TË VENDOSUR, NJË PËRKRAHËS TË
PËRKUSHTUAR DHE NJË MIK TË VËRTETË

*Intervista e Ministrit Jacek Çaputović për Europa nga Alba Çela,
Drejtoresha Ekzekutive e Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare*

TEK POLONIA, SHQIPËRIA KA NJË ALEAT TË VENDOSUR, NJË PËRKRAHËS TË PËRKUSHTUAR DHE NJË MIK TË VËRTETË

Polonia gjithmonë ka qenë mbështetëse e zgjerimit të Unionit, veçanërisht të integritit të Ballkanit Perëndimor. Cilat janë motivet e kësaj mbështetjeje dhe cili është vizioni i Polonisë për rajonin?

Qëkur Polonia u bashkua me Bashkimin European, përkatësisht në gjashtëmbëdhjetë vitet e fundit, ka qenë mbështetëse e politikës së zgjerimit që ne e vlerësojmë si një prej politikave më efektive për të dhënë rezultate të mira. Me këtë nënkuptoj jo vetëm efektin pozitiv që kanë fondet e BE mbi rritjen ekonomike dhe përmirësimin e standardeve të jetesës në vendet që janë bashkuar me BE-në, por gjithashtu aspektin gjeopolitik, përkatësisht zhvillimin e një zone të stabilitetit dhe begatisë në gjithë Europën. Në opinionin tonë, politika e zgjerimit është me rëndësi themelore për të ardhmen e BE-së. Për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë në Europë, BE duhet të vazhdojë me vendosmëri politikën e saj të zgjerimit dhe të mbështesë reformat në vendet e Ballkanit Perëndimor në mënyrë që ata të bëhen anëtarë të BE-së në të ardhmen. Politika e zgjerimit ka gjithashtu një ndikim të mirë në rritjen ekonomike të BE dhe vendeve kandidatë duke i lejuar ato t'i përgjigjen më mirë sfidave, si përmirësimi i nivelit të jetesës së njerëzve ose lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në dallim nga disa vende të tjera anëtare të BE, ne nuk jemi në dilemë për të mbështetur zgjerimin ose forcimin e BE. Zgjerimi i BE-së çon tek forcimi i saj dhe një perspektivë e qartë integrimi është faktori më i mirë shtytës për vendet kandidatë që të ndërmarin reforma. Për këto arsye, një proces i besueshëm zgjerimi është në interesin si të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ashtu dhe të gjithë Bashkimit European. Kështuqë është një situatë ku të dyja palët fitojnë. Rajoni i Ballkanit

Perëndimor është më rëndësi themelore për të forcuar sigurinë në sfondin e lëvizjeve migratore, terrorizmit, kërcënimeve hibride dhe kibernetike, ashtu si dhe të ndikimit destabilizues nga vende të treta.

Ne shpresojmë që shtetet anëtare të BE do të vendosin në favor të hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut gjatë takimit të marsit të Këshillit European.

Ka nga ata që thonë se arsyeja pse Ballkani Perëndimor duhet të bashkohet me BE-në është thjesht gjeopolitike: për të ndaluar aktorë të tjerë që të hyjnë dhe të mbushin hapësirën me ndikimin e tyre. A e ka dhe Polonia këtë pikëpamje?

Nuk mund të them që jemi pro kësaj qasjeje ndaj integritit të Ballkanit Perëndimor, megjithëse qartazi ne e kuptojmë se ky rajon për shkak të rëndësisë së tij potenciale dhe gjeopolitike shpesh ka qenë skena ku vende të treta si Rusia dhe Kina luftojnë për ndikim. Ne jemi të shqetësuar me rritjen e përfshirjes së aktorëve të jashtëm, veprimet e të cilëve shpesh kanë një ndikim shkatërrimtar. Në vend të krijimit të dialogut dhe konsensusit, ato çojnë në rritjen e dallimeve ekzistuese dhe përshkallëzimin e tensioneve.

Sidoqoftë, mbështetja jonë për perspektivën euro-atlantike të Ballkanit Perëndimor është e bazuar tek arsyet pozitive, të tilla si zhvillimi i zonës së demokracisë, sigurisë dhe begatisë në Europë për përfitimin e dyanshëm si të BE-së me vendet e saj anëtare ashtu dhe të Ballkanit Perëndimor. BE bëri një angazhim ndaj shoqërive të Ballkanit Perëndimor për të lejuar këto vende të bashkohen me BE. Tani BE duhet të përmbushë angazhimin. BE gjithashtu duhet të prekë më qartë



Tiranë, 7 maj 2018. Ministri Czaputowicz në Forumin Evropian të Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare duke ligjëruar mbi politikën e jashtme të Polonisë kundrejt Ballkanit Perëndimor, në kontekstin e të ardhmes së rajonit në BE.

problemet shoqërore-ekonomike në rajon, duke përfshirë dhe ngecjen në vend të dialogut Beograd-Prishtinë ose krizën e re politike në Bosnje dhe Hercegovinë të shkaktuar nga prirjet decentraliste. Për shkak të rritjes së propagandës dhe aktiviteteve dezinformuese prej disa vendeve, ne besojmë se BE duhet të forcojë komunikimin e saj strategjik dhe të informojë më mirë shoqëritë e Ballkanit Perëndimor rreth efekteve pozitive të projekteve të zbatuara dhe qëllimit të përfshirjes së BE-së.

Perspektiva e zgjerimit dhe metodologjia janë duke u debatuar dhe mund të ndryshohen. Cili është pozicioni i Polonisë për këto çështje? A janë diskutuar këto çështje gjatë debateve që janë zhvilluar në vendin tuaj?

Polonia mori pjesë në diskutimin për metodologjinë e zgjerimit edhe para se Komisioni të botonte *Komunikimin e tij të shkurtit 2020*. Bashkë me Austrinë dhe Italinë, ne paraqitëm vizionin tonë të riorganizimit të procesit të zgjerimit gjatë takimit të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme në Bruksel në dhjetor 2019. Republika Çeke, Lituania, Letonia, Estonia dhe Malta u bashkuan me ne. Shumë elementë të përvijuar në *non-paper*-in tonë u përfshinë më vonë në *Komunikimin e Komisionit*.

Ne e mirëpresim propozimin e Komisionit dhe besojmë se jep një bazë të mirë për marrëveshje. Ne pajtohemi që procesi i zgjerimit duhet të jetë më efektiv, më i besueshëm dhe më i parashikueshëm. Sidoqoftë,

disa propozime të paraqitura në Komunikim duhet të sqarohen para se të zbatohen. Gjithashtu, ende nuk është e qartë cilat vende do të preken nga metodologjia e re. Ato që tashmë i kanë filluar bisedimet do të jenë të lira të zgjedhin nëse duan ta pranojnë apo jo.

Ne gjithashtu besojmë se pranimi i metodologjisë së rishikuar të zgjerimit nuk duhet të vonojë vendimin për të hapur bisedimet me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ne e përfshimë këtë mendim në një letër që Polonia bashkë me katërmëdhjetë ministra të tjerë të jashtëm të BE-së i dërgoi Presidentit të Komisionit Evropian nëntorin e kaluar.

Cili është vizioni i Polonisë për Unionin, të ardhmen dhe rolin e tij në botë?

Pas bashkimit me BE-në në vitin 2004, anëtarësia jonë në BE ka qenë një forcë shtytëse për reformat e brendshme dhe zhvillimin e Polonisë. Ne dëshirojmë që BE-ja të jetë e hapur, transparente, e sigurt dhe e afërt me qytetarët. Vizioni jonë për BE-në bazohet mbi supozimin se ajo bashkon vendet që ndajnë të njëjtat vlera dhe histori. Për këtë arsye, vendi i Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë duhet të jetë në BE. Politika e zgjerimit sjell rezultate të prekshme – qëndrueshmëri, rritje ekonomike dhe mbrohtësi. Ne besojmë se një Union i përforcuar në këtë mënyrë, duke folur me një zë, ndërkohë që qartazi duke ruajtur ndjeshmërinë kombëtare dhe identitetin,

duke trajtuar njëllor dhe me ndershmëri të gjithë anëtarët e tij dhe duke gëzuar lidhje të forta ndëratlantike, mund të ketë rol në botë dhe të zgjerojë këtë zonë të jashtëzakonshme sigurie dhe mbrohtësie.

Franca dhe në veçanti Presidenti Makron kanë qenë të zëshëm duke i bërë thirrje BE-së të nisë një proces reformash me fokus sfondin gjeopolitik dhe global. Si i është përgjigjur Polonia kësaj thirrjeje?

Franca, ashtu si Polonia, dëshiron të kontribuojë aktivisht për të formësuar BE-në. Franca është një partner i rëndësishëm i yni dhe ne e vlerësojmë zërin e saj të fortë. Kishim një mundësi të diskutonim vizionet tona për të ardhmen e Europës gjatë vizitës së fundit të Presidentit Makron në Varshavë. Ne e ngritëm gjithashtu këtë çështje në takimet e Treshes së Vajmarit që bashkon Poloninë, Gjermaninë dhe Francën. Sot, vizione të ndryshme rreth formës së BE-së po përplasen në Europë. Polonia mbështet një Bashkim European të fortë që ka një ndikim të mirë mbi zonat e tij të afërta. Në këndvështrimin tonë, nuk është e mundur të ndërtohet një Union i tillë pa zhvillimin e një politike zgjerimi të besueshme dhe lidhje të forta ndëratlantike. Koha do tregojë se cila ide do dëshmojë si më e sakta.

Në vitet e fundit vëmendja dhe burimet e Varshavës që i dedikohen rajonit tonë, janë rritur ndjeshëm. Cilat janë interesat e përbashkëta që qëndrojnë pas kësaj rritjeje?

Në të vërtetë, Polonia kërkon të mbështesë vendet e rajonit jo vetëm në dimensione politike por gjithashtu përsa i përket teknologjisë dhe fondeve. Me Ballkanin Perëndimor ne ndajmë përvojat tona të procesit të tranzicionit të sistemeve dhe bisedimeve tona për anëtarësim në BE. Ky shkëmbim kryhet si pjesë e projekteve dypalëshe të tilla si Konferenca. Temat e konferencave zgjidhen nga partnerët tanë të Ballkanit Perëndimor dhe Ministria e Jashtme e Polonisë ka për detyrë të zgjedhë ekspertët e duhur nga institucionet polake.

Në 2015 nisëm të ashtuquajturën Akademi të Zgjerimit për zyrtarët nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Duke patur si fokus integrimin european, programi i tij përfshin luftën ndaj korrupsionit, politikën e mirëqenies, digitalizimin dhe bashkëpunimin rajonal.

Në 2017 nisëm një seminar rinor të përvitshëm të quajtur "Kujtesa, Kuptimi, e Ardhmja". Sipas këtij projekti, të rinj nga Ballkani Perëndimor, Polonia dhe Gjermania mësojnë rreth përvojave të pajtimit polako-gjerman që mund të frymëzojnë afrimin mes shoqërive

të Ballkanit Perëndimor. Nisma drejtohet nga Ministria e Jashtme Polake, fondacioni Kzhizhova për Ndërkuptimin në Europë, ambasada gjermane në Varshavë dhe përfaqësuesi rajonal i Komisionit European në Vrocau.

Për më tepër, administrata polake ka marrë pjesë në të ashtuquajturat projektet e binjakëzimit në Ballkanin Perëndimor që në 2004, më së shumti në fushën e infrastrukturës dhe fondeve të auditit publik – deri më tani janë përmbyllur 13 projekte dhe dy të tjera janë në zbatim. Vlera e përgjithshme e projekte me pjesëmarrje polake arrin në 18 milionë euro.

Në konferencën e donatorëve për Shqipërinë, të organizuar pas tërmetit tragjik, Polonia pramtoi 2.7 milionë euro për të mbështetur rindërtimin e infrastrukturës në Shqipëri, gjë që na vendos në grupin e dhuruesve më të mëdhenj.

Të gjitha këto projekte dhe nisma na kanë lejuar të forcojmë lidhjet e miqësisë së Polonisë me Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë dhe Shqipërinë.

Mbledhja e Poznanit ishte një ngjarje e shkëlqyer që vërtetë tregoi përkushtimin e Polonisë ndaj procesit të Berlinit. Si do e vazhdojë Polonia këtë proces dhe rezultat e pritshme?

Pa dyshim, presidenca polake e procesit të Berlinit na lejoi të forcojmë më tej marrëdhëniet tona me vendet e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë ne e udhëhoqëm presidencën në një kohë sfidash politike, si nga këndvështrimi i agjendës së Komisionit European (zgjedhjet në Parlamentin European, caktimi i Komisionit të ri European) ashtu si dhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor, falë programit të pasur të gjerë të presidencës dhe mbledhjes së Poznanit, ne arritëm të ruajmë interesin e BE-së për të përgatitur Ballkanin Perëndimor që të bashkohet me BE-në. Mbledhja bashkoi dhjetëra krerë qeveritarë, udhëheqës të institucioneve europiane dhe institucioneve financiare ndërkombëtare dhe disa dhjetëra ministra të jashtëm, të ekonomisë dhe të brendshëm nga vendet pjesëmarrëse në procesin e Berlinit. Agjenda e procesit të Berlinit nuk synonte të shmangte diskutimet rreth çështjeve të vështira dypalëshe ose rolin e shoqërisë civile dhe një qasje e tillë u prit mirë. Unë jam i bindur se presidenca polake vuri në dukje edhe më tej synimet e partnerëve të Ballkanit për t'u bashkuar me BE-në mbi një agjendë europiane.

Gjatë Mbledhjes së Ballkanit Perëndimor në Poznan, u lajmërua paketa tjetër e ndërlydhshmërisë në Ballkanin Perëndimor. U caktuan mbi 180 milionë euro për



të mbështetur projekte kyçe ndërlidhëse në rajon. Komisioni Europian nënshkroi një Letër Bashkëpunimi me institucionet financiare për të dhënë 20 milionë euro për të mbështetur sipërmarrjet e vogla dhe të mesme. Për më tepër, vendet e Europës jug-lindore nënshkruan një Memorandum duke krijuar një Institut rajonal për Teknologjitë e Qëndrueshme me qendër në Mal të Zi. Për më tepër, u lajmërua një plan për të përgatitur një strategji rajonale hekurudhore dhe drejtuesit e Ballkanit Perëndimor mbështetën deklaratën e integritimit të romëve.

Polonia gjithashtu dhuroi 1.5 milionë euro si mbështetje financiare për rajonin për projekte infrastrukturore në kuadër të Fondit të Investimit të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu dhamë fonde për Zyrën Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO), që punon për të mbështetur brezin e ri dhe institucionet luftuese të korrupsionit dhe tregtisë së paligjshme të armëve. Gjithashtu i ofruam bursa studentëve nga rajoni

për në Kolegjin e Europës në Natolin dhe e përfshimë rajonin në programet e bursave të dhëna nga Ministria Polake e Shkencave dhe Arsimit të Lartë. Programi Stefan Banah po pranon aplikime për bursa. Sipas këtij programi, studentët nga Ballkani Perëndimor mund të ndjekin studime me kohë të plotë në fushat e inxhinierisë, teknologjisë, bujqësisë, shkencave ekzakte dhe të jetës.

Ne përgatitëm dhe e drejtua presidencën tonë drejt vëmendjes ndaj nevojave dhe pritshmërive të partnerëve tanë ballkanikë. Përparësitë dhe programi i presidencës polake të procesit të Berlinit erdhi prej këshillimeve me vendet e Ballkanit Perëndimor. Presidenca u drejtua në frymën e partneritetit dhe përgjegjesisë së përbashkët të të gjithë anëtarëve të nismës rreth së ardhmes së rajonit. Ishte gjatë presidencës polake që u mor vendimi që kryesimi i radhës do të ndahej mes një vendi të BE-së dhe një vendi të Ballkanit Perëndimor. Jemi të lumtur që presidenca e përbashkët e Bullgarisë dhe e Maqedonisë

së Veriut çon përpara përparësitë dhe formatin polak.

Marrëdhëniet dypalëshe mes Shqipërisë dhe Polonisë po ecin përpara, megjithatë hapi i tyre mund të jetë më i shpejtë. Çfarë ide të reja dhe propozime mund të paraqiten në mënyrë që marrëdhënia të forcohet dhe zhvillohet më tej?

Polonia është aleate e Shqipërisë në NATO dhe një provomuese e vendosur e anëtarësimit në BE. Kur Shqipëria u godit nga një tërmet tragjik në nëntor 2019, ishte e qartë për ne që duhet të tregonim solidaritetin tonë dhe të ndihmonim shqiptarët. Mbështetja që premtuam gjatë konferencës së donatorëve për Shqipërinë të mbajtur javën e kaluar ishte një shprehje e miqësisë polako-shqiptare dhe një vazhdim i mbështetjes për Ballkanin Perëndimor dhe përfshirjes aktive të Polonisë në rajon.

Polonia dhe Shqipëria kanë bashkëpunim në shumë fusha. Në nivelin politik Polonia ndan përvojën e saj të periudhës së shndërrimeve dhe bisedimeve hyrëse përmes forumit të këshillimeve dypalëshe të cilësuar si konferenca e Tiranës. E fundit është mbajtur në shtator 2019 dhe u fokusua në politikën e kohezionit dhe bashkëpunimit territorial europian. Polonia është gjithashtu aktive në lidhje me bashkëpunimin binjakëzues. Në 2019, entitete publike polake fituan një tender me vlerë 1.3 milionë euro të quajtur *Forcimi i aftësisë së Autoritetit Rrugor Shqiptar për të zbatuar praktikën e mirëqeverisjes për planifikimin, kontrollin, prokurimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e investimeve rrugore*. Më herët (në 2016-2018), bashkë me Kroacinë, Polonia zbatoi një projekt binjakëzimi për forcimin e auditit të jashtëm në Shqipëri bashkë me Zyrën Kombëtare Shqiptare të Auditit.

Bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë gjithashtu po shkon mirë. Në gjysmën e dytë të këtij viti, Qendra e Studimeve Europiane në Universitetin e Varshavës do të hapë një degë kërkimi në Universitetin e Tiranës. Veprimtaria e kësaj njësie do të përfshijë gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe do të përfshijë dhe një kurs të gjuhës polake, do të nxisë bashkëpunimin mes Universitetit të Varshavës dhe institucioneve të tjera të larta arsimore polake me ato ballkanike.

Bashkëpunimi ekonomik luan një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet dypalëshe. Sidoqoftë, vëllimi tregtar rreth 90 milionë euro në vit, sigurisht që nuk është mbresëlënës dhe nuk i përmbush pritshmëritë tona. Gjithashtu, në fushën

e investimeve, ka shumë mundësi për rritje. Unë jam i bindur se bashkë me përparimin e Shqipërisë në rrugën e anëtarësimit europian, sipërmarrësit polakë do të jenë më të etur për të bërë biznes me partnerët e tyre shqiptarë.

Një fushë konkrete ku shohim shumë gjallëri është turizmi dhe numri në rritje i qytetarëve polakë që vizitojnë Shqipërinë. Çfarë duhet bërë në këtë fushë për të patur rezultate të qëndrueshme në marrëdhënien tonë?

Shqipëria është një destinacion turistik popullor për polakët. Ata e vlerësojnë bukurinë e natyrës së saj dhe mikpritjen e miqve. Shumica e turistëve zgjedhin qytetet bregdetare, por sidoqoftë, gjithmonë e më shumë po vendosin të zbulojnë pjesët malore të Shqipërisë. Në 2018, mbi 150 mijë turistë polakë vizituan Shqipërinë dhe pavarësisht një rënie prej 14% në 2019, polakët ende përbëjnë grupin më të madh të turistëve të huaj që vizitojnë Shqipërinë, duke përjashtuar diasporën shqiptare. Ne besojmë se edhe më shumë turistë polakë do të udhëtojnë për në Shqipëri në të ardhmen, gjë që do të lehtësohet duke vendosur fluturime të rregullta në linjën Varshavë-Tiranë nga kompania ajrore polake LOT. Fillimisht, në qershor të këtij viti, kompania do të nisë lidhjet e rregullta stinore që do të kryhen në verë. Sigurisht që do të jetë një alternativë e rëndësishme për të shkuar në Shqipëri, përveç udhëtimeve me charter dhe udhëtimit nga toka të zgjedhur nga shumë polakë.

Nëse do të hidhnin një vështrim prej selarti mbi Poloninë, tre dekada pas rënies së komunizmit dhe Perdes së Hekurt, si do ta përshkruanit pamjen e përgjithshme?

Tre dekada pas rënies së komunizmit, Polonia është një vend i ri, i lidhur fort pas strukturave europiane dhe ndëratlantike. Ne jemi i vetmi vend në Europë që kemi patur një rritje ekonomike të vazhdueshme për thujasë 30 vjet. Ne përfitojmë nga anëtarësia në Bashkimin Europian dhe bashkimi me NATO-n mbi 20 vjet më parë na lejoi të modernizojmë forcat tona të armatosura dhe të rrisnim sigurinë tonë. Polakët tani janë më të pasur, më mendjehapur dhe një komb më i mirëedukuar. Për më tepër, mbështetja e popullit polak për BE-në është një prej më të mëdhave ndër vendet anëtare. Polakët e vlerësojnë rëndësinë e saj për përparimin dhe mbrohtësinë e vendit tonë.

SHQIPËRIA DHE POLONIA: ARRITJET DHE POTENCIALET

LEDION KRISAFI

HYRJE

Gjeografikisht Shqipëria dhe Polonia janë shumë larg për të ndikuar drejtpërdrejtë njëra-tjetrën. Por në periudha të caktuara, interesa të përbashkëta ose një ideologji e përbashkët i ka lidhur. Kontaktet më të hershme ndërmjet shqiptarëve dhe polakëve janë në kohën e Skënderbeut, kur Vladislavi i Tretë, Mbret i Polonisë, i dërgoi një letër miqësie Skënderbeut.¹ Në shekujt e mëvonshëm, në Poloni u shkruan shumë libra rreth Skënderbeut dhe luftës shqiptare kundër Perandorisë Osmane. Ndër librat e parë të shkruar nga të huaj rreth Skënderbeut ishte libri *O Skanderbegu macedonie albaniskim ksqizçeciu*, nga Marçin Bielski, botuar në Krakovë në 1564. Bielski në kronikën e tij ka shkruar gjerësisht për Skënderbeun dhe shqiptarët duke u bazuar tek veprat e Marin Barletit nga Shkodra. Vepra e Barletit, *Historia et vita et gestis Scanderbegi Epirotarum*, botuar në Itali ndërmjet viteve 1508 dhe 1510, u përkthye në polonisht dhe u bë burim i punimit të Bielskit, por gjithashtu dhe për dhjetra libra të tjera rreth Skënderbeut botuar në polonisht në shekujt në vijim.

Në shekujt e mëvonshëm, ndërkohë që tokat shqiptare ishin pjesë e Perandorisë Osmane, interesimi i intelektualëve dhe udhëtarëve polakë ka qenë i vazhdueshëm, veçanërisht në shekujt XVIII dhe XIX. Ky interes ishte i përqëndruar më së shumti në popullatën katolike shqiptare në veri të vendit. Disa udhëtarë polakë vizituan dhe shkruan për këto zona. Marçin Çerminski ishte një prift katolik që vizitoi Shqipërinë e veriut në fund të shekullit të XIX, ndërkohë që ai territor ishte ende pjesë e Perandorisë Osmane dhe pak i njohur në qarqet intelektuale polake.² Çerminski shkruan rreth ndarjes mes gegëve dhe toskëve, rreth zakoneve tradicionale, fenomenit të gjakmarrjes në veri të Shqipërisë, traditës së Besës ndër shqiptarët dhe një

informacion të gjithanshëm rreth dioqezave katolike në atë pjesë të vendit. Çerminski gjithashtu kishte zhvilluar dhe një udhëtim tjetër të mëparshëm në tokat shqiptare në Vilajetin e Janinës në 1887.

Këto kontakte ndërmjet dy popujve ishin ende jo zyrtare, më shumë në pjesën e kureshtjes dhe marrjes së informacionit, për shkak se Polonia dhe Shqipëria ishin ende në Perandorinë Ruse dhe atë Osmane përkatësisht. Vetëm pas pavarësisë së Shqipërisë në 1912 dhe Polonisë në 1918, marrëdhëniet ndërmjet dy popujve morën një përmasë shtetërore. Qeveria shqiptare i dërgoi një notë qeverisë polake për njohjen e saj pas fundit të Konferencës së Paqes në Paris. Viti 1937 cilësohet si fillimi i marrëdhënieve zyrtare diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Polonisë, por Shqipëria në atë kohë mbulohej nga ambasadori polak në Athinë, Greqi, ndërkohë që shteti shqiptar nuk kishte mjetet financiare për të hapur një ambasadë në Varshavë.³

PERIUDHA KOMUNISTE

Pas fundit të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria dhe Polonia u gjendën në të njëjtin kamp ideologjik, të bashkuara nga ideologjia marksiste-leniniste, e frymëzuar dhe drejtuar nga Moska. Dallimi në këtë situatë ishte se Partia Komuniste Shqiptare erdhi në pushtet pa ndikimin ose ndihmën e drejtpërdrejtë të Moskës ose Ushtrisë së Kuqe, ndërkohë që në Poloni, udhëheqësi i ri komunist i detyrohej Moskës dhe Ushtrisë së Kuqe për pushtetin e tij. Kjo situatë e re ndërkombëtare e ndryshoi marrëdhënien ndërmjet Shqipërisë dhe Polonisë. Por në atë kohë, marrëdhëniet politike mes dy vendeve ishin ende të pakta. Për arsye financiare, Shqipëria përsëri nuk hapi një ambasadë në Varshavë, por ambasadori shqiptar në Moskë, Koço Tashko, ishin përgjegjës edhe për Poloninë.⁴ Gjithashtu në shtator 1947, në Szklarska Poreba, në jug-perëndim të Polonisë, nëntë

1 Tirana Times, Poland and Albania: Connected by the same spirit of freedom, May 5, 2017 <http://www.tiranatimes.com/?p=132285>

2 Marcin Czerminski, Shqipëria, përshkrime historike, etnografike, kulturore dhe fetare, Onufri 2014

3 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Marrëdhëniet Shqipëri-Poloni <https://punetejashtme.gov.al/marredheniet-dypaleshe/marredheniet-shqip%D1%91ri-poloni/>

4 Prof.as.dr. Genci Luarasi, Në përvjetorin e 80-të të lidhjes së marrëdhënieve Shqipëri-Poloni, 14 maj 2017, Gazeta Dita

parti komuniste evropiane themeluan Informbyronë, por Partia Komuniste Shqiptare nuk ishte ftuar, duke qenë e përfaqësuar nga Partia Komuniste Jugosllave.

Përveç dy marrëveshjeve ekonomike në 1949, në shkurt të po atij viti, Republika Popullore e Shqipërisë u bashkua me Këshillin e Ndhmën Ekonomike Reciproke (Comecon) të sapokrijuar, duke hyrë kështu në skemën shumëpalëshe të marrëdhënieve ekonomike të vendeve të Bllokut Komunist, të drejtuar nga Moska.

Në të njëjtën kohë, në 1948, gjatë debatit Tito-Stalin, në të cilin Shqipëria ishte një prej çështjeve kryesore, Partia e Punës së Polonisë mori anën e Moskës dhe rrjedhimisht atë të Shqipërisë kundër udhëheqjes jugosllave, duke qenë pjesë e nënshkruesve të rezolutës së Bukureshtit *“Në lidhje me situatën në Partinë Komuniste Jugosllave”*, në qershor 1948 duke dënuar Partinë Komuniste Jugosllave për ndjekjen e “një vijë të pasaktë mbi çështjet kryesore të politikës së brendshme dhe të jashtme, një vijë që paraqet shkoputje nga Marksizëm-Leninizmi”.⁵

Me dëbimin e Jugosllavisë dhe Partisë Komuniste Jugosllave nga Blloku Komunist, marrëdhëniet politike ndërmjet Shqipërisë dhe Polonisë, mund të zhvilloheshin në një nivel më të lartë. Në 1957, Musin Kroi u caktua ambasadori i parë shqiptar në Poloni. Në vitet e para pas kësaj ngjarjeje, pati një rritje të marrëdhënieve, veçanërisht në pjesën ekonomike. Në janar 1951, u nënshkrua një tjetër marrëveshje ekonomike, bashkë me një marrëveshje kredie për Shqipërinë në vlerën e 46 milionë rublave, prej të cilave 21.5 milionë u dhanë për pajisjen dhe shërbimin e transportit hekurudhor, 10.5 milionë për minierat dhe 14 milionë rubla për importin e të mirave dhe shërbimeve jo për investim. Polonia duhej të financonte një pjesë të planit pesëvjeçar të Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e industrisë. Falë kredisë polake, Shqipëria hapi miniera, ndërtoi një central elektrik, një fabrikë tekstili në Tiranë, një fabrikë sheqeri në Korçë dhe një rafineri naftë në rajonin e Elbasanit. Gjithashtu, në janar 1951 të dy vendet nënshkruan një marrëveshje pesëvjeçare për bashkëpunimin shkencor dhe teknik që përfshinte dërgimin e ekspertëve polakë, veçanërisht inxhinierëve, gjeodezistëve, në Shqipëri si këshilltarë. Bashkëpunimi i mëtejshëm ekonomik u rregullua përmes disa shkëmbimeve tregtare dhe marrëveshjeve pagese, krediti dhe huaje. Shqipëria ishte gjithashtu një pjesëmarrëse e rregullt e Panairit Ndërkombëtar të Tregtisë në Poznan.

⁵ Ivo Banac, *With Stalin against Tito*, 1988

Por marrëdhëniet ekonomike vareshin në një masë të madhe nga marrëdhëniet politike.

Shqipëria kundërshtoi kritikën ndaj kultit të Josif Stalinit në Kongresin e 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në 1956 dhe në 1961 zyrtarisht doli kundër deklaratës së këtij Kongresi rreth bashkëekzistencës paqësore të regjimeve të ndryshme, që u pasua me një shkoputje të marrëdhënieve politike dhe ekonomike me Moskën, duke mbyllur bazën ushtarake sovjetike në portin e Vlorës dhe përvetësuar nëndetëset sovjetike. Në konfliktin sovjeto-kinez, Shqipëria mori anën e Pekinit që çoi në rritje të ndihmës ekonomike kineze deri në vitin 1978, kur Kina filloi reformat për hapjen e tregut të saj.

Shkoputja sovjetiko-shqiptare u pasqyrua dhe në marrëdhëniet e Tiranës me Poloninë. Që nga viti 1961, shqiptarët në Poloni filluan të shfaqen gjithmonë e më rrallë, për shembull në 1965 me rastin e Kongresit Botëror të Unioneve të Punës, ku përsëritën kritikën e tyre kundrejt doktrinës së “bashkëekzistencës paqësore” dhe Bashkimit Sovjetik në përgjithësi dhe marrëdhëniet dypalëshe u kufizuan në shkëmbime tregtare dhe ngjarje sportive.

Pas krizës dypalëshe dhe shumëpalëshe, operatori kombëtar turistik i Polonisë anuloi të gjithë turet turistike në Shqipëri në verë të vitit 1961, pavarësisht se kishte vendosur një përfaqësues të përhershëm në Shqipëri si lehtësues turizmi. Në atë kohë, Shqipëria filloi t’i refuzonte qytetarëve polakë vizat e hyrjes.

Marrëdhëniet diplomatike në nivelin e ambasadorëve u vazhduan deri në 1966 dhe më pas, u ulën në nivelin e të ngarkuarve me punë. Përkundër vendeve të tjera komuniste si Hungaria, Bashkimi Sovjetik, Çekoslovakia, Polonia nuk i prishi menjëherë marrëdhëniet diplomatike. Në 1962, Polonia u bë vendi i parë nga Blloku Komunist që nënshkroi një marrëveshje të re ekonomike me Shqipërinë pas shkoputjes së vitit 1961.

Incidenti më i lartë në marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve ishte largimi nga Polonia në 1965 i ish anëtarit të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste Polake dhe ish Ministër i Ekonomisë Komunale, Kazimierz Mijal. Ai qëndroi në Shqipëri deri në vitin 1977, nga ku drejtoi gjithë veprimtarinë e tij politike kundër regjimit polak. Pas këtij incidenti, Polonia dëboi ambasadorin shqiptar Mihal Priti dhe qeveria shqiptare bëri të njëjtën gjë me ambasadorin polak në Tiranë, Stanislaw Rogulski.

Pas vdekjes së Enver Hoxhës në prill 1985, regjimi tashmë i drejtuar nga Ramiz Alia u përpoq të ndryshonte diçka në politikën e jashtme shqiptare, duke rritur nivelin



Presidenti Ilir Meta gjatë pritjes së Ministrit të Jashtëm të Polonisë, Jacek Czaputowicz në Shqipëri.

e marrëdhënieve me botën e jashtme, por në fund pak u ndryshua. Në 30 maj 1985, kombëtarja polake e futbollit luajti kundër Shqipërisë në Tiranë. Ata u shoqëruan nga një grup gazetarësh, që çoi në një numër të madh shkrimesh për Shqipërinë në shtypin polak.

Me rastin e përvjetorit të 40-të të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike në nëntor 1985, kryeministri polak Wojciech Jaruzelski i dërgoi një telegram Ramiz Alisë. Marrëdhëniet diplomatike u rivendosën në dhjetor 1990 dhe shkëmbimi i ambasadorëve u bë në 1992.

POLONIA DHE SHQIPËRIA NË PERIUdhËN POST-KOMUNISTE

Në vitet e fundit, Polonia është shqur si një prej ekonomive me rritjen më të shpejtë në Bashkimin Evropian. Me rritjen ekonomike dhe popullsinë e pestë më të madhe në BE, roli dhe pesha e Polonisë në çështjet e BE-së është rritur. Kjo gjë është pasqyruar në marrëdhëniet polako-shqiptare të viteve të fundit. Pas rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike në 1992, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Polonisë janë shumëfishuar. Në vitet 90-të, të dyja vendet ishin

në proces të konsolidimit të institucioneve të reja dhe zbatimit të reformave ekonomike. Polonia ishte veçanërisht vepruese gjatë luftës në Kosovë në 1999. Dërgoi në Shqipëri 140 ushtarë në kuadër të Forcës shqiptare të NATO-s (AFOR). Një mision mjekësor polak erdhi në prill 1999 dhe përfshinte 14 zjarrfikës nga Skuadra e Shpëtimit dhe Kërkimit në Nowy Sacz, 5 mjekë, një infermiere dhe një përkthyes si dhe 3 makina shpëtimi me pajisjet e duhura, ashtu si dhe ilaçe, fasho, pako të ndihmës së shpejtë, etj.

Misioni krijoi kampe refugjatësh në Laç dhe më vonë në Ndroq si dhe një spital fushor. Grupe lëvizëse gjithashtu po punonin në kampet e tjera, si në Mamurras, Shënkoll, Lezhë dhe Kater. Gjatë The Mission established refugee camps in Laç and later in Ndroq, and a field hospital. Mobile teams were also working in other refugee camps, in Mamurras, Shënkoll, Lezhë. Gjatë luftës në Kosovë, qeveria polake ofroi strehim për 1049 refugjatë Kosovarë, shumica shqiptarë, të cilët qëndruan në Cieplice dhe Przysieka. Pas fundit të konfliktit, grupi i fundit i tyre la Poloninë në 13 gusht 1999. Prania ushtarake polake në Shqipëri mori fund në shtator 1999.

Për momentin, marrëdhëniet ushtarake polako-shqiptare zhvillohen në kuadër të marrëveshjes së

bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes nënshkruar në Varshavë në 18 korrik, 2003, që hyri në fuqi në 30 maj 2004. Gjithashtu këto marrëdhënie zhvillohen edhe në kuadër të anëtarësisë së Shqipërisë dhe Polonisë në NATO. Polonia ishte gjithashtu një prej vendeve të para që ratifikoi Protokollin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO në vjeshtën e vitit 2009, duke pasuar nënshkrimin e Protokollit në 8 korrik të atij viti. Që nga viti 2009 Shqipëria dhe Polonia janë anëtare të NATO-s. Të dyja vendet kanë marrë pjesë në misione ushtarake në Afganistan, Irak dhe vende të tjera. Të dyja kanë mbajtur të njëjtat qëndrime kundrejt çështjeve të rëndësishme të sigurisë duke përfshirë dhe kërcënimin nga veprimtaritë ruse në Evropën Lindore dhe më gjerë.

Veçanërisht në vitet e fundit, Polonia është bërë një nga mbështetëset më të zëshme të Shqipërisë dhe veçanërisht të anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Kjo ka ecur krahë për krahë me rritjen e staturës ekonomike të Polonisë brenda BE-së. Polonia jo vetëm ka mbështetur vazhdimisht hapjen e negociatave me Shqipërinë pa asnjë kusht, por gjithashtu ka kritikuar Bashkimin Evropian për shtyrjen e negociatave, veçanërisht vendimet e verës dhe vjeshtës së 2019.⁶

Shqipëria dhe Polonia erdhën nga e njëjta përvojë komuniste dhe e njëjta periudhë tranzicioni në vitet 90-të drejt ekonomisë së tregut dhe institucioneve të reja. Polonia dhe vendet e tjera të Vishegradit, të gjitha vende ish komuniste me të njëjtat përvoja si Shqipëria, janë të vetëdijshme për rëndësinë që një proces i qartë integritit evropian ka mbi reformat dhe zhvillimin ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Për këtë arsye, në vitet e fundit këto vende janë bërë gjithmonë e më shumë mbështetëse të Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit. Gjithashtu, Polonia ka theksuar integritimin e Ballkanit Perëndimor dhe nga një këndvështrim strategjik, si çështje sigure dhe qëndrueshmërie e të gjithë kontinentit.⁷ Për shkak të historisë së saj, Polonia është e vetëdijshme për ndikimin shkatërrimtar që Rusia mund të ketë në Ballkan dhe një mungesë e perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor mund të jetë e rrezikshme për të gjithë kontinentin.

Në dy vitet e fundit marrëdhëniet politike mes Shqipërisë dhe Polonisë janë ngritur në një nivel më të

lartë pas visitës së kryeministres polake Beata Szydło në Tiranë në dhjetor 2016., pasuar nga vizita e Ministrit të Jashtëm të Polonisë në 2018. Në vitin 2014, Ministri i Jashtëm Shqiptar, Ditmir Bushati vizitoi Varshavën dhe nënshkroi një memorandum bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Polonisë për çështjet e integritit në BE.⁸ Polonia jo vetëm që po mbështet procesin integruar të Shqipërisë duke qenë një prej mbështetësve më të zëshëm për hapjen e negociatave me Shqipërisë, por gjithashtu po ofron përvojën e saj si një prej vendeve më të suksesshme.

MARRËDHËNIET EKONOMIKE

Shqipëria dhe Polonia vijnë nga e njëjta e kaluar komuniste me ekonomi të centralizuara, të cilat kaluan një proces privatizimi dhe hapjeje të tregut në tre dekadat e fundit, që nga rënia e regjimit komunist në të dy vendet. Në këtë periudhë, Polonia, për arsye të ndryshme, është zhvilluar më shumë ekonomikisht se Shqipëria, ku të ardhurat e saj për frymë janë rritur me 6% çdo vit në tre dekadat e fundit, duke u rritur shtatëfish në krahasim me momentin e rënies së komunizmit. Ky proces nuk ka ndodhur në Shqipëri. Gjithashtu, ekonomikisht Shqipëria është më shumë e prirur drejt Italisë dhe Greqisë, ndërkohë që Polonia drejt Gjermanisë dhe vendeve të tjera të Vishegradit. Këto dy aspekte e kanë kushtëzuar marrëdhënien ekonomike shqiptaro-polake.

Në katër vitet e fundit, tregtia mes dy vendeve është rritur në mënyrë të konsiderueshme, nga 48.4 milionë euro në 2014 në 73.4 milionë euro në 2018. Në këtë ndryshim, më mbresëlënëse kanë qenë eksportet shqiptare drejt Polonisë, të cilat janë rritur nga 7.7 milionë euro në 2014 në 17.1 milionë euro në 2018.⁹ Krahasuar me vitin 2017, ka patur një rritje prej 3 të eksporteve dhe 10% të importeve. Por në katër vitet e fundit, krahasuar me vitin 2014, ka patur një rritje prej 122% të eksporteve shqiptare drejt Polonisë dhe një rritje prej 38.2% të importeve nga Polonia.¹⁰

Struktura e shkëmbimeve tregtare mes Shqipërisë dhe Polonisë është e ndryshme për secilin vend. Tre mallrat kryesore më të eksportuara nga Polonia në Shqipëri janë duhani, që përbën 27% të të gjitha eksporteve Polake

6 Poland Criticizes EU For Postponing Accession Talks With Albania, North Macedonia, Radio Free Europe, July 05, 2019 <https://www.rferl.org/a/poland-criticizes-eu-for-postponing-accession-talks-with-albania-north-macedonia/30038958.html>

7 Ministry of Foreign Affairs Republic of Poland, Western Balkans, <https://www.gov.pl/web/diplomacy/western-balkans>

8 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Marrëdhëniet Shqipëri-Poloni <https://punetejashtme.gov.al/marredheniet-dypaleshe/marredheniet-shqip%D1%9Iri-poloni/>

9 Ministerstwa Przemysłu i Technologii, WSPÓLPRACA GOSPODARCZA Z ALBANIA,

10 Ibid

drejt Shqipëri në 2017; sheqeri me 6.1% dhe pelenat me 4.1. ndërkohë që eksportet e Shqipërisë për në Poloni janë këpucë, që përbëjnë pothuajse 30% të të gjitha eksporteve shqiptare drejt Polonisë në 2017; peshku dhe produktet e tij me 10.7% të eksporteve dhe malli i tretë më i eksportuar janë veshjet.

Siç tregojnë dhe shifrat e mësipërme, tregtia e Shqipërisë me Poloninë është shumë më e vogël se ajo me Italinë, Greqinë, Gjermaninë, Turqinë, Kosovën apo Serbinë. Në të njëjtën kohë, niveli i investimeve polake në Shqipëri është shumë i ulët, vetëm 600 mijë euro në 2017.¹¹

Rritja e viteve të fundit në tregtinë mes dy vendeve është ndihmuar nga politikat e të dy qeverive për të nxitur tregtinë. Një prej këtyre nismave është Forumi Ekonomik Shqipëri-Poloni, organizuar në Tiranë në dhjetor 2016, ku fokusi ishte tek investimet polake në Shqipëri, bashkëpunimi mes kompanive nga të dyja vendet dhe nënshkrimi i dy marrëveshjeve ekonomike në lidhje me bashkëpunimin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë me homologen e saj polake dhe një marrëveshje tjetër ndërmjet agjencive të investimeve.¹² Rritja e tregtisë dhe interesi i zhvillimit të mëtejshëm u konfirmua nga kryeministra polake Beata Szydło në visitën e saj zyrtare në Tiranë në dhjetor 2016.¹³

Më herët, në vitin 2007, Polonia dhe Shqipëria krijuan një Komision të Përbashkët Polako-Shqiptar për Bashkëpunimin Ekonomik, që u mbledh për herë të parë në dhjetor 2008 në Tiranë.

Gjatë atij takimi të parë, palët ranë dakord që bashkëpunimi ekonomik do të koordinohet nga Agjencia Polake për Zhvillimin e Sipërmarrjes dhe dhe marrja e përvojës së Polonisë në prodhimin e energjisë elektrike dhe shfrytëzimit të minierave ashtu si dhe bashkëpunimi shkencor dhe teknologjik në miniera dhe tubacionet e gazit.


Misioni i parë ekonomik polak me përfaqësues të 18 sipërmarrjeve vizitoi Tiranën dhe Durrësin në 7-8 qershor 2010 dhe mori pjesë në një seminar për të mësuar më shumë rreth aktivitetit ekonomik në Shqipëri. Sipërmarrjet polake gjithashtu u përfaqësuan në Panairin Ndërkombëtar KLIK EXPO në Tiranë në 25-30 nëntor 2010 me 21 biznese dhe në Ekspozitën Ushtarake Shqiptare organizuar në tetor 2010 me 11 biznese.

Për Poloninë këto zhvillimi hapin një panoramë të re në

11 Ibid.

12 Zhvillohet në Tiranë, forumi ekonomik Poloni-Shqipëri, <https://uccial.al/index.php/2016/12/09/zhvillohet-ne-tirane-forumi-ekonomik-poloni-shqiperi/>

13 Premierzy Polski i Albanii: bedziemy rozwijac i umacniac relacje pomiedzy Polska i Albania <https://www.tvp.info/35104884/premierzy-polski-i-albanii-bedziemy-rozwijac-i-umacniac-relacje-pomiedzy-polska-i-albania>



Perandori

Autori: RYSZARD KAPUŚCIŃSKI

Perandori, i përkthyer në mbi 32 gjuhë, është një nga 150 librat më të lexuar të shekullit të XX-të. Si portreti i një autokracie të ngurtësuar dhe ritualizuar, Perandori vështirë se mund të lëshohet nga dora dhe vështirë të harrohet.

Një Kapuściński vlen më shumë se një mijë shkruar qaramanë e fantazues. Gërshetimi i jashtëzakonshëm i gazetarisë dhe artit në veprat e tij na lejon të ndihemi më afër asaj që Kapuściński e quan pamjen e vërtetë të pashprehshme të luftës.

marrëdhëniet me Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor në përgjithësi. Për shkak të ekonomisë së saj në rritje dhe peshës në Bashkimin Evropian, Polonia po përpiqet të diversifikojë marrëdhëniet dhe intereset e saj ekonomike.

Por ende ka problem. Pavarësisht marrëveshjeve dhe memorandumeve të bashkëpunimit, shkëmbimet tregtare mes dy vendeve janë ende të ulëta krahasuar me potencialin që ekziston nga të dyja vendet. Veçanërisht eksportet shqiptare në Poloni janë shumë të ulëta, megjithëse në rritje në dy vitet e fundit. Mallrat bujqësorë, për të cilat Shqipëria për shkak të pozicionit gjeografik dhe klimës, ka avantazh krahasues, mund të jenë një prej fushave me potencialin më të madh për të rritur tregtinë mes dy vendeve, që deri më tani nuk është shfrytëzuar shumë.

Në të njëjtën kohë, investimet polake në Shqipëri janë ende shumë të vogla, pavarësisht interesit të treguar nga kompani polake dhe potencialit që ekziston, veçanërisht në fushën e energjisë. Për shembull, në vitin 2016 nuk kishte asnjë investim polak në Shqipëri. Disa prej arsyeve

për këtë situatë janë mungesa e njohurisë për situatën ekonomike në Shqipëri, sistemi i taksave, largësia gjeografike dhe mënyrat e ndryshme të të bërit biznes në Shqipëri dhe Poloni.

Kjo situatë mund të krahasohet me tregtinë e Polonisë me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut, dy vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor si Shqipëria. Tregtia e Polonisë me Serbinë në 2018 ishte 1.2 miliardë euro¹⁴, krahasuar me 73.4 milionë euro me Shqipërinë, ndërkohë që me Maqedoninë e Veriut ishte pak më shumë se ajo me Shqipërinë.

MARRËDHËNIET KULTURORE DHE TURIZMI

Marrëdhëniet kulturore kanë qenë të rëndësishme që nga lidhjet e para ndërmjet shqiptarëve dhe polakëve në Mesjetë. Ky interes ka qenë më shumë i njëanshëm, më shumë nga Polonia drejt Shqipërisë se sa e kundërta. Dhe në shekujt XIX dhe XX, gjatë udhëtimeve në Shqipëri, udhëtarët polakë kanë shkruar rreth etnografisë dhe çështjeve gjuhësore në lidhje me shqiptarët dhe gjuhën shqiptare. Në shekullin e XX-të, një prej albanologëve kryesorë në botë ishte polaku Waclaw Cimochoowski (1912-1982), i përkushtuar në kërkime për gjuhën shqipe. Ndër të tjera, ai shkroi një vepër të rëndësishme mbi pozicionin gjuhësor të ilirishtes ballkanike brenda gjuhëve indo-evropiane. Një tjetër albanolog polak ishte Waldemar Jan Dział, profesor në Universitetin e Gdanskut dhe Institutin e Studimeve Politike në Akademinë e Shkencave të Polonisë, i cili ndër të tjera shkroi një liber mbi politikën e jashtme të Shqipërisë së pas-luftës, me titull "Shqipëria ndërmjet Beogradit, Moskës dhe Pekinit, 1948-1978" dhe botuar në 1989.

Në të njëjtën kohë, shkrimtarët polakë kanë qenë vazhdimisht të pranishëm në tregun shqiptar të librit. Disa libra nga Ryszard Kapuscinski janë përkthyer në shqip, si "Imperium", "Udhëtime me Herodotin" dhe "Perandori". Poezia e fitueses së çmimit Nobel Wislawa Szymborska është përkthyer dhe vlerësuar gjerësisht ashtu siç ka qenë rastin me nobelistin tjetër Czeslaw Milosz, libri i të cilit "Mendja e mbërthyer" ka kaluar në disa botime në shqip. Nobelistja e re Olga Tokarczuk gjithashtu ka qenë e pranishme në gjuhën shqipe edhe para fitimit të çmimit Nobel ashtu si dhe poeti më i madh polak Adam Mickiewicz me përkthimet e Lasgush Poradecit dhe Ismail Kadaresë¹⁵.

14 Ministerstwa Przedsiębiorczości i Technologii, Serbia, Informacja na temat współpracy gospodarczej z Polska

15 Ben Andoni, Shqipëria dhe letërsia polake, Revista Europa, Nr. 4, 2014

Në vitet e fundit disa prej romaneve të Ismail Kadaresë janë përkthyer në polonisht ashtu siç janë përkthyer dhe vepra nga Fatos Kongoli, Fatos Arapi, Ylljet Aliçka dhe autorë shqiptarë nga Kosova¹⁶.

Një prej ndryshimeve më të mëdha në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Polonisë në vitet e fundit, ka qenë turizmi polak në Shqipëri. Në 2018 numri i turistëve polakë ishte 153 mijë, duke u rritur me 34% nga 2017¹⁷. Por megjithëse ka përjetuar një rënie prej 14% në vitin 2019, mbetet ende i lartë.¹⁸

Kjo rritje e interesit të turistëve polakë për Shqipëri është bërë e mundur dhe nga fluturimet e drejtpërdrejta nga Krakova, Varshava dhe Katowice drejt Tiranës.

PËRFUNDIME

Shqipëria dhe Polonia vazhdimisht kanë patur marrëdhënie të mira në tre dekadat e fundit që nga rënia e regjimeve komuniste në vendet përkatëse. Fakti që të dyja vendet vijnë nga e njëjta e shkuar komuniste dhe kanë kaluar nëpër të njëjtën periudhë tranzicioni drejt ekonomisë së tregut në vitet 90-të, shërben veçanërisht për Shqipërinë si një shembull për t'u ndjekur. Për më tepër, Shqipëria dhe Polonia si vende anëtare të NATO-s ndajnë të njëjtat =konsiderata strategjike dhe të njëjtat kërcënime brenda Aleancës. Gjithashtu Polonia është një prej mbështetësve kryesorë të integritit evropian të Shqipëri si një mënyrë për të siguruar dhe stabilizuar rajonin, por gjithashtu dhe për shkak të përvojës së saj, procesi i integritit në BE është shtytës e konsiderueshme për reforma, zhvillim ekonomik dhe institucione të qëndrueshme. Edhe në këtë këndvështrim, Polonia mund të shërbejë si model për Shqipërinë.

Megjithëse në nivelin politik marrëdhëniet janë më të mirat e mundshme, në pjesën ekonomike tregtia mes dy vendeve është ende shumë e ulët, megjithëse në rritje. Polonia duhet të nxisë kërkesën për mallra shqiptare, veçanërisht ato bujqësore, por dhe për naftë dhe minerale, ndërkohë që Shqipëria duhet të jetë më shumë mikëpritëse për investimet polake. Dy vendet duhet të punojnë më shumë për të zbatuar shumë marrëveshjet ekonomike të nënshkruar mes tyre, në mënyrë që të nxisin rritjen e tregtisë dhe investimeve. Mjetet e duhura për ta bërë këtë tashmë janë.

16 Po aty.

17 INSTAT, Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Dhjetor 2018

18 INSTAT, Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Tetor 2019

REPRESIONI KOMUNIST NË POLONI

ŁUKASZ KAMIŃSKI

Polakët, ngjashëm me kombet e tjera në Rusi, u shënjestruan nga persekutimi komunist thujse që në ditët e para të grushtit të shtetit Bolshevik. Pas përfundimit të luftës polako-bolshevike dhe nënshkrimit të Paqes së Rigës (1921), banorët e territoreve polake të para Copëtimit u lejuan të riktheheshin në Poloni. Mbi 1.1 milionë njerëz e shtrytëzuan këtë rast, por po aq ngelën në Bashkimin Sovjetik. Ata u shtypën ngjashëm me qytetarët e tjerë – u burgosën dhe u dërguan në kampet e punës, u shpronësuan dhe u deportuan. Sidoqoftë, nuk mund të jepet një numër i saktë i polakëve të persekutuar.

Kjo gjë është e mundur vetëm në rastin e të ashtuquajturit “operacioni polak” i NKVD-së, zhvilluar në vitet 1937-38. Gjatë tij rreth 140 mijë polakë u arrestuan, prej të cilëve 111 mijë u ekzekutuan, të tjerët u dërguan në kampet e Gulagut. Në të njëjtën kohë, rreth 50 mijë njerëz u zhvendosën në Siberi dhe Kazakistan gjatë deportimeve massive. Ishte një shenjë e fatit që i priste polakët nën pushtimin sovjetik.

Në 23 gusht 1939, Joahim fon Ribentrop dhe Vjaçesllav Molotov nënshkruan traktatin e mossulmit ndërmjet Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik. Aneksi i tij secret e ndante territorin e Polonisë dhe të disa vendeve të tjera të Evropës Qëndore ndërmjet dy aleatëve të rinj. Ishte hapi i fundit drejt Luftës së Dytë Botërore. Në shtator 1939 gjermanët dhe sovjetikët bashkërisht sulmuan Poloninë.

52% e territorit dhe thujse 40% e popullsisë ishin nën pushtimin sovjetik. Krimi i Katinit u bë simbol i masakrave të kryera nga komunistët sovjetikë. Duke u bazuar në një vendim të vetëm të Byrosë Politike të 5 marsit 1940, thujse 22 mijë njerëz u vranë me një të qëlluar në kokë – të burgosur luftime, roje burgu dhe kufiri, oficerë policie, të burgosur politikë. Ndërmjet tyre ishin mijëra përfaqësues të elitës polake – shkencëtarë, artistë, avokatë, mësues, priftërinj të të gjitha feve. Shtypjet nuk u kufizuan me këtë krim – 330 mijë njerëz u deportuan për në Lindje, dhjetra mijëra u dërguan në Gulag. Pas fillimit të luftës sovjetogjermane në qershor 1941, NKVD-ja vrau të paktën 10 mijë të burgosur që nuk mundën t'i zhvendosnin.

Varret a tyre të vrarë në Katin u zbuluan në 1943. Fakti

që qeveria polake në megrim i kërkoi Komitetit të Kryqit të Kyq të hetonte ishte një arsye për Stalinin që të shkëpuste të gjitha marrëditet diplomatike të rivendosura në 1941. Në këtë mënyrë ai kishte lirinë e plotë për të vendosur një të ardhme komuniste për Poloninë. Ushtria e Kuqe hyri në territorin polak në janar 1944. Menjëherë më pas filloi arrestimi i anëtarëve të rezistencës polake. Edhe ushtarët e Ushtrisë së Brendshme të cilën luftuan krah për krah me sovjetikët gjatë çlirimit të Vilniusit dhe Lvvit në korrik 1941, u arrestuan ose internuan. Këto veprime u vazhduan dhe në muajt pasues. Gjithsej më shumë se 40 mijë ushtarë të rezistencës polake u dërguan në kampet e Bashkimit Sovjetik deri në 1945.

Stalini filloi ndërtimin e qeverisë komuniste vetëm pas kalimit të lumit Bug (që në vizionin e tij përbente kufirin e ri lindor të Polonisë). Në korrik 1944 një thujse-qeveri u krijua në Moskë, Komiteti Polak i Çlirimit Kombëtar. Përfshinte një oficer të sigurisë publike që ishte fara e aparatit të sigurisë komuniste. Bashkë me propagandën dhe ushtrinë një prej shtyllave mbajtëse të sundimit komunist deri në 1989. Aparati më i gjerë shtypës përfshinte gjithashtu shërbimet e fshehta ushtarake (në 10 vitet e para të drejtuara nga oficerë sovjetikë) dhe gjyqet ushtarake. Këto të fundit dënuan me vdekje disa qindra kundërshtarë të regjimit vetëm në gjysmën e dytë të 1944 dhe deri në vitin 1956 ishin dhënë 8 mijë dënime me vdekje, duke përfshirë dhe mbi 5 mijë për arsye politike.

Aparati sovjetik i sigurisë, duke përfshirë një divizion të tërë trupash të NKVD, veproi haptazi në territorin polak deri në 1947. 50-60 mijë njerëz u morën nga Pomerania dhe Silezia për punë të detyruar në BS. Gjatë Konferencës së Jaltës, gjatë së cilës ndryshimi i kufijve polakë u miratua sipas kërkesave të Stalinit, u mor gjithashtu vendimi dhe për krijimin e një qeverie të re. Ato vendime u kundërshtuan nga qeveria polake në mërgim, megjithatë udhëheqësit e rezistencës polake, pavarësisht qortimit të Jaltës, treguan gatishmëri për të biseduar për krijimin e një qeverie të re. Por përkundrazi ata u arrestuan, u dërguan në Moskë dhe u dënuan me akuza fallce. Tre prej tyre, duke përfshirë dhe zëvendës kryeministrin dhe delegatin për Poloninë, Jan. S. Jankovski dhe komandantin e Ushtrisë së Brendshme, gjeneral Leopold Okulicki, vdiqën në burg. Sidoqoftë,

krimi më i madh sovejtik për luftës ishte operacioni gjigand i NKVD dhe Ushtrisë së Kuqe, “arrestimet e Augustovit” (korrik 1945). Shtatë mijë njerëz të dyshuar për bashkëpunim me rezistencën u arrestuan, 600 prej tyre u vranë në një vend ende të panjohur.

Në përgjithësi vendosja e regjimit komunist në Poloni mori rreth 50 mijë jetë: të vrarë në luftime dhe gjatë vendosjes së rregullit, të vrarë gjatë hetimeve, të vdekur në kampe dhe burgje. Numri i përgjithshëm i njerëzve të shtypur është i panjohur, për shkak të shkatërrimit të dokumenteve. Vetëm të dhëna pjesore njihen – gjatë periudhës së kolektivizimit mbi gjysmë milion bujq u dënuan me ndëshime të ndryshme (nga gjobot tek arrestimet, burgosjet dhe kampet e punës). Vetëm Komisioni për Luftën ndaj Abuzimit dhe Sabotimit ekonomik, i krijuar në fund të 1945, dërgoi më shumë se 84 mijë persona në kampet e punës, megjithatë numri i vërtetë i të burgosurve ishte më i lartë meqë kampet u mbushën gjithashtu me ata të dënuar nga gjyqet. Llogaritet se numri i përgjithshëm i të ndaluarve ishte deri në 350 mijë. Për më tepër, 200 mijë të rinj me biografi të “keqe” u çuan në punë të detyruar (më së shumti në miniera) gjatë shërbimit ushtarak. Të dhënat e 5.4 milionë polakëve (një e katërta e popullsisë!) të dyshuar për arsye të ndryshme, u mbajtën në arkivat e Ministrisë së Sigurisë Publike.

Terrori u qetësua pas ndryshimeve të 1956, megjithatë në qershor një rebelim në Poznan u shtyp me gjak – 58 të vrarë, qindar të plagosur. The terror lightened after the changes of 1956, however still in June a riot in Pozna was bloodily suppressed – 58 were killed, hundreds wounded. Në vitet në vijim u kryen shumë më pak dënime se sa gjatë periudhës staliniste, megjithatë qindra njerëz u dënuan për vitet për arsye politike. Ata ishin anëtarë të organizatave të vogla sociale, pjesëtarë protestash, mbrojtës të lirisë fetare ashtu si dhe intelektualë që kundërshtonin regjimin. Në 1963, partizani i fundit i lëvizjes anti-komuniste – Jozef Françak – u vra. Gjatë revoltave rinore të marsit 1968, 2500 njerëz u arrestuan, disa qindar u burgosën. Rebelimi i dhjetorit 1970 u shtypu me 45 të vdekur dhe mbi 1100 të plagosur.

Vitet në vazhdim ishin ndër më të ashprit në historinë e pas luftës në Poloni. Numri i të burgosurve politikë ra në disa dhjetra në vit dhe forma të tjera shtypjeje u pakësuan. Vala e re e persekutimeve erdhi pas grevave dhe protestave të qershorit 1976. 586 njerëz u dënuan me ndëshkime nga disa muaj në 10 vjet burg. Shkalla e shtypjeve ishte shtytëse për një organizata të reja shoqërore. Më në fund, vala e grevave të gushtit 1980



përfundoi me krijimin e të vetë-qeverisurës unionit tregtar “Solidariteti”.

Autoritetet komuniste u përgjigjën në dhjetor 1981 duke vendosur ligjin e ushtarak. Gjatë tij dhe më pas, të paktën 56 njerëz u vranë, më së shumti gjatë kontrollit të grevave dhe protestave dhe për shkak të vrasjeve (duke përfshirë dhe vrasjen e at Jezhi Popieushkos, tashmë i bekuar nga Kisha Katolike). Tre priftërinjtë efundit që mbështesnin opozitën u vranë në 1989. Thuajse 10 mijë njerëz u internuan, 11 mijë u dënuan me burg (deri në gjysmëne parë të vitit 1983), dhjetra mijëra u arrestuan për periudha të ndryshme. Spastrime pati në shumë komunitete.

Siç mund të shihet, shtypja shoqëroi sistemin komunist në Poloni që nga fillimi deri në fund. U kryen mijëra krime. Për fat të keq, shumica e atyre nuk janë



Demonstrues të Lëvizjes Solidarność (Solidariteti) në Poloni, në 1989.

ndëshkuar apo trajtuar. Përpjekja e pare u bë që në 1989. Pas zgjedhjeve pjesërisht të lira, Kuvendi krijoi të ashtuquajturin Komisioni Rokita (i emëruar nga kryetari i tij), që u ngarkua me detyrën për të hetuar vrasjet e viteve 80-të. Pavarësisht pengesave të vazhdueshme në rrugën e tij nga Ministrina e Punëve të Brendshme, ende e kontrolluar nga komunistët, në 88 raste materialet e mbledhura iu dërguan prokurorisë. Vetëm disa prej tyre arritën në gjyq, me gjyqet që zgjatën deri në 15 vjet dhe dënimet në shumicën e rasteve ishin të pakënaqshme për familjet e viktimave.

Në vitin 1991 hyri një kategori e re në sistemin ligjor – “krim stalinist”. Lejoi ndjekjen e keqbërësve nga 1939 në 1956. Për pasojë, akuzat për 100 kriminelë u dërguan në gjykatë dhe dënimet arritën deri në 10 vjet burgim.

Pakënaqësia në rritje me procesin e përballjes me të shkuarën shkaktoi krijimin e Institutit të Kujtesës Kombëtare – Komisioni për Ndjekjen e Krimeve kundër kombit polak në vitin 2000. Në të njëjtën kohë, u krijua një përcaktim zyrtar i krimeve të komunizmit, duke lejuar ndjekjen penale të krimeve të kryera deri në vitin 1989. Si pasojë. Aktet penale kundër më shumë se 500 njerëzve u çuan në gjykatë, i fundit në janar 2020. Shumë më shumë raste u hetuan, por shpesh të akuzuarit kishin vdekur tashmë (para se të ishte bërë akti i ndjekjes, gjysma të dyshuarve vdiqën), gjithashtu mungojnë dhe dëshmitë.

Në krahasim me nurmin e krimeve, numri i kriminelëve të dënuar mbetet i vogël. Sidoqoftë, është mirë të kujtohet që në Poloni, pas Gjermanisë, janë dënuar më shumë se kudo tjetër nga vendet ish komuniste.

DUKE SFIDUAR TOTALITARIZMIN DHE KOMUNIZMIN

Instituti Polak i Përkujtesës Kombëtare

PRZEMYSŁAW GASZTOLD

Komunizmi u rrëzua paqësisht në Poloni, pa u shtënë as edhe një plumb i vetëm. Ndonëse kishte protesta nëpër rrugë, përlëshje me milicinë, deri dhe vrasje ende të pazgjidhura të tre priftërinjve në 1989, rënia nga pushteti e Partisë Polake të Punëtorëve të Bashkuar përfshinte një proces të gjatë, rrënjët e së cilit mund të gjurmoheshin deri në fillim-vitet '80, kur zbatohet Ligji Martial dhe ushtria përdorej prej Komunistëve për të mbrojtur pushtetin e tyre. Polonia u bë zyrtarisht një vend demokratik, i bazuar në shtetin ligjor vetëm pasi frazat e ideologjisë Marksiste-Leniniste u hoqën prej Kushtetutës në ditët e fundit të dhjetorit 1989. Periudha e tranzicionit nga Komunizmi në demokraci, megjithëkëtë, solli sfida të reja shoqërore, politike dhe ekonomike. Për më tepër, Republika e Polonisë, rishtazi e themeluar, u desh të mbështetej në kuadro të vjetra në shumë fusha të administratës shtetërore, sektorit të sigurisë dhe politikës së jashtme. Kishte ende mjaft nëpunës civilë që i përkisnin partisë së Punës ose që ishin trajnuar prej Bashkimit Sovjetik. Kundërshtarët e mëparshëm që iu bashkuan politikës dhe mbështetën partitë e pas-Solidaritetit, nisën të ngrenë pyetje mbi përgjegjshmërinë e shtetit demokratik për të gjykuar të shkuarën komuniste, për të nderuar viktimat dhe heronjtë e luftës kundër Komunizmit. Nga ana tjetër, ata argumentonin se autorët e krimeve komuniste duhet të dalin para drejtësisë dhe të ndëshkohen. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme për të afërmit dhe familjet e viktimave të vrara gjatë regjimit komunist. Funkionarët e organeve të sigurimit ose zyrtarë të ushtrisë, ishin përgjegjës për shembull, për vdekjen e 9 punëtorëve nga miniera "Wujek", të vrarë në fazat fillestare të Ligjit Martial në 1981. Shembuj të tillë zgjuan debatin mbi nevojën për të themeluar një institucion të posaçëm, i cili do të hulumtonte thellësisht dhe do të nxirrte në dritë të shkuarën komuniste.

Instituti i Përkujtesës Kombëtare – Komisioni për Ndjekjen Penale të Krimeve kundër Popullit Polak u themelua nga Parlamenti polak më 18 dhjetor 1998. Megjithatë, Instituti e filloi punën në mes të vitit 2000, kur u zgjodh nga Parlamenti dhe Presidenti i parë i IPK. Që prej asaj kohe, u kthye në institucionin më të madh në botë i cili trajton historinë bashkëkohore dhe në vecanti, periudhën e Luftës së Ftohtë. IPK numëron më shumë se 2400 punonjës dhe buxheti i tij vjetor është afërsisht 98 milion euro. Instituti ndahet në 7 njësi kryesore: Komisionin e Lartë të Ndjekjes Penale të Krimeve të kryera kundër Popullit Polak; Arkivin e Institutit të Përkujtesës Kombëtare; Zyrën për Përkujtimin e Luftës dhe Zyrën e Vetingut; Zyrën e Kërkimit dhe Identifikimit; Zyrën Kombëtare të Edukimit dhe Zyrën e Hulumtimit Historik.

Komisioni i Lartë i Ndjekjes Penale të Krimeve të kryera kundër Popullit Polak është përgjegjës për të hetuar krimet e kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe gjatë periudhës komuniste. Ndonëse shumë prej autorëve të krimeve naziste janë ndarë nga jeta tashmë, prokurorët kryejnë hetime duke u përqendruar në shkeljen e ligjit dhe të drejtave të njeriut të kryera në Republikën Popullore Polake, kryesisht nga funksionarë të organit të sigurimit.

Arkivi i Institutit të Përkujtesës Kombëtare përbën bërthamën e IPK. Para së gjithash, Arkivi është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e 90 kilometrave dokumentave arkivorë në Varshavë dhe në 10 qytete të tjera ku IPK ka degët e saj. Së dyti, dokumentat që janë në pronësi të IPK janë vërtetë unike, sepse në bazë të vendimit të qeverisë, të gjitha dokumentat që dilnin nga organi i sigurisë ishin të deklasifikuara. Kjo nënkupton që çdo dokument i inteligjencias dhe kundërzbulimit nga shërbimet civile dhe ushtarake janë tashmë të hapura për hulumtuesit.

Dokumentat operativë, stacionet e spiunimit, bashkëpunuesit sekretë, dosjet e personelit të organit të sigurimit, asetet e huaja të rekrutuara nga inteligjencia – këto janë vetëm disa prej shembujve të dokumentave të cilët janë lehtësisht të aksesueshëm për këdo që dëshiron të hulumtojë. Këto lloj të dhënash janë ende



Ceremonia e përkujtimit të krimeve të kryera kundër polakëve në vitet 1937-1938 më 11 gusht 2018 në Varshavë

të klasifikuara në vendet Perëndimore dhe ish-Sovjetike, me fare pak përjashtime në Europën Lindore, duke e bërë kështu Arkivin e IPK unik në rang global. Hapja e dosjeve të organit të sigurimit rezultoi të ishte mjaft e volitshme për hulumtimet historike, në vecanti në studimin e natyrës totalitare të shteteve komuniste, ose si një burim i rëndësishëm për të zbërthyer detajet e jetës së përditshme nën stalinizëm.

Zyra për Përkujtimin e Luftës dhe Therorisë është kryesisht përgjegjëse për “vendet e memories” për shembull vendet ku veteranët ose ushtarët polakë janë varrosur. Kjo zyrë është ngarkuar gjithashtu dhe për fshirjen e të gjitha “mbetjeve” të ideologjisë komuniste në sferën publike, si p.sh. emrat e rrugëve që përkujtojnë figura komuniste, monumentet apo pllakatat përkujtimore.

Zyra për Kërkimin dhe Identifikimin synon të gjejë vendvarrimet anonime të ushtarëve polakë dhe heronjve të rezistencës së armatosur anti-komuniste. Ata kanë qenë të persekutuar, të torturuar dhe trupat e tyre shpeshherë janë vendosur në varre masive. Zyra nëmerr gërmime, zhvarrosje dhe përdor teknologji të fjalës së fundit për analizimin e kampionëve të ADN me qëllim identifikimin e heronjve polakë që kanë humbur jetën në luftën e tyre për liri. Punime të tilla kryhen dhe jashtë shtetit, si për shembull në Lituani dhe në Ukraini.

Zyra e Vetingut u krijua për të verifikuar nëse politikanët që garojnë në zgjedhjet e përgjithshme apo locale kanë bashkëpunëtore secret në organit të sigurimit. Ata duhet të nënshkruajnë një deklaratë që të vërtetojnë nëse kanë bashkëpunuar apo jo me policinë komuniste. Zyra e Vetingut verifikon këto deklarata duke i krahasuar ato me burimet arkivore. Nëse dikush rezulton të ketë gënjer në formularin e vetë-deklarimit, gjykata vendos nëse ai person do ta humbasë postin e tij në administratën shtetërore.

Zyra Kombëtare e Edukimit dhe Zyra e Hulumtimit Historik janë të dyja përgjegjëse për hulumtimin shkencor dhe edukimin. Pavarësisht se IPK ka më shumë se 2400 punëtorë, ka mesatarisht 140 historianë që punojnë aty si hulumtues me kohë të plotë. Ata zhvillojnë projekte hulumtimore locale dhe qendrore, si për shembull, duke u fokusuar në luftën anti-komuniste të rezistencës së armatosur nga 1944 deri më 1963, duke shqyrtuar shtypjet komuniste kundër Kishës Katolike Polake, ose duke zbërthyer aktivitetet që kryeshin nga organi i sigurimit.

Që prej themelimit, IPK ka luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimit të komunizmit nga rinia. Instituti ka kryer një punë të pamasë në promovimin e heronjve të harruar polakë nga Lufta e Dytë Botërore, si p.sh. Witold Pilecki i cili shkoi vullnetarisht në kampin



e përqendrimit Aushvitz, organizoi një rrjet të fshehtë rezistence aty, raporto i mbi Holokaustin, por pas Luftës u arrestua dhe u vra nga komunistët. IPK ka nxjerrë në dritë dhe njaft shembuj të tjerë të akteve guximtare, për shembull duke kujtuar shkallën dhe qëllimin e protestive anti-komuniste të cilat kulminuan gjatë të ashtuquajturve “Muajt Polakë” në 1956, 1968, 1970, 1976 dhe në 1980 që cuan në lindjen e “Solidaritit”.


Të dyja zyrat bashkëpunojnë ngushtësisht me mësuesit e shkollave të cilët duan të thellojnë njohuritë e tyre mbi historinë e regjimit komunist në Poloni. Mësuesit mund të bashkëpunojnë me IPK në bazë vullnetare. Instituti organizon konferenca, punëtori dhe ekspozita për nxënësit, studentët dhe mësuesit nga Polonia dhe nga jashtë shtetit. Pjesëmarrja në këto evente është gjithmonë pa pagesë. Gjithashtu, IPK furnizon mësuesit me materiale plotësuese: libra, broshura educative për skenare të ndryshme historike ose postera. Për më tepër, Instituti ka botuar tashmë disa libra udhëzues mbi historinë polake të cilat mund të përdoren si materiale plotësuese nga mësuesit dhe studentët të cilët duan të zgjerojnë horizontin e tyre.

Meqenëse shumë prej studentëve përdorin smartphone dhe janë të lidhur me internetin, IPK i kushton një rëndësi të vecantë botës digjitale. Instituti jo vetëm promovon historinë në platforma të ndryshme (YouTube, Facebook, Twitter) por gjithashtu përdor dhe median sociale për

të shpërndarë njohuritë mbi historinë në mënyrë më të thjeshtuar. Një prej aktiviteteve më të famshme të zbatuara nga IPK konsiston në shpikjen e lojërave të tavolinës si një mjet për të promovuar historinë e komunizmit dhe totalitarizmit. Në këtë kuadër, IPK përgatiti lojën e memories “1939” ku lojtarët duhet të mbajnë mend imazhet më të rëndësishme të pushtimit gjerman të Polonisë në 1939. Loja tjetër “Njih Simbolin” (*Znaj Znak*) synon të përkujtojë simbolet më të rëndësishme polake, emblemat dhe shenjat nga shekulli XX, si për shembull emblemën e lëvizjes underground të Luftës së Dytë Botërore, apo simbole të organizatave të ndryshme anti-komuniste. “Rradha” (*Kolejka*) është loja më e famshme e IPK e cila ka fituar dhe cmime ndërkombëtare, u përkthye në disa gjuhë dhe u kthye në bestseller mes njaft lojërave komerciale të tavolinës. Ideja e lojës ishte të njohë lojtarët me kufizimet e ekonomisë së planifikuar. Të gjitha lojërat e tavolinës kanë një prezantim të vecantë historic që shpjegon kontekstin dhe ofron dhe literaturë plotësuese. Shumë prej lojërave të prodhuara nga IPK, librat, vëllimet e redaktuara, albumet apo revistat janë tashmë Online dhe mund të shkarkohen lehtësisht.

Që nga themelimi, IPK u bë një institucion shumë i rëndësishëm shtetëror i cili jo vetëm që formëson debatin historik në Poloni, por që ka filluar një fushatë shumë të gjerë dhe efektive në zgjerimin e njohurive mbi historinë polake.

Daniel Serwer



NGA LUFTA TE PAQJA NË BALLKAN, NË LINDJEN E MESME DHE NË UKRAINË

BOTIM I **Aiis**

aiis@aiis-albania.org

ISBN: 978-9928-195-32-6

Çmimi: 1000 lekë

Përse dhe si u nda Ballkani dhe çfarë bënë Shtetet e Bashkuara, Europa, Kombet e Bashkuara dhe organizatat ndërkombëtare për ta bashkuar rajonin, është një pyetje shumë e rëndësishme, që s'mund të injorohet. Dyshimet rreth asaj që është bërë janë të shumta, por rajoni duket qartë se sot gjendet në një formë më të mirë se sa në vitet 1990. Kuptimi i Ballkanit mund të na tregojë se çfarë duhet të bëjmë tjetër dhe ta ndihmojmë rajonin për të kuptuar historinë e vet, me synimin për të shmangur një shpërthim në të ardhmen. Marrëveshja e Dejtonit i dha fund luftës në Bosnjë në vitin 1995, Lufta e Kosovës mbaroi në vitin 1999 dhe konflikti i armatosur në Maqedoninë e Veriut përfundoi në vitin 2001. Tani është koha t'i peshojmë gjërat me kujdes.

Ky libër synon të analizojë luftërat e njëpasnjëshme në Jugosllavi pas vitit 1989 dhe më pas vendosjen e paqes në vitet 1990 dhe 2000 deri në ditët e sotme.



BOTIM I **Aiis**

aiis@aiis-albania.org

ISBN: 978-9928-195-29-6

Çmimi: 1000 lekë

LUFTA E SHQIPTARËVE NË BOTËN E VJETËR DHE TË RE na jep një përmbledhje interesante dhe me vlerë të katër dekadave të para të jetës së komunitetit shqiptaro-amerikan në Shtetin e Masaçusetsit. Ky komunitet, që ishte i përqendruar në Boston, ishte nga vendbanimet e para të shqiptarëve në Shtetet e Bashkuara dhe ishte komuniteti më i madh dhe më i rëndësishëm i tyre në fillim të shekullit të njëzetë dhe deri në fund të viteve 1960. Në të vërtetë, aty nga viti 1914, Bostoni ishte kryeqyteti i padiskutueshëm i kolonisë shqiptaro-amerikane, që në atë kohë ishte si qendra më e rëndësishme e nacionalizmit shqiptar dhe e veprimtarisë patriotike të diasporës.

....Nga ana tjetër, ky libër do t'iu japë lexuesve shqiptarë një vlerësim mbi realitetin e vështirë të jetës së mërgimtarëve në Shtetet e Bashkuara gjatë dekadave të para të shekullit të njëzetë. Kjo vepër do të shtojë edhe respektin për sakrificat që ka bërë brezi i parë i shqiptaro-amerikanëve në mbështetje të përpjekjeve për të ruajtur pavarësinë dhe integritetin territorial të Shqipërisë gjatë periudhave më kritike të historisë së kombit tonë. Për më tepër, ky libër do të kontribuojë për të kuptuar më mirë rëndësinë që i kushtonin mërgimtarët e hershëm shqiptarë ruajtjes së trashëgimisë së tyre kulturore.



ÇFARË NDODH NË QYTET

HAPJA E NEGOCIATAVE - MOS PRETENDONI TA INJORONI LISTËN E GJATË TË KUSHTEVE!

ALBA ÇELA

Vendimi i rëndësishëm i Këshillit të BE për t'i dhënë më në fund dritën e gjelbërt Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut lidhur me hapjen e negociatave u prit me njëfarë mospërfilljeje nga mazhoranca shqiptare. Duke u shprehur se vonesat në këtë proces kishin nisur të “mbanin erë”, Kryeministri Rama dukej sikur bënte sikur kishte harruar listën e gjatë të kushteve që i ishin vënë përpara Shqipërisë. Këto kushte që duhen përmbushur, përpara konferencave të para dhe të dyta ndërqeveritare, janë një kombinim i nëntë kushteve ekzistuese të vëna nga Bundestagu gjerman vjeshtën e shkuar dhe gjashtë kushte të reja.

Në tërësinë e tyre, lista pasqyron nevojën për të mundësuar normat për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Këtu përfshihen miratimi dhe zbatimi i Reformës në Drejtësi, funksionimin e gjykatave të larta dhe hapa të tjerë konkretë të reformës në drejtësi me fokus të veçantë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit. Ka gjithashtu dhe disa kushte të tjera të ndryshme që rezultojnë nga agjendat politike afatshkurtra të disa prej shteteve anëtare, sic është rritja e përpjekjeve për frenimin e azilkërkuësve dhe zbatimi i ligjit për minoritetet. Një tjetër kusht i ri i vendosur i korrespondon çështjes së re që është përfutur nga propozimi i ligjeve drakonike mbi mediat, për të cilin BE rekomandon të rishikohet.

Lista e gjatë dhe e vështirë e punëve është e rëndësishme kritike dhe vendimi për ta shmangur përmendjen e listës në deklaratat e para publike është fatkeqësisht shumë domethënës. Detyrat e shtëpisë janë shtuar ndjeshëm. Duhet mbajtur parasysh që Maqedonia e Veriut nuk ka fare kushte të vendosura për të proceduar me hapin e parë: konferencën ndërqeveritare. Që kjo listë të përmbushet, nevoja për të përfshirë në procesin e këtyre reformave vendimmarrësit e vërtetë dhe për të kërkuar kompromis të vërtetë nëpërmjet dialogut politik është mëse e qartë.

Kur të vijojmë me këtë detyrë shtëpie duhet të mbizotërojë vetëm një qasje: të gjithas masat dhe aksionet e kërkuara prej nesh janë ato të duhurat. Këto janë kërkesa të drejta të cilat nuk rrjedhin nga metodologjia e re, por nga vetë thelbi i kriterit politik. Këto do ta ndihmojnë Shqipërinë së pari e para së gjithash për t'iu larguar trashëgimisë së tranzicionit shkatërrues të ngërceve politike, korrupsionit, manipulimit të zgjedhjeve dhe autoritarizmit individual.

Këto detyra kërkojnë jo vetëm përgjegjësinë, por dhe një qasje realisht korrekte ndaj vlefshmërisë së tyre. Ka ardhur koha ta braktisim njëherë e mirë narrativën e “check the box” që shpeshherë është inkurajuar nga qëndrimi i disa aktorëve ndërkombëtarë në kurriz të impaktit real.

Shqipëria mori një lajm të mirë! Por mori gjithashtu dhe një kujtesë të fortë dhe të rëndësishme që në rast se nuk ia nisin punës të gjithë palët e interesuara, ne mund të kuptojmë në pak javë që mund të kemi festuar para kohe!

NJË KRIZË TANI, DHE NJË KRIZË MË E GJATË QË PRITET TË VIJË

Është e natyrshme dhe mëse e pritshme të përfshihesh në gjendjen e panikut të momentit, në përpjekje për të bërë më të mirën për të frenuar përhapjen e epidemisë Covid-19. Sigurisht, zbatimi i masave parandaluese dhe monitorimi i afërt i situatës është i domosdoshëm. Megjithatë kufizimet ekzistuese logjistike që ka, qeveria duket se po bën një punë të mirë, së paku sipas miratimit të zyrtarëve të Oganizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), të cilët e mirëpritën vendimin e shpejtë të qeverisë për të kufizuar ndërveprimet shoqërore.

Megjithatë, kritikët me të drejtë theksojnë nevojën e ndalimit më të herët të udhëtimeve për Italinë e Veriut, si dhe përgatitjen e vendeve të karantinimit shumë kohë më përpara se sëmundja të shfaqej brenda kufijve të Shqipërisë.

Përpos krizës së tanishme, në horizontin e kësaj situatë me zhvillim të shpejtë, një tjetër rrezik na kanoset: problemet ekonomike dhe shoqërore që pritet të rriten si pasojë e impaktit të virusit brenda vendit dhe në mbarë globin. Para së gjithash, ekonomia shqiptare është tashmë vulnerabël: një klimë biznesi që ka penguar investimet e

huaja direkte, një shkallë konkurrueshmërie në nivel të ulët si pasojë e monopoleve të krijuara dhe koncesioneve, si dhe sektorëve dhe segmentëve të popullsisë që janë më të goditurit nga tërmeti.

Pezullimi dhe limitimi i aktivitetit ekonomik, i vendosur si masë për mbrojtjen e shëndetit publik, do të prodhojë së paku një shok afat-shkurtër në të ardhurat që vijnë nga bizneset. Impakti në fushën e turizmit do të jetë shkatërrimtar. Zyrtarë nga shoqata e turizmit kanë folur tashmë në media mbi anulimet në shkallë të lartë të kohëve të fundit, të cilat iu shtuan anulimeve të tjera që u kryen fill pas rënies së tërmetit. Industria e transporteve dhe shumica e kategorive të tjera të shërbimeve përballen me të njëjtin fat. Për momentin, ndonëse palët e interesuara janë në dijeni të kësaj situatë, është e paqartë cilat janë kapacitetet reale të financave publike të Shqipërisë për të përballuar edhe pasojat e epidemisë. Sakaq, zgjidhjet afatshkurtra janë më të lehta për t'u gjetur. Për shembull, pezullimi i kredive për individët dhe bizneset për tre muaj, është njoftuar tashmë nga Banka e Shqipërisë. Kjo është mëse e nevojshme, pasi me shumë gjasa, të ardhurat e familjeve dhe bizneseve të



vogla do të bien në pikiatë dhe nuk do të jenë në gjendje për të përballuar detyrimet ndaj sektorit bankar.

Megjithatë, panoramën e plotë të efekteve nuk jemi ende në gjendje ta dallojmë. Efekti i përgjithshëm në ekonomi mbetet për t'u kuptuar dhe për t'u pranuar, me kalimin e kohës. Ndërsa bursat dhe çmimi i arit të zi është në rënie në mbarë botën, diskutimet mbi recesionin e ardhshëm, të ngjashëm me atë të 2008, po dëgjojnë anembanë nëpër mediat globale. Gjatë recesionit të fundit, Shqipëria pësoi pasoja të pjesshme si pasojë e ekspozimit të saj tejet të kufizuar ndaj tregjeve financiare. Por kësaj rradhe, gjërat do të jenë ndryshe. Asnjë strategji rrugëdaljeje nuk do të funksionojë kundër kësaj force shkatërruese mikroskopike që është duke bërë kërdrinë.

Shqipëria nuk gëzon as gjysmën e vitalitetit dhe qëndrueshmërisë së ekonomisë italiane, dhe as nuk mund të mbështetet në opsionet e ndihmës që vijnë si pjesë e të qenurit një shtet anëtar i Bashkimit Europian. Disa vendime të vështira duhen ndërmarrë, në kufijtë e buxhetit shtetëror dhe në kuadër të mbajtjes së borxhit publik nën kontroll. Prandaj, lind nevoja e një debati serioz, me bazë ekspertësh, pa ngjyrimë histerie apo

polarizimi, për të krahasuar opsionet dhe strategjitë e mundshme, dhe për të diskutuar ide kreative në mitigimin e impaktit negativ në performancën ekonomike dhe impaktin shoqëror të tij në popullsi.

Ky debat duhet të jetë i hapur, konstruktiv dhe gjithëpërfshirës, përta i përket palëve të interesuara. Kjo nënkupton që debati të përfshijë qeverinë, opozitën, këshillat e biznesit dhe punëdhënësve, akademikët dhe institucionet financiare që monitorojnë indikatorët tanë.

Ekspertët shëndetësorë besojnë që kriza e virusit do të arrijë pikën kulmore dhe më pas do të shuhet gradualisht. Përvoja e dëshmuar në Kinë duket se e mbështet këtë tezë. Qeveria është tashmë përgjegjëse për të ndjekur masat e duhura dhe për të garantuar zbatueshmërinë e tyre me përpikëri, si dhe për të fuqizuar sektorin shëndetësor me çdo masë të mundshme, me qëllim që të mundësohet ofrimi i shërbimit mjekësor ndaj qytetarëve dhe për rrjedhojë, të shpëtohen jetë.

Megjithatë, nuk duhet të harrojmë që një krizë më e madhe është tashmë në pragun tonë të derës: rënia ekonomike, si pasojë e ndërprerjes së aktivitetit. Nevojitet përgatitje rigoroze për t'i bërë ballë krizës së paskëtajme.



NGA REPUBLIKË NË LAGJE, NJË SHOQËRI NË IKJE

Ditët e sotme ikja masive e shqiptarëve jashtë shtetit nuk është e nevojshme të paraqitet me shifra. Njerëzit e ndiejnë atë në përditshmërinë e tyre, me pjesëtarët e familjes, fqinjët, kolegët dhe miqtë e tyre që gjithnjë e më shumë, marrin valixhet dhe shpërngulen jashtë vendit. Megjithatë, edhe për ata pak skeptikët e mbetur, kryesisht ndër rradhët e klasës politike që po e bën ‘një sy qorr e një vesh të shurdhër’ kundrejt këtij fenomeni, shifrat pësuan sërish një rritje në dy muajt e parë të këtij viti. Vetëm në 2018, INSTAT numëronte përafërsisht 46 000 shtetas shqiptarë që kishin braktisur vendin e tyre. Gjithsej, më shumë se 350 000 kanë emigruar vetëm gjatë tetë viteve të fundit. Për më tepër, në një studim të kryer nga Qendra Kërkimore Pju (Pew Research Center) dhe disa nga skenarët e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet demografike, parashikimet për Shqipërinë duken të zymta: një skenar realist parashikon se popullsia e Shqipërisë do të tkurret në afro 1 milionë banorë deri në fund të këtij shekulli; ndërsa skenari më negativ, parashikon gjysmën e këtij numri, duke bërë që harta e popullsisë së vendit t’i përngjajë asaj të një lagjeje modeste të një qyteti të madh.

Shqipërisë, megjithatë nuk do t’i duhet të presë deri në fund të këtij shekulli për të ndjerë barrën e tkurrjes dramatike të popullsisë së saj. Çdo gjë që e mban gjallë strukturën e shoqërisë së saj: skema e pensioneve, burimet njerëzore të sektorit shëndetësor, ajo çka ka mbetur nga cilësia e arsimit të lartë dhe vetë shpresa për ndryshim politik - është në rrezik për t’u shpërbërë para syve tanë, shumë shpejt.

Në mes të kësaj humbjeje të popullsisë, ikja e trurit është më e dhimbshme për t’u observuar: një numër

i madh mjekësh, inxhinierësh apo dhe studentësh të shkëlqyer po e braktisin vendin me ritme të shpejta, duke e privuar kështu Shqipërinë nga më të mirët dhe më të mirë-arsimuarit, duke i thelluar kështu më tej sfidat strukturore të tranzicionit të pafundëm të vështirësive.

Rishfaqja e migrimit dhe në veçanti e ikjes së trurit është një fenomen i dallueshëm në mbarë rajonin. Nisur nga prezenca dhe efekti dërrmues i këtij fenomeni, është e habitshme pse klasa politike në të gjithë rajonin ka vendosur ta trajtojë këtë temë si një oportunitizëm të hidhur shifrash. Në rastin e Shqipërisë, sjellja cinike kundrejt fenomenit dhe përpjekjet për ta normalizuar atë janë edhe më të rënda.

Në kontrast me qeverinë, qytetarët shqiptarë duken shumë më të vëmendshëm ndaj kësaj çështjeje, ndonëse me një frymë dorëzimi ndaj fatit. Ndërsa të rinjtë bëjnë gati valixhet për të ikur, brezi i vjetër vajton fatin që e pret vendin e privuar prej të rinjve dhe perspektivës, ndërsa prindërit në moshë të mesme i janë futur punës për të njohur mekanizmat ligjorë për t’u bashkuar ligjërisht me familjarët e tyre jashtë kufijve.

Pikërisht këtu qëndron miti i parë që duhet të demaskohet, nëse duam t’i drejtohem shoqërisë në ikje. Kjo nuk është e paevitueshme, nuk është “e shkruajtur”. Largimi është rezultati i disa dekadave autoritarizëm, kaosit, luftës së përbrendshme, korrupsionit, nepotizmit dhe militantizmit politik.

Për cilindo individ, ky është një vendim personal dhe familjar. Megjithatë, ne nuk duhet të harrojmë që në fund të ditës, fitorja u përket atyre që qëndrojnë për të përfituar më shumë kur mbeten vetëm dhe të lirë për të bërë ç’të duan. Dhe më e rëndësishmja, është humbja e shoqërisë sonë, e vendit tonë.

SI TË PËRMIRËSOHET EKONOMIA? GËNJESHTRAT NUK FUNKSIONOJNË

Forumi Ekonomik i Tiranës, një event me një emër disi pompoz, ia ka arritur gjithsesi të sjellë fokusin e diskutimeve në situatën aktuale ekonomike në Shqipëri dhe sfidat e saj të shumta. Në fjalimin e tij, Kryeministri Edi Rama parashtrroi disa vëzhgime mbi gjendjen aktuale dhe disa prej masave që mund t'i adresojnë problemet.

Kur diagnoza është e pasaktë, kurat që ndiqen zor se do të funksionojnë.

Kryeministri ritheksoi që papunësia sipas statistikave të Bankës Botërore është në rekordet më të ulëta historike dhe deklaroi paraprakisht që kjo nuk vjen si pasojë e eksodit masiv të njerëzve. Ç'ironi e hidhur! Pikërisht në javën kur po zhvillohej Forumi, sondazhet vërtetuan sërishmi mungesën e mundësive të punësimit por njëherazi dhe pagat e ulëta, kushtet e këqija dhe një mungesë mundësish rritjeje në punë, ndër arsytet më të përmendura nga shqiptarët për të emigruar. Papunësia, thjesht si shifër, në fjalët e vetë Kryeministrit 'nuk hahet'.

Vëzhgimi tjetër që u përmend ishte rritja në investimet e huaja direkte në Shqipëri. Kjo është akoma më e habitshme! Raportet ekonomike dëftojnë që me mbylljen e dy projekteve madhore, Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) dhe projektit hidroenergjetik të Devollit, Shqipëria po përballet me një rënie të ndjeshme të investimeve të huaja direkte. Lajmet mbi projekte të reja që do të zbatohen, me hapje pusesh të reja naftë në fusha potenciale të sapozbuluara, kanë mbetur vetëm në nivelin e studimeve të fizibilitetit, në rastin më të mirë. Planet e tjera për të ndërtuar aeroporte, gjithashtu, nuk duket se po ecin, me kompani të ndryshme ndërkombëtare që fillimisht i marrin përsipër, dhe më pas tërhiqen – me gjasa, për shkak të termave korruptivë të referencës që u vihen përpara.

Në kuadër të investimeve të huaja direkte, Shqipëria i ngjet një shkretëtire – edhe kur krahasohet me vendet fqinje. Në Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi, pavarësisht momenteve të destabilitetit, investimet nga Shtetet e Bashkuara, vendet e Bashkimit Europian,

Turqisë dhe madje dhe vendet e Gjirit nuk kanë munguar dhe kanë ardhur duke u shtuar. Kjo vjen si rrjedhojë e klimës krahasimisht më të favorshme të investimeve që këto vende kanë ndërtuar dhe kanë arritur të mbajnë.

Pikërisht këtu qëndron vëzhgimi kryesor të cilit Kryeministri i vjen rrotull: shteti ligjor që është në qendër të ekonomive të suksesshme të tregut, parakushti parësor që investitori kërkon të shohë dhe garancia e zhvillimit të qëndrueshëm.

Kjo është veçanërisht e dallueshme edhe kur ai liston "kurën": digjitalizimi i 95 për qind të shërbimeve, përmirësimi i transparencës së transaksioneve nga biznesi në biznes, lufta ndaj krimit të organizuar dhe shtrirja e tregjeve nëpërmjet bashkëpunimit rajonal. Kjo është para së gjithash një sërë masash që janë kundër logjikës. Shteti ligjor, që duhet të ishte fjala kyçe që duhej përmendur, mund të arrihet vetëm tërthorazi nga lufta kundër krimit.

Shërbimet digjitale tingëllojnë si një truk i bukur propagandistik, por që shpesh i zbehet shkëlqimi nga keqfunksionimi, me uebsajtet që kolapsohen shpesh të cilat brezat e vjetër në Shqipëri ende nuk mund t'i përdorin. Bashkëpunimi rajonal dhe tregtar, në një rajon të goditur rëndë nga problemet politike dhe hendeqet e thella të ndërlidhjes, janë sërish thjesht dëshira.

Por ka dhe një listë modeste kurash që mungojnë: shpërbërja e monopoleve dhe oligopoleve që po mbysin ekonominë dhe po rëndojnë ditë pas dite konsumatorin shqiptar, të zhveshur nga inovacioni dhe konkurrueshmëria; rishikimin e gjithë skemës obsesive të PPP që po i vendos financat publike para një rreziku ekstrem dhe së fundmi, përmirësimi i tregut të punës në të gjitha dimensionet e tij, duke përfshirë këtu sigurinë, që për rrjedhojë mund të ndihmojë në shpopullimin e vendit.

Pa këto, i vetmi progres ekonomik që ne do të shohim është rritja e gjigandëve të ndërtimeve, që lajnë para kat pas kati, në përpjekjet e tyre për të kapur qiellin.

Ndreqja e ekonomisë është punë e vështirë. Gënjeshtrat nuk do të ndihmojnë.

QEVERIA SHQIPTARE NË BOTËN E ÇUDIRAVE

Ndërsa hyri viti i ri 2020, realiteti shqiptar dhe qeveria e Shqipërisë nuk mund të ishin më larg nga njëri-tjetri, secili duke operuar në një dinamikë ekskluzive me fare pak - ose aspak - pika kontakti.

Të goditur nga një krizë politike paralizuese, një fasadë demokracie e cilësisë së dobët, me pak substancë institucionale, një ekonomi në amulli dhe tërheqje të fjetura investimesh të huaja, dhe të goditur nga një fatkeqësi natyrore që la me mijëra të pastrehë, Shqipëria është duke u zvarritur.

Dhe sikur të mos mjaftonin këto, Shqipëria u cilësua nga autoritetet iraniane si 'një vend i vogël djallëzor' ku opozita e tyre është e strehuar me kërkesë të Shteteve të Bashkuara, duke bërë kështu që Shqipëria të shtohet si një objektiv vulnerabël në listën e Iranit.

Megjithatë, nëse do të mbështeteshit në mediat sociale qeveritare për të marrë të rejtat më të fundit mbi aktualitetin e Shqipërisë, do të besonit se vendi po lulëzon. Do të besonit se po vihen në zbatim plane të mëdha për ndërtimin e aeroporteve në pika kyçe turistike, që nafta është gati të shpërthejë në fushat në jugperëndim të vendit dhe që receta e bashkëpunimit rajonal në kuadër të Mini-Schengen është pikërisht shpikja që na nevojitet për të sjellë mirëqenien dhe integrimin.

Por qershia mbi tortë e këtyre realiteteve paralele, e aftë për t'i shkaktuar kujtdo disonancë të rëndë konjitive, është festa për kryesinë e Shqipërisë së OSBE. Kjo *arritje historike e politikës së jashtme* supozohet t'i frymëzojë të gjithë shqiptarët anembanë të festojnë.

Në fjalën e tij gjatë ceremonisë për fillimin e kryesisë, Kryeministri shqiptar mbuloi të gjitha temat, që nga përshirja e grave në agjendën e sigurisë, deri në zbatimin e Marrëveshjes së Minskut. Temat me interes global rrëshkasin natyrshëm

në gojën e liderëve shqiptarë të të gjitha anëve që vazhdojnë të besojnë heshturazi, sikurse predikohej në kohën e komunizmit, që Shqipëria është në qendër të botës. Vetëm kur bëhet fjalë për çështjet e brendshme, ngecin punët.

Një vend që është tejet i pasigurt për qytetarët e vet ka marrë tashmë përgjegjësinë për të promovuar paqen dhe sigurinë në mbarë hemisferën veriore. Krahasuar me këtë, krijesat e Botës së Çudirave të Lewis Carroll duken më pranë realitetit.

Në realitetet paralele, ku njerëzit hedhin granata dore në zyrat e bashkive dhe ku ka dhjetëra njerëz të vrarë që në javën e parë të 2020-ës, për motive që variojnë nga gjakmarrja në ujdite mafioze, sipas deklaratave zyrtare të agjencive ligjzbatuese për vrasjet e shumta të ditëve të para të vitit, këto nuk janë gjë tjetër veçse një glitch.

Në realitetet paralele, ku qeveria dhe kryetarët magjikë të bashkive po përgatisin terrenin për lagje fringo të reja të shkëlqyera që do ndërtohen për njerëzit e pastrehë të pas-tërmetit, afatit për të qëndruar në hotele i ka ardhur fundi dhe familjet në fjalë kanë mbetur duke u endur në qiell të hapur me gjithë fëmijët dhe ato çka u kanë

mbetur nga gjërat personale.

Herë zemërlëshuar, herë pezmatuar nga realitetet paralele, lista vazhdon e vazhdon...

Nuk na mbetet gjë tjetër veçse të shpresojmë që brenda botës së magjisë të ekzistojë një pluhur magjik që do ta zgjojë një ditë qeverinë dhe ta bindë të kapërcejë pragun e realiteteve paralele, të fillojë të punojë mbi çështjet konkrete dhe të ndërmarrë një standard minimal modestie dhe përgjegjshmërie kundrejt zgjedhësve të saj.

Ndoshta dhe kjo është e mundshme në Botën e Çudirave.





SHQIPËRIA DHE KOSOVA: NGA LUFTA E FTOHTË TEK NJË AGJENDË STRATEGJIKE

ALBERT RAKIPI

Vizita e parë e Kryeministrit të ri të Kosovës, Albin Kurti, në Tiranë më 11 shkurt 2020, bëri edhe njëherë publike se në marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë ka tensione dhe ekzistojnë mosmarrëveshje për çështje themelore të bashkëpunimit midis dy shteteve, përfshirë edhe pikëpamje të ndryshme për bashkëpunimin rajonal. Vetëm pak ditë pasi udhëheqësi i *Lëvizjes Vetëvendosje* arriti të krijonte një qeveri pas një koalicioni të vështirë me LDK, vendosi të vizitonte Shqipërinë si shteti i parë që viziton si Kryeministër.

Por pavarësisht nga karakteri simbolik, kjo vizitë rikonfirmoi varfërinë e marrëdhënieve midis dy shteteve,

bashkëpunimin e dobët ekonomik, shkëmbimet e varfëra tregtare midis dy vendeve dhe rrjedhimisht, mungesën e investimeve respektive. Ndërkaq, përballë këtij realiteti, të dy kryeministrat zbuluan një “realitet” tjetër: Më shumë se shtatëdhjetë marrëveshje të nënshkruara midis të dy vendeve të cilat ose nuk janë zbatuar fare, ose zbatimi i tyre është i pjesshëm dhe për çështje jo substanciale. Kryeministrat u angazhuan të ndërtojnë një komision ndërshtetëror për të kuptuar përse këto marrëveshje nuk funksionojnë.

Dymbëdhjetë vjet pas shpalljes së Kosovës si shtet i pavarur, marrëdhëniet me Shqipërinë ecin ngadalë, pa ndonjë domethënie të madhe për të dy vendet dhe për më tepër, me tensione në rritje.

Por së pari, përse kjo *state of affairs* midis të dy shteteve? Dhe pyetja e dytë e lidhur me të parën: Si mund



të ndërtohet një axhendë normale dhe strategjike midis të dy vendeve në bazë të së cilës edhe Shqipëria, edhe Kosova, do ta ndihmonin realisht njëra-tjetrën? Nga pikëpamja strategjike, të dy vendet e shikojnë të ardhmen si dy shtete të pavarura, funksionale, me ekonomi të zhvilluar, dhe anëtare të Bashkimit Evropian.

Arsyet e largimit nga ky objektiv, njëherazi arsyet e tensioneve politike midis të dy vendeve janë të paktën dy. Së pari, Shqipëria aktualisht vijon të aplikojë një qasje paternaliste dhe here-herë arrogante ndaj Kosovës, çka u vu re edhe në shfaqjen e parë publike të të dy kryeministrave gjatë vizitës së parë të Z. Kurti në Tiranë, në kapacitetet e shefit të Qeverisë së re në Kosovë. Së dyti, është vënë re se Shqipëria, në marrëdhëniet e saj me Serbinë, ka marrë përsipër të flasë në emër të Kosovës, të përfaqësojë Kosovën dhe institucionet e saj, të negociojë në emër të Kosovës, madje dhe të ndërmjetësojë në emër të saj.

Askush nuk e ka ngarkuar me këtë mandat. Përkundrazi, udhëheqës të nivelit të lartë në Kosovë, fillimisht në një gjuhë të përmbajtur dhe më pas hapur, dhe me zë të lartë kanë kërkuar që Tirana ta ndalojë këtë rol paternalist. Sipas ish-Ministrit të jashtëm, Enver Hoxhaj “Ndërmjetësuesin midis Serbisë dhe Kosovës nuk mund ta luajë Shqipëria, pasi Shqipëria nuk e ka as fuqinë, as kapacitetet për ta bërë këtë rol.” Është BE dhe SHBA, sipas Hoxhaj, që duhet t’i ndërmjetësojnë marrëdhëniet midis shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Por kjo nuk e ka ndaluar Kryeministrin e Shqipërisë të vijojë një mision

imagjinar. Nga viti 2014 në çdo takim të Kryeministrit të Shqipërisë me ish Kryeministrin dhe Presidentin aktual Vucic, të Serbisë Kosova është qendrore, sikur Kosova të ishte një çështje midis Shqipërisë dhe Serbisë.

Për shkaqe të njohura historike, Shqipëria kurrë nuk e ka luajtur rolin e saj si *shteti amë*. Dhe aq më pak mund ta bëjë këtë pas vitit 2008, kur Kosova u bë një shtet i pavarur. Tingëllon paradoksale, por duket se Shqipëria e konsideron Kosovën si një krahinë autonome të vetën.

Kjo qasje paternaliste që *harron* se Kosova është një shtet i pavarur, ka bërë që nga agjenda normale bilaterale e të dy shteteve të bjerren çështjet normale të bashkëpunimit politik, bashkëpunimit ekonomik, shkëmbimet tregtare, bashkëpunimit kulturor, shkencor, akademik etj.

Agjenda normale dypalëshe midis Shqipërisë dhe Kosovës është ngushtuar dhe zbratur, sepse Shqipëria do të luajë rolin kryesor në pajtimin në Ballkan midis shqiptarëve dhe serbëve. Shqipëria dhe Serbia, sipas kryeministrit të Shqipërisë, duhet të bëjnë atë që Gjermania dhe Franca kanë bërë me njëra-tjetrën.

Në fakt, pajtimi i shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan, nuk varet nga Shqipëria dhe Serbia, por nga Kosova dhe Serbia. Ky është ekuacioni i paqes i ngjashëm me ekuacionin Gjermani-Francë. Këmbëngulja e Shqipërisë për të bërë paqe me Serbinë edhe në emër të Kosovës, e detyroi Presidentin Hashim Thaçi të deklarojë publikisht se “Paqja midis shqiptarëve dhe serbëve kalon nga Prishtina, dhe jo nga Tirana.”



Agjenda normale më tej është zëvendësuar me një agjendë false strategjike për ndërtimin e paqes në Ballkan sipas modelit Shengen.

Shengeni ashtu siç është implementuar në Europë është një botë idealiste dhe hëpërhë utopike në Ballkan. Tirana luan me idenë e mbështetjes perëndimore për mini-Shengenin ballkanik. Është shumë e gabuar të kushtëzosh bashkëpunimin dhe marrëdhëniet me Kosovën me Shengenin ballkanik (nëse i përmbahemi deklaratës së Ramës se pa mini- Shengen nuk ka makro-Shengen shqiptar.) Perëndimi, Bashkimi Evropian apo Shtetet e Bashkuara nuk janë kundër bashkëpunimit të Shqipërisë dhe Kosovës.

Thirrjet për heqjen e kufirit midis Shqipërisë dhe Kosovës janë ushtrime populiste që më e pakta mund të fshehin arsyet e verteta të marrëdhënieve të varfëra midis Shqipërisë dhe Kosovës. “Luftërat” për patatën, qumështin, miellin apo të tjerat në kufirin midis dy vendeve nuk janë për shkak të ekzistencës së kufirit, por për shkak të politikave, interesave oligarke, korruptive, nëse jo për shkak të interesave kriminale.

Është koha që Shqipëria dhe Kosova të ndërtojnë një agjendë normale dhe madje strategjike. Por për këtë, fillimisht do të duhet që Qeveria dhe Kryeministri i Shqipërisë të heqin dorë nga qasja dhe aksionet paternaliste ndaj Kosovës. Kryeministri Rama duhet të heqë dorë nga përdorimi *proxy* që i bën Kosovës për interesat e tij në dy rrafshet. Së pari, për të blerë mbështetje

në Perëndim duke përdorur Kosovën. Duke u shfaqur si një lojtar i rëndësishëm, në mos më i rëndësishmi në të ardhmen e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.

Së dyti, loja *proxy* e Shqipërisë, në fakt e Kryeministrit, ka për qëllim të promovojë lidhshypin e tij në Ballkan, krejtësisht i panevojshëm, i pabesueshëm, dhe i padobishëm.

Po kështu, protoganizmi i Kryeministrit të Shqipërisë për të ashtuquajturin mini-Shengen është në funksion të blerjes së mbështetjes perëndimore nën idenë e promovimit të një udhëheqësi reformator që po kontribuon për paqen në Ballkan përmes Shengenit - një institucion që askush nuk mund ta kritikojë në parim. Por ky udhëheqës që është angazhuar për një botë ideale përmes Shengenit në Ballkan, në gjashtë vjet qeverisje nga *zero probleme me fqinjët*, që premtoi më 2013 përfundoi në probleme me të gjithë fqinjët, përfshirë për fat të keq edhe Kosovën, ndërsa në politikën e brendshme, Shqipëria mbërriti në zgjedhje me një parti politike dhe me një parlament njëngjyrësh.


Edhe me Serbinë për të cilën mund të mendohet se marrëdhëniet janë të mira dhe po ecin, e vërteta është se marrëdhëniet karakterizohen nga *status quo*-ja. Nëse sigurisht, nuk konsiderojmë si arritje të marrëdhënieve Shqipëri-Serbi iniciativat e përbashkëta të Beogradit dhe Tiranës për paqen dhe ndërtimin e zonës Shengen në Ballkan. Nëse Serbia është e interesuar për ndërtimin e paqes edhe përmes zonës apo formulës Shengen, hapi i parë do të ishte ndalimi i fushatës së njohjeve ndaj Republikës së Kosovës, njohja e dokumenteve të udhëtimit dhe pasaportave siç kanë bërë disa vende që ende nuk e njohin Kosovën si shtet.

Një axhendë normale midis Shqipërisë dhe Kosovës do të kërkonte përpara zhvillimit të Shengenit ballkanik, zhvillimin, funksionimin dhe forcimin e marrëdhënieve shtetërore midis Shqipërisë dhe Kosovës, të cilat janë pothuaj në krizë.

Në Kosovë ka një qeveri të re dhe një kryeministër të ri, në fakt, një populist i cili deri sa erdhi në pushtet i përmbahej tezës që bashkimi kombëtar është *sine qua non* për zhvillimin dhe përparimin e Shqipërisë dhe Kosovës. Bashkimi kombëtar ka qenë *the currency* e ideologjisë politike të Z. Kurti por mbetet të presim si do të akomodohet. Por gjithsesi, Kurti ka të drejtë kur thotë se përpara se të merremi me Shengenin ballkanik duhet të merremi me makro-Shengenin shqiptar, i kuptuar ky sigurisht si bashkëpunim dhe intensifikim i marrëdhënieve politike ekonomike e gjithfarëlojëshe midis Shqipërisë dhe Kosoves - gjithmonë, si dy shtete të pavarura.

NACIONALIZMI I RI

JILL LEPORE — KWAME ANTHONY APPIAH — ANDREAS WIMMER — JAN-WERNER MÜLLER — ROBERT SAPOLSKY
Yael Tamir — Jack Snyder — Lars-Erik Cederman




BOTIM I **AiiS**

aiis@aiis-albania.org

ISBN: 978-9928-195-27-2

Çmimi: 900 lekë

Sot, komb-shteti është aq dominues sa duket si natyral. Shtetet janë struktura politike sovrane. Kombet janë grupe shoqërore të bashkuara. Po çfarë borxhe i kanë ata njëri tjetrit? Pretendimet e shtetit janë të dukshme: ai ka një varg përgjegjësish praktike dhe legjione teknokratësh, që punojnë për t'i kryer ato. Kurse pretendimet e kombit janë më pak të qarta dhe ato shfaqen me zëra të çjerrë. Avokati i atyre pretendimeve – nacionalizmi – ka kryer disa nga krimet më të mëdha gjatë historisë. Dhe në këtë mënyrë, ky koncept u bë tabu në shoqërinë e kulturuar me shpresën se mos bëhej tabu edhe në praktikë. Megjithatë ai po vjen përsëri tani me hakmarrje. Në këtë libër, një grup autorësh të jashtëzakonshëm shpjegojnë se çfarë po ndodh dhe arsyen e asaj që po ndodh.



METODOLOGJIA E RE PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE ME BASHKIMIN EUROPIAN

VLADIMIR MEDJAK¹

Bashkimi European dështoi të hapë negociatat me Maqedoninë e Veriut dhe me Shqipërinë në tetor 2019, pavarësisht rekomandimeve positive të Komisionit. Franca ishte shteti më shprehës në qëndrimin e saj kundër çeljes së negociatave dhe opinioni francez gjeti mbështetjen e shumë shteteve të tjera anëtare. Kjo situatë, dhe reagimet negative mes shteteve anëtare të cilat ishin në favor të hapjes së bisedimeve dhe për pasojat që ky vendim mund të sjellë në kredibilitetin global të BE, sollën sërish të ardhmen e zgjerimit në agjendën e BE. Shumë prej aktorëve të BE e përshkruan vendimin si një gabim.

Rrugëdalja e kësaj situatë duket se u gjend në ndryshimin e metodologjisë së zhvillimit të negociatave hapëse. Think tanks të ndryshëm nëpër Europë, përfshi këtu Lëvizjen Evropiane në Serbi kanë advokuar për ndryshim të procesit prej vitesh. Ne të gjithë kemi vënë në dukje se modeli aktual i zhvillimit të negociatave është i privuar nga liderhipi politik, është bërë tepër administrativ dhe i segmentuar dhe është tepër i dyshimtë nëse mund të çojë realisht në anëtarësimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor.

¹ Zv. President i Lëvizjes Evropiane në Serbi dhe ish-Kryekëshilltari Ligjor në Grupon e Hapjes së Negociatave të Serbisë me Bashkimin European

Pas vendimit të tetorit, Franca² botoi në nëntor non-paper e saj duke propozuar ndryshimet në metodologji. Në reagim të këtij publikimi, nëntë vende anëtare publikuan në dhjetor non-paper e tyre.³ Me qëllim që ta strukturonin debatin, Komisioni propozoi të bëhej një sintezë e ndryshimeve të propozuara dhe për të publikuar një propozim zyrtar për rindërtimin e zhvillimit të negociatave, i cili u adoptua prej shteteve anëtare në mars 2020, duke lejuar Komisionin të përgatisë një paketë investimesh për Ballkanin Perëndimor deri në Samitin e Zagrebit të BE në maj 2020⁴.

Ky rezultat i menjëhershëm i këtij debati është konkluzioni që mënyrës së deritanishme të zhvillimit të negociatave i ka ardhur fundi. Deri më tani, negociatat me Serbinë dhe Malin e Zi janë zhvilluar me një hap të ngadaltë, pa iniciativë politike dhe përfshirje të nivelit të lartë politik, sidomos nga ana e BE. Sot, ritmi i zgjerimit mbetet në duart e vetë shteteve anëtare për t'u vendosur, gjë që çon në ngadalësimin e procesit të brendshëm të reformave. Situata e zgjerimit në 2004 ishte krejt e kundërta. Kishte një shtysë të fuqishme nga ana e niveleve më të larta të BE për ta prioritetizuar zgjerimin.

Në këtë drejtim, qëllimi i metodologjisë së re është

² <https://www.politico.eu/article/france-outlines-proposal-to-overhaul-eu-accession-process/>

³ Austria, Republika çeke, Estonia, Italia, Letonia, Lituania, Malta, Polonia dhe Sllovenia <https://www.politico.eu/article/eu-enlargement-reform-pushback/>

⁴ Mbetet e paqartë nëse do të mbahet Samiti i Zagrebit, për shkak të pandemisë së Covid-19.

të japë më shumë kredibilitet, të sjellë më shumë qasje politike, më shumë dinamikë, parashikueshmëri dhe kushtëzueshmëri positive dhe negative në proces. Duke mbajtur parasysh kufizimet e paper-it, unë do të përqendrohem në ndryshimet më madhore por duke nxjerrë në dukje dhe shumë “elementë të rinj” që kanë ekzistuar dhe më parë.

Sipas metodologjisë, qëllimi i ushtrimit është anëtarësimi i plotë dhe përgatitja e vendit kandidat për t’u bërë pjesë e familjes europiane. Ky refren përsëritet disa herë me qëllim që t’i jepet fund dilemës që po ekziston prej disa kohësh mbi këtë çështje, veçanërisht që prej tetorit, dhe mundësive alternative që po diskutohen dhe po promovohen që prej asaj kohe.

Një ndryshim madhor i propozuar është rikthimi i ngasjes politike të zgjerimit, gjë që mungonte që prej 2007. Kjo ngasje politike do të jetë prezente përgjatë gjithë procsit, duke rritur prezencën e vendeve anëtare nëpërmjet kontributeve direkte në raportet vjetore dhe eksperimente sektoriale. Vendet anëtare gjithashtu mund ta rishikojnë dhe ta monitorojnë të gjithë procesin më rregullisht. Komisioni do të propozojë në paketën e tij vjetore të zgjerimit rrugën që duhet ndjekur për vitin e ardhshëm, me më shumë detaje, për miratimin e vendeve anëtare, duke përfshirë dhe propozime për masa korrektuese. Konferenca ndërqeveritare specifike për secilin vend duhen mbajtur pas publikimit të paketës vjetore të Komisionit dhe të ofrojnë forume për dialog politik mbi reformat e paracaktuara për vitin e ardhshëm, përfshirë këtu hapjen dhe mbylljen e kapitujve / grupimeve (clusters) të kapitujve dhe masave korrektive. Të gjitha palët duhet të sigurojnë përfaqësim në konferencat ndërqeveritare në nivelin e duhur, me qëllim që të përftohet një agjendë politike sa më produktive.

Një inventarizim më i hollësishëm politik duhet të ndodhë në tetë raste gjatë negociatave (menjëherë pasi të arrihen standardet e vendosura mbi reformat themelore – kapitujt 23 dhe 24 – përpara se të hapen gjashtë grupimet e kapitujve dhe menjëherë pasi negociatat e përgjithshme të jenë teknikisht gati për t’u mbyllur). Ky do të ishte ndryshimi madhor në qasje, që do të çojë në një proces reformimi më të përqendruar dhe të parashikueshëm, duke i shtyrë qeveritë e vendeve kandidate të bëjnë përpara në zbatimin e reformave. Kjo metodologji gjithashtu do t’i parandalojë shtetet anëtare të prezantojnë kushtëzime të reja pas hapjes së kapitujve. Me katër vende kandidate që zhvillojnë negociatat, në Ballkanin Perëndimor do të niste kështu një konkurrencë pozitive.

Demokracia është baza e stabilitetit në rajon dhe nevojitet



një angazhim më i madh nga ana e liderëve të Ballkanit Perëndimor, ndaj vlerave të BE, të cilat duhen promovuar dhe i duhen komunikuar më tej popullatës, si dhe ndaj shtetit ligjor, që është dhe bërthama e kësaj metodologjie. Nëse implementohen plotësisht, kjo gjë do të çonte në fundin e stabilokracisë në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, pritjet që nga ana e tyre, vendet e Ballkanit Perëndimor të përqafojnë vlerat dhe standardet europiane – gjë kjo që nënkupton që ndryshimet në jetët e qytetarëve të jenë të ndjeshme, dhe që të çojnë në shndërrimin e Ballkanit Perëndimor në ekonomi funksionale të tregut që të jenë më tej të aftë për t’u integruar plotësisht në tregun e përbashkët të BE, të krijojnë vende pune dhe mundësi sipërmarrjeje, të përmirësojnë klimën e biznesit dhe të investimeve, të promovojnë shtetin ligjor dhe të frenojnë migrimin e trurit në rajon.

Negociatat duhet të zhvillohen paralelisht me reformën e brendshme të BE dhe kapitujt kryesorë do të jenë të parët që do të hapen dhe do të mbyllen në fund, teksa negociatat mbi kapitujt e tjerë do të rrjedhin paralelisht. Ky është ndryshimi më i madh nga pikëpamja më problematike e opinionit francez.

Vendet që do t’i afrohen më tej anëtarësimit në BE do të kenë më shumë mundësi për të marrë pjesë në punën e BE, duke u përfshirë gradualisht në politika individuale të BE dhe duke përfituar rritje financimesh dhe investimesh me qëllim përforcimin e ekonomive vendase.

Kapitujt e negociatave do të grupohen në gjashtë grupime ose clusters. Të gjithë kapitujt e kapitujt e një grupimi do të hapen njëherazi por do të mbyllet secili kapitull individualisht. Kjo do të ndryshojë dinamikën e aktiviteteve të reformës të vendeve kandidate,



krahasimisht me atë të Malit të Zi dhe Serbisë. Tanimë, vendet candidate duhet të përqëndrohen në të gjithë kapitujt njëherazi me qëllim që të hapin ndonjërin prej tyre. Nga ana tjetër, kur një grupim është gati, ata mund të hapin tetë ose nëntë kapituj në një konferencë ndërqeveritare, gjë që ishte e paprecedentë në rastin e Serbisë dhe të Malit të Zi. Kjo kërkon më shumë përpjekje në fazën fillimore të negociatave por mund të përshpejtojë fazën e mëvonshme.

Propozimi parashtron një sërë sanksionesh të mundshme nëse një shtet nuk i kryen detyrat e tij. Negociatat mund të vendosen në pritje ose të pezullohen tërësisht, kapituj të mbyllur përkohësisht mund të rihapen, intensiteti i financimeve të reduktohet (me përjashtim të mbështetjes për shoqërinë civile). Është e qartë për të gjithë që këto mundësi ekzistojnë tashmë dhe janë pjesë e kuadrit të negociatave me BE për bisedimet me Serbinë dhe Malin e Zi.

Si përfundim, mund të konkludojmë që metodologjia e re është një dokument i zhvilluar kryesisht me qëllim që t'i lejojë vendet anëtare të dalin nga qorrrokaku i dështimit ku e gjenden veten pas vendimit të tetorit, të hapë udhën për arritjen e një konsensusi të brendshëm mbi zgjerimin në BE. Roli i saj dytësor është të ushtrojë më shumë trysni politike në proces dhe ta bëjë procesin më funksional. Sikurse e theksoi Komisioni, **“ruajtja dhe zgjerimi i kësaj politike është e domosdoshme për besueshmërinë e BE, për suksesin e BE dhe për ndikimin e BE në rajon dhe më gjerë – në veçanti, në kohë të një konkurrence të rritur gjeopolitike.”** Përpos përpjekjeve për të zgjidhur probleme të brendshme lidhur me zgjerimin, Komisioni propozoi ndryshime dhe

mundësi të reja që mund të asistojnë vendet candidate në zhvillimin e hapjes së negociatave. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Malin e Zi dhe Serbinë, të cilat kanë përparuar tashmë dhe ku orientimi politik u ka munguar në procesin e negociatave. Prania e tij do t'i ndihmojë të përshpejtojë procesin nëse kanë vullnet (se mundësi sigurisht që kanë) për të dëftuar rezultate në aspektin e shtetit ligjor. Njëkohësisht, të gjitha mundësitë e sanksionimit, “të propozuara” në metodologji ishin tashmë prezente në çeljen e negociatave.

Përsa i përket Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, ndryshimet e propozuara janë pozitive dhe/ose neutrale kur krahasohen me modelin e negociatave të Serbisë dhe të Malit të Zi. Grupimi do t'i detyrojë qeveritë të përqëndrojnë forcat e tyre përreth clusters, dhe jo kapitujve individual, por megjithatë kushtet për kapitujt individual do të mbeten të njëjtë. Efektet negative të mundësive potencialisht “të rritura” të sanksionimeve janë të pritshme në rast se situata në shtetin ligjor përshkallëzon në këto dy vende. Megjithatë, nuk ka realisht një rritje të sanksioneve, duke qenë se të gjitha mundësitë e përmendura ekzistojnë tashmë edhe për Serbinë dhe Malin e Zi.

Zgjerimi mund të jetë i suksesshëm nëse është një sipërmarrje e përbashkët e BE, vendeve anëtare dhe shtetit kandidat. Kandidatët nuk mund t'i bashkohen Unionit, nëse BE nuk do t'u shtrijë dorën. Për këtë arsye është propozuar më shumë orientim politik. Megjithatë, duhet të jetë e qartë që asnjë ndryshim në metodologji nuk do të ndihmonte nëse mungon vullneti politik, si në BE ashtu dhe në Ballkanin Perëndimor. Miratimi i kësaj metodologjie e vë menjëherë në provë vullnetin politik.



"Duhet të jemi më pranë qytetarëve tanë", tha Kryeministri kroat Plenković, gjatë prezantimit të prioritetëve të presidencës kroate.
© Bashkimi European 2020

PRESIDENCA EUROPIANE E KROACISË: PËR NJË EUROPË MË ME NDIKIM

SANDRO KNEZOVIĆ

Vetëm gjashtë vite e gjysëm pas hyrjes historike të Kroacisë në BE, Kroacia përbalet me një tjetër sfidë historike në gjysmën e parë të 2020 – presidencën e Këshillit të BE. Nisur nga track record i historikut politik të Kroacisë, ky zhvillim është i rëndësishëm parësor për vendin dhe më gjerë. Vetë fakti që po ndodh, ka lënë një shenjë të pashlyeshme në historinë moderne të Republikës kroate dhe rolin të saj në çështjet më të gjera rajonale dhe europiane.

Është interesante të vërehet ndryshimi faktual në praktikën politike të vendit gjatë kohëve të fundit. Në periudhën ndërmjet vitit 2000 kur u prezantua procesi i Stabilizim-Asociimit dhe 2013 kur vendi iu bashkua familjes europiane, Kroacia performoi si një vend që po merrte de facto direktiva nga Brukseli për ta çuar përpara procesin e aksesimit. Thënë ndryshe, procesi i bisedimeve konsistonte tërësisht në negociimin e mënyrës së implementimit të akteve dhe rregulloreve të paracaktuara, në vend që të negociohej mbi substancën e tyre. Sot, bëhet fjalë për një vend që ndikon drejtpërdrejt në formulimin e politikave të BE, duke marrë në konsideratë kapacitete relativisht të limituara.

Përveç kësaj, ndikimi i përdorimit të fondeve strukturore europiane në periudhën pas pranimit në BE filloi të ndryshojë vendin në mënyrë dramatike, veçanërisht në fushën e zhvillimit të infrastrukturës së transportit. Ndërsa efikasiteti i përdorimit të fondeve të lartpërmendura është ende nën nivelin e dëshiruar, shifrat tregojnë një përfitim konkret për ekonominë e Kroacisë në periudhën pas pranimit - Kroacia ka tërhequr dy herë më shumë fonde sesa ka paguar në buxhetin e BE-së në 6 vitet e fundit.

Kjo, sigurisht, përfaqëson vetëm një nga përfitimet konkrete të anëtarësimit në BE. Përveç përfitimeve, anëtarësimi sjell edhe përgjegjësi specifike, ku kryesia e Këshillit përfaqëson vetëm një nga ato më të shquarat.

Kryesia e Këshillit të BE-së është mundësia më

e mirë për anëtarin më të ri të BE-së të dëshmojë pjekurinë dhe të kontribuojë në suksesin e përcaktimit dhe zbatimit të politikave të BE-së. Është një mundësi ideale për Republikën e Kroacisë të tregojë aftësinë për anëtarësim aktiv duke ndjekur politika energjetike si shteti anëtar “pas timonit të BE”, në vend që të ndjekë vetëm zhvillimin e ngjarjeve të përcaktuara nga “lojtarët e mëdhenj” të klubit, pra, të qenurit në sediljen e pasme.

Prandaj, përsëri, presidenca e radhës e Këshillit të BE-së është një mundësi e shkëlqyeshme për vendet anëtar me më pak ndikim që të “shënojnë mbi peshën e tyre”. Suksesi i tyre do të varet ekskluzivisht nga aftësia e tyre për të menaxhuar me sukses tërë përpjekjen dhe në veçanti për të artikuluar me mençuri përparësitë e tyre dhe për të ndërtuar koalicione për zbatimin e tyre.

Nga ana tjetër, disa çështje dhe trende aktuale nuk mund të ndikohen drejtpërdrejt. Mjedisi bashkëkohor në të cilin mbahet Presidenca Kroate e Këshillit të BE-së është i pashembullt dhe prandaj nuk është thjesht një presidencë festive dhe ceremoniale. Jo vetëm që mjedisi gjeo-strategjik i BE-së është shumë sfidues, por vetë BE-ja është e ngarkuar me sfida të mëdha.

Mbi të gjitha, marrëdhëniet ndërkombëtare janë në një periudhë çrregullimi të gjerë dhe koncepti i multilateralizmit - siç e njohim, është në një krizë serioze. Realpolitik po bëhet jashtëzakonisht e rëndësishme në kurriz të qasjes konstruktiviste në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo reflektohet gjithashtu në funksionalitetin e BE-së me qasjen e saj konstruktiviste ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare, bazuar në konceptet e fuqisë së butë, fuqisë së zgjuar dhe bashkëjetesës paqësore. Gjithashtu, BE po përballlet me disa sfida të jashtëzakonshme të brendshme që përcaktojnë kontekstin në të cilin po zhvillohet Kryesia e Këshillit të BE të Kroacisë.

Para së gjithash, Brexit - sipas fjalëve të një poeti cinik, ishulli i mjegullt më në fund u zhduk nga horizonti, por jo plotësisht - periudha e tranzicionit zgjat deri në fund të vitit dhe negociimi i një marrëveshjeje tregtare në vetëm 11 muaj do të jetë një sfidë e madhe. Kryeministri

i Mbretërisë së Bashkuar Johnson tashmë ka deklaruar se nuk dëshiron një zgjatje të kësaj periudhe. Koha do të tregojë se sa realiste mund të jetë kjo dhe çfarë mund të bëhet për të shmangur tregtimin bazuar në rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë (si me një vend të tretë) pas vitit të ri. Këtu duhet të theksohet se një marrëveshje tregtare është vetëm një segment i kornizës së negociatave. Mbeten shumë gjëra për të cilat duhet të arrihet një marrëveshje - çështje të tilla si bashkëpunimi i inteligjencës (kushtet për shkëmbimin e informacionit konfidencial), siguria e ajrit, vërtetimet e produkteve farmaceutike dhe shumë të tjera gjithashtu presin të zgjidhen. Prandaj, Brexit pati një ndikim të madh në zhvillimin e politikave në BE më parë, por edhe gjatë dhe pas Presidencës Kroate të Këshillit të BE-së.

Një çështje tjetër ishte kalimi i strukturave politike në Bruksel. Deri në fillim të kryesisë së presidencës, BE-ja nuk kishte Komisionin dhe Kryetarin e Këshillit, ndërsa mbledhja e re e Parlamentit European pati shumë vështirësi në fillimin e punës së saj - veçanërisht në procesin e legjitimitetit politik të vetë anëtarëve të Komisionit.

Në lidhje të drejtpërdrejtë me këtë, pyetja edhe më e rëndësishme për të ardhmen dhe funksionimin e BE-së është kuadri financiar shumëvjeçar për 2021-2027, ose buxheti i BE-së, i cili është akoma në fazën e negociatave, i ngarkuar me shumë mosmarrëveshje dhe vështirësi konceptuale. Në thelb, ekzistojnë dy grupe të vendeve me pikëpamje dhe interesa të kundërta - (1) anëtarët më pak të zhvilluar (përfshirë Republikën e Kroacisë), të ashtuquajturit Miqtë e Kohezionit, të cilët kërkojnë të forcojnë politikën e kohezionit në mënyrë që të zvogëlojnë hendekun në nivelin e zhvillimit brenda BE-së dhe (2) vendeve më të zhvilluara që e kundërshtojnë atë, me një shpjegim se ata duan të investojnë në teknologji të përparuar, Marrëveshjen e Gjelbër, sigurinë europiane, etj.

Kur bëhet fjalë për sigurinë europiane, BE nuk e ka gjetur veten në një mjedis kaq problematik për një kohë të gjatë. Qëndrimi i administratës aktuale të SH.B.A.-së ndaj BE-së është i pashembullt, si dhe ndaj sfidave të rëndësishme globale që kanë pasoja të drejtpërdrejta për BE (p.sh. marrëveshja bërthamore e Iranit, ndryshimi i klimës ...). Politikat më agresive ruse dhe kineze përballë BE-së, por edhe në Europën Juglindore, kanë një ndikim thelbësor në nivelin e suksesit të politikave të BE-së, si dhe në legjitimitetin e tij. Ekzistojnë edhe sfidat e financimit të politikave të përparuara si Marrëveshja e Gjelbër, futja e teknologjive të reja si 5G, ngritja e

populizmit dhe euroskepticizmit në Europë, etj.

E fundit, por sigurisht jo më pak e rëndësishmja, frenimi i fundit i krizës së koronavirusit që paralizoi tërë globin dhe do të ketë ndikim parësor në ekonominë botërore. Kjo u shfaq pas përcaktimit të përparësive. Prandaj, ajo nuk ka ndikuar në formulimin e tyre, por ajo tashmë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të të gjithë BE-së dhe kështu ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e tyre.

Prandaj, është një mjedis ku Republika e Kroacisë duhet të përcaktojë përparësitë e saj dhe të përpiqet të kontribuojë në zbatimin e tyre. Janë përcaktuar 4 përparësi të përgjithshme:

Një Europë që zhvillohet - Një përparësi këtu është zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë europiane. Para së gjithash, zhvillimi rajonal më i balancuar i të gjithë anëtarëve - kohezioni. Në këtë drejtim, theksi nuk është vetëm në zhvillimin ekonomik, por edhe në sigurimin e një standardi më të mirë për të gjithë qytetarët europianë, me një lidhje të drejtpërdrejtë me sfidat demografike me të cilat përballen shumica e anëtarëve të BE-së në ditët e sotme (plakja e popullsisë, ikja e trurit ...);

Një Europë që lidh - Lidhshmëria është fjala kyçe e kësaj përparësie. Fokusi do të jetë në rritjen e teknologjive moderne, infrastrukturës, veçanërisht infrastrukturës teknologjike të 5G. Fokusi këtu është gjithashtu në zhvillimin e balancuar në të gjithë vendet anëtare, si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm;

Një Europë që mbron - Fokusi këtu është në sigurinë e BE-së dhe të gjithë qytetarëve të saj, si dhe vlerat themelore të saj (liria dhe të drejtat). Një theks i madh është vendosur në përmirësimin e luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, mbrojtjen dhe përmirësimin e punëve ekzistuese të brendshme dhe sistemeve të drejtësisë, si dhe mbrojtjen e zonës Shengen.

Një Europë me ndikim - Fokusi është në forcimin e pozitës së BE-së në marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohore, përmirësimin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së, veçanërisht përbërësit e saj mbrojtës, politikat e konsolidimit të fuqizimit





në lagjen e drejtpërdrejtë - Partneriteti Lindor dhe zgjerimi në Ballkanin Perëndimor. Duke pasur parasysh pozicionin e Republikës së Kroacisë dhe interesin e saj për stabilizimin afatgjatë në rajon, një fokus i veçantë është natyrisht tek zgjerimi. Për këtë, Samiti i madh BE-BP është planifikuar (në maj 2020), me idenë për të sjellë një dinamikë të re në pranimin e Ballkanit Perëndimor në BE. Pritshmëritë janë të larta - gjatë Presidencës Kroate të Këshillit të BE-së ideja është të korrigjohen gabimet e bëra në Shqipëri dhe veçanërisht Maqedoninë Veriore dhe të hapen negociatat e pranimit me ta. Aktivitete intensive po zhvillohen në këtë drejtim. Komisioni Europian miratoi një propozim të ri për një kornizë të politikave të zgjerimit - i cili duhet t'i japë fund rezervave dhe bllokadave franceze - dhe është arritur një konsensus i gjerë politik në nivelin e BE për të bërë hapa të rinj në këtë fushë.

Presidenca është një simbolikë e madhe në prioritetet e lartpërmendur. Njëzet vjet më parë, në Zagreb, u hap për herë të parë perspektiva e pranimit në BE për vendet e rajonit dhe u fillua procesi i Stabilizim Asociimit për të gjitha vendet, përfshirë Kroacinë. Sot, njëzet vjet pas kësaj, gjatë Presidencës Kroate të Këshillit të BE-së ka një mundësi për t'i dhënë një hov të ri zgjerimit të mëtejshëm të BE-së në rajon.

Sigurisht që dëshirat janë një gjë, dhe politika e vërtetë diçka tjetër. Është e qartë se zgjerimi nuk ka qenë një temë e nivelit të lartë dhe nuk është diskutuar seriozisht në BE për shumë vite. Kjo është pikërisht një nga arsyet kryesore pse kjo politikë është ndalur për mjaft kohë. Për më tepër, kjo është arsyeja pse në këtë rajon ne mund të shohim gjithnjë e më shumë ndikimin e disa aktorëve të tjerë që nuk janë të interesuar për idenë e zgjerimit të mëtejshëm të BE-së, për të mos përmendur atë të Aleancës së NATO-s.

Tashmë është e qartë se këta aktorë po zhvillojnë një aftësi serioze për të çimentuar pozicionet e tyre në rajon dhe ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në proceset politike dhe ekonomike në këtë pjesë të Europës. Nga ana tjetër, është e qartë se forcat pro-europiane në rajon po humbasin gjithnjë e më shumë legjitimitetin, që është një pasojë e drejtpërdrejtë e procesit të bllokimit të zgjerimit.

Në këtë drejtim, mund të konkludohet se është koha e duhur që të dy palët në proces të investojnë më shumë, në mënyrë që të zhbllokojnë përfundimisht procesin. Pavarësisht nga të gjitha vështirësitë dhe ngadalësisë së procesit të pranimit në BE, ky është ende skenari i vetëm racional për konsolidimin afatgjatë të Europës Juglindore dhe përfundimin e suksesshëm të projektit madhor europian.

EMMANUEL MACRON MBI POZICIONIN E BRISHTË TË EUROPËS NË NJË BOTË ARMIQËSORE

*Presidenti francez parashtron mendimet e tij për
NATO, Sh.B.A dhe të ardhmen e BE*

Kur Emanuel Makroni zbriti nga avioni i tij presidencial në tapetin e kuq të aeroportit të Shanghait më 4 nëntor 2019, dy flamuj valëviteshën në ajrin e ngrohtë: ai kinez dhe tringjyrëshi francez. Kjo ishte e pritshme për një president francez në vizitë zyrtare, të cilit presidenti Xi Jinping i shtroi dy bankete dhe një darkë private, në dy qytete të ndryshme. Megjithatë, mungesa e flamurit të Bashkimit European ishte një kujtesë e vogël vizuale e shkallës së vështirësisë diplomatike që Z. Makron kishte marrë përsipër, pasi presidenti francez shkoi në Kinë, jo vetëm për të folur për Francën, por për Europën.

Mesazhi i Z. Makron ishte graduar me shumë kujdes. Kur kancelarja gjermane Angela Merkel u nis në shtator për në Kinë, ajo mori në avionin e saj një delegacion të madh ekzekutivësh të lartë gjermanë. Z. Makron gjithashtu fluturoi me biznesmenë francezë në Kinë dhe insistoi për një rritje më të madhe të aksesit të mallrave francezë në tregjet kineze. Për ta konkretizuar bisedën, Z. Makron dhe Z. Xi provuan së bashku Bordeaux të cilësisë më të lartë dhe copëza bifteku francez në panairin tregtar të Shangait.

Megjithatë, presidenti francez gjithashtu shkoi në Kinë “për të treguar që Europa ka një fytyrë të bashkuar”. Ai solli me vete një komisioner europian nga Irlanda, një ministër gjerman dhe përfshiu një sërë biznesesh gjermane në delegacionin francez. Në një fjalim për tregtinë, Z. Makron iu referua interesave të përbashkët të Europës, dhe thajse nuk e përmendi fare la France. Me Kinën e gatshme për të shfrytëzuar çdo ndarje europiane, Z. Makron shpresonte të dëftonte që një politikë e përbashkët strategjike, mbarë-europiane mund të ishte e mundshme.



DORËSHTRËNGIMET QË BËJNË HISTORINË

Pak kohë përpara udhëtimit të tij në Kinë, Z. Makron parashtrroi vizionin e një Europe më “strategjike” dhe më “sovrane”, në një intervistë të tijen për *The Economist*. Biseda u zhvillua mbrëmjen e 21 tetorit në Pallatin Elysée, në zyrën me dekore të praruara të presidentit, *le salon doré*, aty ku punonte dhe Charles de Gaulle. Në atë intervistë, Z. Makron është aq i zymtë mbi rreziqet që i kanosen kontinentit, sa ç’është dhe radikal në përshkrimet e tij.

“Shihni përreth ç’po ndodh në botë. Gjëra që ishin të paimagjinueshme pesë vite më parë,” deklaroi presidenti francez. “Që do të ishim duke lodhur veten mbi çështjen e Brexit; që Europa do ta kishte kaq të vështirë për të ecur përpara ; që Amerika, aleatja jonë, do të na kthente kurrizin kaq shpejt mbi çështje strategjike, askush nuk do ta kishte menduar të mundshme. Europa është buzë një gremine,” thotë ai. “Nëse ne nuk zgjohemi... ka një rrezik të konsiderueshëm që në terma afatgjatë ne do të zhdukemi gjeopolitikisht, ose që më e pakta, nuk do të jemi më në kontroll të fatit tonë. Unë e besoj këtë thellësisht.”



Që në vitet 1990, thotë Z. Makron, Bashkimi European e ka humbur gradualisht qëllimin e tij politik. Fokusi i tij në zgjerimin dhe rregullimin e tregut, i mbështetur nga garancia e mbrojtjes amerikane, jepnin iluzionin e një stabiliteti të përgjeshëm. Zmbrapsja graduale e Amerikës nga Europa dhe Lindja e Mesme, që ai e vendos në kohë përpara zgjedhjes së presidentit Donald Trump, kombinuar me proteksionizmin e ri, kanë nxjerrë në pah vulnerabilitetin e Europës.

“Mirëpo, ne e gjejmë veten për të parën herë me një president amerikan i cili nuk ndan të njëjtën ide për projektin european,” nënvizon Makron, qasja e të cilit ndaj xhihadistëve të burgosur në Siri që janë në arrati është që ata “do të arratisën drejt Europës”. Kur Z. Tramp i thotë presidentit francez që “problemi është në derën tuaj, jo timen”, thotë Z. Makron, ajo çka Tramp nënkupton është: “Zgjohuni!” Me Amerikën që i kthen shpinën, me Kinën në ngritje e sipër dhe më liderë autoritarë në dyert e Europës, rezultati është “një brishtësi e jashtëzakonshme e Europës”, përfundon Makron, “e cila nëse nuk e mendon dot veten si një fuqi globale, do të zhduket.”

“Ajo çka ne po përjetojmë,” deklaroi ai, në referencë me zmbrapsjen e trupave nga Siria është “rënia në koma e NATO-s”. I nxitur ta shtjellojë më tej këtë ide, ai argumenton se: “nuk ka kurrfarë koordinimi strategjik në vendimmarrje mes Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të NATO-s. Aspak. Ka një veprim agresiv të pakoordinuar nga një tjetër aleat i NATO-s, Turqia, në një zonë ku

preken interesat tanë.” A nënkuptonte kjo që Neni Pesë, thelbi i Aleancës – sipas të cilit, nëse një anëtar i NATO-s do të sulmohej, anëtarët e tjerë do t’i vinin në ndihmë – është ende funksional? “Nuk e di,” përgjigjet ai. “Por ç’dobi do të ketë Neni Pesë nesër?”

Mesazhi i nënkuptuar është i vrazhdë: Europa duhet të reshtë së gjykuari në këto kohëra anomalie historike, dhe të fillojë të pyesë nëse NATO është e përshtatshme për qëllimet e saj dhe të riorganizohet. Kjo është një qasje që mbështetet nga shumë bashkëkombas të tij. “Edhe nëse nuk duam t’i dëgjojmë,” thotë ai, “ne nuk mundemi që me gjithë përgjegjësinë që kemi, të dështojmë për të nxjerrë konkluzionet, ose së paku, le të fillojmë të mendojmë për to.”

PUNA E TIJ ËSHTË FILOZOFIA

Z. Makron, një i diplomuar në filozofi si dhe një ish-bankier investitor, është konsideruar si më mendimtar ndër shumë liderë të tjerë botërorë. Ai përpiqet të lexojë për një orë çdo ditë. Në Shanghai ai “rëshqiti” nga impenjimet zyrtare për një drekë private me artistët kinezë për të rrahur mendimet me ta mbi lirinë. Diskutimet e Z. Makron e shpjen atë të mbërrijë në përfundimin se ajo çka nevojitet është “soveraniteti european”: aftësia kolektive për të mbrojtur në mënyrë strategjike interesat e Europës – mbi sigurinë, privacinë, inteligjencën artificiale, informacionin, mjedisin, industrinë, tregtinë e të tjera.

Gjatë intervistës së tij, Z. Makron prek tema të ndryshme, duke u zhvendosur nga një portret psikologjik i Vladimir Putinit në një moment, në rreziqet e një ekonomie me interesa të ulët. Europa përballet me një moment thuajse ekzistencial, argumenton ai, ndërsa bota zhvendoset nga rendi global i bazuar në ligje, në një rend të përcaktuar nga fuqia politike. Megjithatë, ai nuk duket të jetë i frikësuar nga kjo. Përgjatë intervistës, ai projektonte një qasje më të ngrohtë për publikun, nga ç'prietet nga një personazh me një reputacion prej mendjemadhi si ai. Momente si ai kur Z. Makron qortoi një adoleshent që nuk iu adresua presidentit me «Zotëri» në 2018, ose një moment në 2017 kur ai tha se stacionet e trenave janë vende ku «njeriu këmbëhet edhe me ata që janë të suksesshëm, edhe me ata që nuk kanë asgjë», kanë shtuar përshtypjet e njerëzve që ai është arrogant. Dhe në të vërtetë, vrazhdësia e analizës së Z. Makron shoqërohet nga një vetëbesim i pazakontë – dhe sigurisht, i tepërt – mbi aftësinë e tij për të bërë diçka për këtë.

Mirëpo a mundet ai të bëjë diçka? Presidentët e Republikës së Pestë franceze duket se e kanë përzemër të parashtrajnë vizione gjithëpërfshirëse të botës që i kanë hije madhësisë së vendit të tyre. Përgjatë viteve, kur liderët francezë bënë thirrje për një (puissance) fuqi europiane, këto kanë tingëlluar si kode të dyshimta për ambicie hegjemoniste të Francës. Këto përpjekje në të shkuarën janë shpërfillur prej Londrës dhe Uashingtonit si të çuditshme, si nënvleftësuese për NATO-n, ose akoma më rrezikshëm, të dyja bashkë. Në vitin 2003, gjatë luftës së Irakut, kur Franca, Gjermania, Belgjika dhe Luksemburgu mbajtën bisedime mbi këto tema, takimet e tyre u shpërfillën si një “Samit çokolllatash” i dorës së dytë.

Megjithatë, ka arsye të reja që përpiqen t'i japin kuptim

opinionit që mbizotëron në Paris. Z. Makron është një diplomat energjetic, i prirur për t'i dhënë formë ngjarjeve që ai sheh të zhvillohen. Për së paku vitin 2020, dhe me gjasa edhe më tej, ai do të jetë i vetmi lider ambicioz i një demokracie liberale që është gjithashtu në krye të një fuqie bërthamore, me një prezencë ushtarake që shtrihet nga Europa në Paqësor, me një karrige në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, me fuqi ekzekutive të madhe dhe një mazhorancë të fortë parlamentare. Krahasojeni këtë me agoninë e një Britanie pas Brexit, koalicionin jofunksional të Gjermanisë dhe ekonominë ngurruese, ose paralizën politike të Italisë dhe Spanjës.

Për rrjedhojë, lidërshipi në Europë mund t'i mbetet Francës. I parazgjedhur, por dhe i prirur natyrshëm, Z. Makron është i mirë-pozicionuar për t'u bërë lideri i ri diplomatik i Europës, thotë Benjamin Haddad nga Këshilli Atlantik në Uashington, DC.

Me gjasa, Z. Makron nuk mund ta konkurrojë Znj. Merkel për nga përvoja. Por, në gjysmë-rrugë të mandatit të tij, presidenti 41-vjeçar francez ka ndërtuar marrëdhënie me shumë liderë botërorë. Qëkurse mori mandatin, Z. Makron ka kryer 101 udhëtime në 50 shtete të ndryshme, përfshirë vende (nga Nigeria në Indi) jashtë sferës tradicionale të Francës. Edhe pozicioni i tij i brendshëm ka nisur të përmirësohet, pasi mori një goditje pas marrjes së mandatit. Pas trazirave të shumta të udhëhequra nga (*gilets jaunes*) jelekverdhet një vit më parë, shkalla e pranueshmërisë së tij ndonëse mbetet ende e ulët me vetëm 34%, të paktën është kthyer në shkallën që ishte përpara se të fillonin protestat. (Z. Tramp është në shkallën e 41% dhe përgjatë tri viteve të shkuara nuk ka rënë poshtë 36%.)

Megjithatë, pavarësisht disa lëvizjeve të ngathta, Z.



Makron gëzon mundësinë e të paturit një sërë miqsh të Francës të emëruar në pozicionet më të larta të BE. Ata përfshijnë Ursula von der Leyen, kryetaren e re të Komisionit Europian; Charles Michel, presidentin e Këshillit Europian; dhe Christine Lagarde, e cila drejton tani Bankën Qendrore Europiane. Franca gjithashtu, ka siguruar një portofol të ri të majmë që përfshin tregun e përbashkët, politikën industriale, digjitale, atë të mbrojtjes dhe të hapësirës – ndonëse ai nuk mundi të sigurojë Silvi Gulard për këtë punë, pasi ajo u bë kandidatja e parë franceze që u refuzua nga anëtarët e Parlamentit Europian në Bruksel, pasi u konsiderua e papërshtatshme për postin.

Një pjesë e retorikës në Europë ka nisur të jetë në favor të Z. Makron. Znj. von der Leyen thotë që ajo dëshiron të drejtojë një komision “gjeopolitik”. Mark Rutte, kryeministri hollandez ka argumentuar se “BE i nevojitet një kontroll i realitetit: fuqia nuk është fjalë e pisët.” Znj. Merkel i ka thënë europianëve që kur vjen puna për siguri kolektive, “kanë ikur kohërat kur mund të mbështeteshim tek të tjerët.”

FLUTURIM DREJT LINDJES

Gjatë ditës së tretë të udhëtimit të tij, zyrtarët francezë ishin të gëzuar që u nënshkrua një marrëveshje për të mbrojtur markat rajonale të ushqimeve europiane, si djathi blu Roquefort – në Kinë dhe anasjelltas, dhe që Kina dukej mbështetëse mbi ndryshimet klimaterike. Por ata ishin gjithashtu të sigurtë mbi vështirësinë e zbatimit të tyre.

Kina është një test i mirë nëse Z. Makron mund ta bëjë Europën të flasë me një zë të vetëm, dhe nëse Europa do që ai zë të jetë zëri i Z. Makron. Ai e ka bërë të ditur mendimin e tij që “Kina ka treguar një mjeshhtëri të vërtetë diplomatike duke luajtur mbi përçarjet tona dhe duke na dobësuar”. Ai kërkon nga europianët që ata të jenë më pak naivë; ka argumentuar që ishte “idiotësi” shitja e infrastrukturës esenciale në Europën Jugore – Kinës. Ai dëshiron gjithashtu që BE të insistojë në reciprocitetin në tregti dhe në mbrojtjen kundër transferimeve teknologjike. Për ta mbështetur këtë me një shfaqje “muskujsh” të limituar, Franca lundron së paku dy herë në vit nëpër ujërat e Detit të Kinës Jugore.

Nevoja për një politikë të besueshme të përbashkët tingëllon e arsyeshme. Por të përpiqesh ta krijosh një të tillë, është shumë më e vështirë. Merrni parasysh ndërtimin e rrjeteve 5G të telekomunikacionit në Europë. “Duhet ta kuptoni ndjeshmërinë e çështjes për të cilën

po flasim,” thotë Z. Makron, me tonin e zërit në ngritje. Europa e ka fokusuar politikën e saj të teknologjisë mbi ekskluzivitetin në çështjet e tregut, si roaming dhe konkurrueshmëria, në sajë të mendimit strategjik, thotë ai me keqardhje. Ai mendon se europianët duhet të jenë të shqetësuar që nuk garantojnë dot që kjo teknologji kaq sensitive nuk do të jetë as kineze, as amerikane. Franca po ndërmerr hapa të kujdesshëm në shqyrtimin e investimeve në rrjetin e saj 5G. Pavarësisht një paralajmërimi nga kreu gjerman i shërbimit të inteligjencës së huaj, Gjermania ka ndërmarrë një qasje më pak kufizuese.

Në disa çështje, BE mund të bëhet më e gatshme të veprojë në atë çka Z. Makron e konsideron mënyrë strategjike. Komisioni i ri Europian mund të bëhet më mirëkuptues ndaj dëshirave franceze për të zbatuar masa globale të fuqisë tregtare për vlerësimin e shkrirjeve industriale, gjë që do të lejonte kampionët pan-europianë të shkrihesheshin. Ideja e taksës së shitjeve mbi firmat e teknologjisë, që në Francë u prezantua në korrik, që e nxiti Z. Trump të bënte një të ejet të zemëruar mbi “çmendurinë e Makron”, po merr mbështetje edhe në vende të tjera. Franca e ka bindur Gjermaninë të marrë në konsideratë edhe idenë e një takse europiane të karbonit kufitar.

JETOJMË NË KOHËRA TË VËSHTIRA

Megjithatë, pjesa më e vështirë e vizionit të Z. Makron do të përfshinte një hap ndryshimi për Europën, gjë që do të ishte tejet e vështirë nëse ndërmerret në nxitim e sipër. Kjo do të nënkuptonte konvertimin e një blloku që përdor tregun e tij për të vendosur rregulla dhe standarde - dhe i vendos masat mbrojtëse për qëllime menaxhimi krizash - në një Europë që mund të projektojë fuqi dhe të veprojë kolektivisht si forcë ushtarake. “Është shumë e vështirë,” pranon Z. Makron “që të pranojmë se Europa nuk e ka dëftuar ende besueshmërinë e saj.” Mirëpo, insiston ai, «ne po bëjmë progres dhe po ndryshojnë qasjet.»

Presidenti francez citon projektin e tij të preferuar, Nismën e Ndërrhyrjes Europiane, një koalicion shtetesh (përfshirë Britaninë), të gatshme për të vepruar së bashku në kohë krizash, si dhe marrëveshjen e bashkëpunimit të mbrojtjes së BE, që favorizohet nga gjermanët, e njohur si Pesco. Ai gjithashtu flet dhe për fondin europian të mbrojtjes për financimin e hulumtimeve dhe pajisjeve, si dhe një marrëveshje franko-gjermane për një tank të përbashkët të gjeneratës së fundit dhe një aeroplan luftarak. Të gjitha këto, thotë Z. Makron, janë “të dizenuara për të qenë asete plotësuese për NATO-n”. Nisur nga operacionet franceze anti-terroriste



në Sahel, Franca është mëse e vetëdijshme mbi nivelin e mbështetjes së Aleancës tek Amerika.

Por a është Europa vërtetë e gatshme për të ndërmarrë një transformim të tillë? “Kam dëgjuar për autonominë strategjike europiane prej shumë kohësh,” thotë Philip Gordon i Këshillit të Marrëdhënieve të Jashtme, dhe ish-këshilltar i Barack Obama. Pjesë e problemit janë shpenzimet për mbrojtjen (shihni grafikun 2). Nëse anëtarët europianë të NATO-s do të plotësonin detyrimin e tyre për të shpenzuar 2% të GDP-së së tyre për mbrojtjen deri në 2024, kjo do të thoshte që do të shpenzoheshin 102 bilion \$ më shumë – gati 40% më shumë nga shpenzimet aktuale të tyre.

Akoma më e vështirë është nevoja për të ndryshuar qasje. Gjermania mbetet mbrojtëse e status quo. Ky është një rast konservatizmi buxhetar, të cilin Z. Makron dështoi për ta ndikuar, si dhe rendit të pas Luftës së Ftohtë, ku ai dallon disa ndryshime. Gjermania është “shumë ambicioze në skenën botërore, dhe kështu një partner shumë i vështirë për Francën,” thotë Claudia Major, nga Instituti Gjerman për Çështjet Ndërkombëtare dhe të Sigurisë, një think-tank. “Ne ndihemi në mënyrë konstante që [francezët] duan diçka prej nesh, dhe që kjo është shumë bezdisëse.”

Gjermania nuk është e vetme. Në kryeqytete të tjera europiane ka njëfarë shqetësimi mbi perspektivën e lidhshimit francez dhe një ndjesi që Z. Makron është i gatshëm për bashkëpunim, përsa kohë ai të jetë sipas kushteve franceze. Këto dyshime dolën në pah me veton e tij të fundit për fillimin e hapjes së bisedimeve për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Europianët e tjerë e dënuan fuqimisht këtë akt, duke e cilësuar si një lloj mungese mendimi gjeostrategjik – pikërisht ajo çka Z. Makron akuzon të tjerët.

Kjo qasje e zemëron presidentin. Një zgjerim pa reformën e BE dhe i rregullave të pranimit është absurd, sipas tij. Nuk do ta lejonte Europën të vepronte si një bllok më i integruar. “Gjysma” e vendeve të tjera të BE, pajtohen me të lidhur me Shqipërinë, pretendon ai, por fshihen pas Francës. Dhe ai e refuzon idenë që vetoja e tij i lë shqiptarët vulnerabël ndaj fuqive rivale, duke përmendur si shembull rritjen e ndikimit rus dhe kinez në Serbi, që është vend kandidat. Nëse Europa do të reformohej fillimisht, atëherë Z. Makron thotë se to të ishte “i gatshëm për të hapur negociatat”.

Le të marrim në konideratë politikën e Z. Makron për Rusinë. Ai ka argumentuar gjithmonë se fuqitë që sillen në mënyrë të pazakonshme, janë më të rrezikshme kur janë

të izoluara. Për këtë arsyë, ai e ka ftuar Vladimir Putinin edhe në Versailles, pranë Parisit, edhe në Brégançon, në Mesdhe. Por thirrja e tij për “rapprochement” me Rusinë, me qëllim që ta mbajë atë larg duarve të Kinës, ka alarmuar Poloninë dhe vendet e Balltikut. “Ideja ime nuk është aspak naive,” argumenton Z. Makron. Ai insiston që çdo lëvizje do të ishte kushtëzuese në raport me akordet e paqes së Minskut në Ukrainë. Ai nuk ka bërë thirrje për heqje të sanksioneve. Dhe e shikon këtë si një strategji afatgjatë, për të cilën “mund të duhen dhjetë vite”. Është besimi i Z. Makron që, eventualisht, Europës do t’i duhet të përpiqet të gjejë gjuhën e përbashkët me fqinjën e saj të afërt. E kundërta do të ishte “një gabim i madh”.

HISTORIA MBAN FRYMËN

Pjesa tjetër e botës nuk është ende e sigurt si ta shohë presidentin francez. Ka një sërë aktivitete trallsëse diplomatike, me rrënjë në Paris. Këto kanë shpënë tashmë në disa shpresa të rreme, si perspektiva e takimit Iran-Amerikë, i ndërmjetësuar prej Makron. Premtimet për bisedime katërpalëshe mes Rusisë, Ukrainës, Francës dhe Gjermanisë në vjeshtë mbeten ende për t’u zhvilluar. Jo fort ndryshe nga shfaqja e tij globale prej shoëman-I dhe dorështrëngimet teatrale me liderë të tjerë botërorë, edhe politika e tij e jashtme po gjeneron interes dhe shqetësim njëherazi.

Mundet që pavarësisht gjithë përpjekjeve të tij

energjetike, ambiciet e Z. Makron për “soveranitetin europian” ndeshen me një kombinim të përçarjeve europiane, Brexit, incersisë së Gjermanisë dhe dyshimeve konstante mbi francezët. Ose, mundet të jetë sjellja e tij arrogante ajo që ia kufizon ndikueshmërinë Z. Makron. “Ai ka çdo gjë në dorë për të ndërtuar një Europë të përqëndruar mbi Francën,” thotë Ulrich Speck, i German Marshall Fund. “Në planin strategjik, ai ka të drejtë për shumë gjëra, por në planin zbatues, ai nuk punon me mjaftueshëm partner të tjerë sa për t’i vënë në jetë planet e tij.” Madje, mbetet e paqartë nëse Europa do që ta plotësojë hendekun e saj në leadership.

Megjithatë, sikurse demonstroi në vizitën e tij në Kinë, Z. Makron do ta luajë rolin nëse do i jepet mundësia. Presidenti francez mund të mos i përmbushë të gjitha zotimet që ai merr përsipër, por ai nuk shqetësohet prej atyre që e akuzojnë atë si një shtytës apo njeri të vështirë, duke e konsideruar si një rezultat të paevitueshëm të përpjekjeve për të ndryshuar rregullat. “Unë po përpiqem ta kuptoj botën siç ajo është; nuk po i jap leksione askujt. Mund ta kem gabim,” insiston ai, me një ton që lë të nënkuptohet që ai vetë as nuk e dyshon këtë gjë për asnjë sekondë. Lideri që përshkruan një të ardhme kaq të zymtë për Europën do të përpiqet të bëjë diçka pëer këtë, pavarësisht nëse të tjerët e besojnë ose jo. Sikurse shprehet për të një prej këshilltarëve të tij, Z. Makron është “një realist dhe një pragmatist, dhe ai e ekspozon veten duke ndërmarrë rreziqe. Por ai ky është. Kështu arriti të bëhej president.”



TIRANA  **TIMES**.com

UNDERSTANDING
ALBANIA



E DASHUR EUROPË

Letra nga figura të ndryshme publike

LETËR SHTËPISË

J. K. Rowling

Letra ishte e shkruar në një letër të hollë, me një ngjyrë blu të zbehtë. Shkrimi i dorës ishte i rregullt dhe i rrumbullakosur. Shoqja ime e re gjermane, nëpërmjet letërkëmbimit, Hana, e prezantonte veten me një anglishte të shkëlqyer. Shkollat tona kishin vendosur që Hana dhe unë do të ishim një çift i mirë si shoqe letrash, sepse që ta themi troç, ne të dyja, ishin peshkope. Brenda pak muajsh, unë do të shkoja të qëndroja me të për një javë, në familjen e saj, e cila jetonte në Shtutgart dhe pak kohë pas kësaj vizite, ajo do të vinte dhe do të qëndronte me mua në kufirin e Uellsit. Unë isha 13 vjeç dhe gjithçka ishte drithëruese.

Shtëpia e saj ishte e ngrohtë, pa një pikë njolle dhe mjaft ndryshe. Unë i kujtoj akoma qirinjtë zbukurues dhe qilimat mbi dyshemenë e shtruar me pllaka, mobilitet elegante dhe të projektuara bukur, si edhe pianon që shndriste në një qoshe, ku Hana sigurisht që luante

bukur. Kur mbërrita atje, nëna e Hanës më pyeti se çfarë dëshiroja për mëngjes dhe kur nuk iu përgjigja menjëherë, ajo filloi t'i rendiste të gjitha ushqimet që kishte në përdorim. Pasi përmendi një shtatë a tetë lloje ushqimesh, meqë unë kisha dëgjuar se gjermanët shin mjeshtër për kekët, i thashë: "Kek, të lutem."

Nëna e Hanës ishte një kuzhinierë e shkëlqyer. Mua më kujtohej sidomos supa e kthjellët me tul buke, salsicet me thjerrëza dhe çdo mëngjes, kur ajo më jepte kek, me sa duket sepse mendonte që unë isha mësuar me të. Ishte një gjë e mrekullueshme.

Unë i mbajta lidhjet me Hanën me vite dhe kur isha 15 vjeç, familja e saj më ftoi, me një bujari të pabesueshme, t'i shoqëroja ata gjatë një udhëtimi prej një muaj në Itali. Kështu, me Hanën dhe familjen e saj unë pashë për herë të parë Mesdheun dhe shijova për herë të parë molusqet.

Unë u ktheva nga Italia shtëpi e etur për më shumë aventura europiane. U lidha me letërkëmbim me një shoqe franceze, e cila quhej Adela, me të cilën, pas ca kohësh, shkova të qëndroj në Bretanjë. Atje pashë nënën

e saj, që bënte krepa, specialiteti i rajonit, në një *bilig*, një tigan i madh, i rrumbullakët: ato ishin gjërat më të shijshme që kisha ngrënë ndonjëherë, madje përfshi edhe karavidhet italiane. Kur isha larg syve të të rriturve, unë përfitova nga çmimi i lirë i cigareve franceze dhe fillova zakonisht tim foshnjor të pirjes së duhanit, duke u përpjekur vërtet shumë t'i pëlqejë cigaret Gitanes dhe pothuajse ia arrita.

Kur mbusha 16 vjeç, shoqja ime e ngushtë dhe unë e mbushëm mendjen për të shkuar nja dy javë në Austri me nga një çantë shpine më kurriz. Duke e hedhur vështrimin pas, unë pyes veten se çfarë menduan prindërit tanë, që na lanë të shkonim: dy vajza shkolle, me një gjermanishte të çalë, që shkonin me autobus pa pasur plane të përcaktuara dhe pa rezervuar fjetjen. Ne dolëm nga ajo përvojë pa pësuar gjë: ne i lexonim siç duhet oraret e trenave të huaj, arritëm gjithmonë të gjenim vend për fjetje, shkua në liqenet e ngrira malore nën një diell të shkëlqyer dhe udhëtuam nga njëri qytet në tjetrin, të cilët na pëlqyen shumë.

Kur u bëra më e madhe, vendosmëria ime për të kapërcyer tej Kanalit Anglez, edhe pse vetëm dhe me pak para, u shtua akoma më shumë. Sikur të kishe një biletë ndërhekurudhore, sigurisht një nga shpikjet më të mira të kohërave, thjesht, nëse nuk gjeje dot një dhomë, mund të kapje trenin tjetër ose dremisje në stacion sa të vinte treni tjetër. Kur isha 19 vjeç, u nisa vetëm për të bredhur nëpër Francë, një aventurë e cila përfundoi menjëherë pasi më vodhën kuletën.

Shumë fëmijë, përfshi edhe vajzën time të madhe, nuk do të kishin lindur pa lëvizjen e lirë që na dha Bashkimi Europian.

Gjithsesi, unë u ktheva shpejt në Paris, sepse aty kalova një vit për diplomën time të frëngjishtes. Nëna ime, një frankofone e qetë, me baba gjysmë francez, ishte e kënaqur të më vizitonte atje, kurse im atë, ndoshta më pak se ajo, pasi kishte parasysh lutjet e mia të shpeshta, të pasuksesshme, ndaj kamerierëve për të kuptuar se *biencuit*, në këtë rast do të thoshte që thela e mishit të mos kishte asnjë pikë të kuqe në mes.

Kur më vdiq nëna unë isha 25 vjeç dhe në atë moment hoqa dorë nga pretendimet se doja një lloj pune në zyrë. Atëherë fillova të bëja atë që vinte më natyrshëm: rrëmbeva dorëshkrimin e librit për fëmijë, që dukej sikur e kishte kafshuar qeni dhe u nisa përsëri përtej Kanalit Anglez. E çorientuar nga hidhërimi, kisha zgjedhur një nga tre punë e mësimdhënies, që m'i propozuan pothuajse rastësisht. Ajo punë ishte në Portugali, një vend që nuk e njihja dhe nuk dija asnjë fjalë të gjuhës së tij.

Mësimdhënia e anglishtes jashtë shtetit është një profesion mjaft i respektuar, por çdokush që e ka bërë këtë punë nuk mund të mohojë se ajo ka edhe pjesën e saj të mangësive të përshtatjes dhe të largësisë. Unë i kisha të dyja. Gjithsesi, unë rashë në dashuri me Porton dhe e dua atë akoma. Mua më magjepste *fado*-ja, muzika folklorike melankolike, që pasqyron portugezët, që, sipas përvojës sime, kishte një qetësi dhe një butësi unike mes popujve latinë, që nuk e kisha hasur deri atëherë. Urat e bukura të qytetit, brigjet e lumenjve, ku ngriheshin thikë ndërtesat antike, shtëpitë e vjetra të portit, sheshet e gjera: ato më kishin bërë për vete.

Ne të gjithë kemi kujtime të bukura nga rinia, që bëheshin prekëse sepse ngarkohen me gjërat që mund t'iu ndodhin më vonë bashkudhëtarëve apo se çfarë gjendet para nesh. Atëherë ne ishim të lirë të bridhnim nëpër Europë, me një mënyrë që na formonte dhe na pasuronte, ndërkohë që përfitonim nga paqja e pandërprerë, aq e gjatë, sa ky kontinent nuk e kishte njohur më parë. Miqësitë afatgjata, lidhjet e dashurisë dhe martesat nuk mund të kishin ndodhur asnjëherë. Disa fëmijë që njihja unë, përfshi edhe vajzën time të madhe, nuk do të kishin lindur pa lëvizjen e lirë që na dha Bashkimi Europian.

Tani që po shkruaj këtë letër, është e pasigurt nëse brezi tjetër do t'i gëzojë ato liri që kishim ne. Ata, si puna ime, që e dinë me saktësi se sa humbje e thellë është kjo, po përjetojnë një ndjenjë të humbjes, me një ankth të madh për rrezikun e prishjes së lidhjeve të vjetra.

Unë mendoj përsëri për shoqen time adoleshente të letrave, Hanën, teksa shoh një citat nga Volteri. Ajo zor se më la të largohesha pa ndonjë gjë, ndaj ndoshta do të më kishte akuzuar për zgjedhjen e një filozofi francez me një frymë të pastër provokimi.

Nejse, Hana kishte të drejtë për shumë gjëra, por këtu do ta kishte gabim. E vërteta është se unë po mendoj për atë tani, sepse ajo ishte shoqja ime e parë nga Europa kontinentale dhe sepse fjalët e Volterit, që kanë aq shumë kuptim për mua tani, janë këto: "*L'amiéest la patrie*". "Ku ka miqësi, ka atdhe." Po Hana, unë nuk dua ta humbas vërtet atdheun tim.

NË RADHËN E PASAPORTAVE

Jeffrey Boakye

Kjo ndodh gjithmonë në aeroport. Në radhën e pritjes për të treguar pasaportën dhe për t'u lejuar të hysh në vendin në fjalë, me një varg mendimesh që të shkojnë nëpër mendje tende me shqetësimin se a

do të pranojnë dhe si do të presin. Në hapin e fundit ndihesh ndryshe, shumë ndryshe, duke u kapur pas identitetit tënd britanik, me pasaportën me kapak lëkure të kuqe, me shpresën se do të të mbajë optimist në ujëra të panjohura. Ai është momenti kur ndihesh goxha larg shtëpisë; ngjyra e gabuar, në vendin e gabuar, me një gjuhë të gabuar dhe me ndjenjën e një kokteji të gabuar shqetësimesh.

Por pastaj shkon te sporteli dhe ndodh diçka. Aty gjen një buzëqeshje apo një bisedë të shkurtër apo një koment - një lloj shkëmbimi, që të kujton se i përket të paktën këtij momenti. Ai nuk është gjithmonë agresion apo dyshim. Ajo hera herës është mikpritje. Ti i mbledh ato momente, sepse janë mjaft të çmuara. Dhe pastaj shpreson se ato nuk do të jenë të rralla.

MBRËMJA E VITIT TË RI NË BERLIN

Shami Chakrabarti

Ishte fundi i viteve 1980 dhe i pushimeve të mia pas studimeve juridike në LSE. Unë punoja si marrës porosish në një kafene në *Golders Green*. Koleta ishte menaxherja jonë dhe na përshëndeste nga Irlanda. Francezet Sara dhe Maria prisnin tavolinat dhe kishte edhe shumë të tjerë emrat e të cilëve fatkeqësisht ishin harruar. Unë kisha lindur në Londër me prindër indianë, por ne të gjithë ishim të rinj londinezë plot kureshtje për qytetin tonë dhe botën e madhe përtej nesh. Ne e kalonim kohën e lirë së bashku, në dhomat e gjumit apo nëpër shtëpi.

Pastaj një ditë, Sara u mërzit shumë apo e kishte marrë malli për shtëpinë. Ajo po nisej për në shtëpinë e nënës në jug të Francës, kurse unë isha i ftuar. Unë kisha qenë disa herë në Paris, dija frëngjisht dhe kisha lexuar pak nga Kamy, Sartri dhe De Beauvoir. Megjithatë nuk ka si mundësia për të qëndruar në një familje, të kesh ushqimin e tyre, historitë dhe strehën e tyre. Ajo mirësi, që u përsërit shumë herë në vitet që pasuan, më ndihmoi për t'u formuar.

Disa muaj më vonë, Ania, një shoqe gjermane dhe bashkëstudente e drejtësisë, ftoi disa prej nesh për herë të parë në shtëpinë e saj në Frankfurt dhe pastaj ne Berlin për të festuar Mbrëmjen e Vitit të Ri. Hej, çfarë nate! Gjatë ditës kishte lloj-lloj kufizimesh se si të kaloje nëpër Portën e Brandenburgut apo Pikën e Kontrollit Çarli, në varësi të shtetësisë. Kur po afrohej mesnata, numrat e mëdhenj të njerëzve e bënë kontrollin të vështirë. Unë

e pashë veten të rrethuar nga njerëzit dhe pastaj, disa momente më vonë, gjendesha në pjesën lindore. U ktheva në shtëpi në Londër me fragmente të bukura grafiti nga muri i dikurshëm, ndarës, që nuk ekzistonte më.

NUK DO TË ECNI KURRË VETËM

Frank Cottrell Boyce

E dashur Europë,

A të kujtohet ajo kohë në vitin 1973, kur Xhaxha Billi shkoi për të parë *Liverpulit* që mundi Borussia Mönchengladbach 3-2 në finalen e Kupës UEFA? Pas ndeshjes, policia prusiane çoi mijëra tifozë të çmendur në aeroplanët që i prisnin. Vetëm kur mbërriti në Aeroportin e Liverpulit, Billit iu kujtua se kishte shkuar në ndeshje me furgonin e vet. Furgoni, siç shpresonte ai, duhej të ishte akoma i parkuar nën hijen e panjave në Bunter Garten, një mijë milje larg.

Ajo natë ishte fillimi i dashurisë sonë me Europën. Deri atëherë, vështrimi i Liverpulit ishte i hedhur tej - përtej detit në Irlandë, Nju Jork, Valparaiso - te rrugët e vjetra detare që kishin përshkuar etërit tanë, që ktheheshin me majmunë dhe papagaj, që luani nëpër ballkonet tona shumë kohë pasi ajo tregti ishte mbyllur.

Futbolli e hodhi Europën në zemrat tona. Liverpuli ndihej shpesh i shkëputur nga pjesa tjetër e Anglisë, por futbolli na lidhi me Europën si një pasaportë me vlerë. Të rinj që zor se kishin shkuar përtej lagjeve të tyre u bënë të njohur me rrugët e autobusëve dhe metrotë e Parisit, Romës, Amsterdait dhe sigurisht edhe Munshengladbahut. Mua më kujtohet kur rrija në Qendrën Irlandeze të Liverpulit një mbrëmje, kur një turmë tifozësh të gëzuar holandezë me bluza portokalli thoshin: "Irlandez?! Ne jemi me ju. Portokall dhe Jeshi, apo jo?" Sikur në Irlandë portokallia dhe jeshilja të ishin dy ngjyra që shkonin mirë së bashku, si stemat e gjakmarjes së lashtë. Çdokush i përshëndeste dhe iu jepte birra. Unë përfundova duke çuar katër prej tyre në stadium.

Unë kam jetuar në Francë dhe në Spanjë. Kam punuar në Itali. Por jam kthyer gjithmonë në vendlindjen time. Jam rrënjësor, siç thuhet "në vendin tim të dashur". Por në zemrën time mbaj një të vërtetë, që udhëheqësin tanë të tanishëm përpiqen ta fshijnë - të vërtetën që nuk mund t'ia kushtosh veten një vendi, kur zbulimi, në fakt, pjesë e një gjeje më të madhe, se ne nuk do të ecim kurrë vetëm.

Dashuri dhe puthje nga Liverpuli.

LETRA IME E DASHURISË PËR BRITANINË: MARRËDHËNIET FAMILJARE NUK MUND TË SHKËPUTEN

*Qëkurse shkoja në një shkollë britanike, ti ke qenë pjesë e imja.
Tani po largohesh dhe po më thyen zemrën.*




FRANS TIMMERMANS¹

Kam lexuar së fundmi një libër të këndshëm me letra dashurie për Europën. Dhe më solli ndër mend dashurinë time për Britaninë. Sapo m'u kujtua që kur ti iu bashkove Komunitetit Ekonomik European, unë isha në një prej shkollave të tua. Sa për dijeni, jo në tokën tënde por në Itali. Në Shkollën Ndërkombëtare të Shën Xhorxhit, për të qenë më preciz. Isha 12 vjeç atëherë dhe isha ende duke mësuar

¹ Frans Timmermans is executive vice-president of the European Commission.

anglishten. Atë vit, u veshja me kimono, si një orej “zotërinjve nga Japonia” tek Mikado, shfaqja teatrale e shkollës. Znj. Alkok më nxiti të mos këndoje me shumë zë të lartë, që të mos ndiheshin notat e mia false. Por më mbajti në skenë. E adhurova. Ashtu sikurse e adhurova dhe të qenurit pjesë e korit në “Zonja ime e bukur” vitin tjetër dhe rolin e Breshkës Përçeshëse në “Liza në Botën e Çudirave” në vitin pasardhës.

Kanë kaluar më shumë se 40 vite që atëherë. Kaq shumë gjëra kanë ndodhur. Familja ime u kthye në Hollandë, ku unë studiova – gjithashtu dhe në Francë. U martova dhe u bëra baba, kryeva shërbimin ushtarak, punova si diplomat, u divorcova dhe u martova sërish, u



zgjodha në parlament, shërbeva në qeveri dhe jam tani në Komisionin Europian. Britania ka qenë gjithmonë aty, si pjesë e imja. Të qenurit në një prej shkollave të tua më bëri më hollandez nga ç'kisha qenë ndonjëherë më parë. Por njëkohësisht, kjo lloj shkrirjeje lë gjurmë. Ajo çka ti thith e absorbon mbetet: si një shtresë e dytë që është shkrirë pjesërisht me shtresën ekzistuese dhe mbetet pjesërisht e veçueshme dhe unike.

Unë të njoh tani. Dhe të dua. Për atë çka je dhe për atë që më ke dhënë mua. Unë jam si një dashnor i vjetër. T'i di pikat e tua të dobëta dhe ato të fortat. E di që mund të jesh zemërgjerë po gjithashtu dhe dorështrenguar. E di që e mban veten për unike dhe ndryshe nga të tjerët, Dhe sigurisht e tillë je në shumë mënyra, po ndoshta më pak nga ç'e mendon. Nuk do reshtës së na referuari ne të tjerëve si "kontinenti". Të ndihmon të krijosh distancën që ti mendon se të nevojitet. Por gjithashtu të pengon për të parë që të gjithë ne na nevojitet pak distancë nga njëri-tjetri. Të gjithë kombët europiane janë unike. Diferencat tona janë burim admirimi, surprize, sikleti, keqkuptimesh, talljeje, karikature dhe po, dashurie.

Në kohërat më të mira, këto dallime na bëjnë një ndër familjet më krijuese, produktive, paqësore dhe më të suksesshmen. Në ditët tona më të këqija, dallimet tona përdoren kundra nesh për të mbjellë frikë, për të përhapur superioritetin, dhe për të ndërsyer një anëtar të familjes kundra një tjetri. Atëherë gjërat dalin jashtë kontrollit. Ne jemi gjithashtu shumë, shumë të mirë për këtë gjë. E kemi të trashëguar. Këta jemi! Dhe si familje e kemi për detyrë t'i bëjmë jehonë kohërave të mira dhe t'i ruhemi kohërave të këqija. Deri më tani, me gjithë gabimet e saj, BE ka qenë mjeti më i suksesshëm për ta arritur atë qëllim.

Ti ke vendosur të largohesh. Dhe kjo gjë më thyen zemrën, por e respektoj atë vendim. Ishe e dyzuar për këtë, sikurse ke qenë ngahera me dy mendje për BE. Do të doja t'i kishe qëndruar kësaj qasjeje, të shërbente më së miri dhe na mbante në formë të gjithë ne të tjerët. Ishte vërtetë e nevojshme ta imponoje këtë çështje? Aspak. Megjithatë, ti e bëre. Dhe gjëja më e trishtë është se e shoh që po të lëndon. Sepse dy mendjet do të jenë akoma aty, edhe pasi të kesh ikur. Gjatë këtij procesi të është bërë kaq shumë dëm i panevojshëm, sikurse dhe të gjithë neve. Dhe kam frikë se akoma më shumë dëm do të pasojë.

Ç'është e vërteta, u lëndova shumë kur vendose të largohesh. Tre vite më vonë jam thjesht i pikëlluar që një anëtar i familjes sonë dëshiron t'i presë marrëdhëniet. Por në të njëjtën kohë, ngushëllohem me mendimin se lidhjet familjare nuk mund të shkëputen kursesi. Ne nuk po ikim asgjekundi dhe ti do të jesh gjithnjë e mirëpritur të kthehesh sërish.



SHTATË MËSIMI NGA KORONAVIRUSI

Kriza e Covid-19 do të riformësojë në mënyrë dramatike reagimin e BE ndaj të gjitha krizave të tjera me të cilat është përballur në dekadën e fundit.

IVAN KRASTEV

Sa kohë të çuditshme po jetojmë”, më shkruante dje një miku im spanjoll. Dhe të çuditshme janë vërtet. Ne nuk e dimë se kur do të përfundojë pandemia Covid-19; nuk e dimë si do të përfundojë; dhe, për momentin, ne vetëm mund të spekuojmë për ndikimin e saj afatgjatë, politik dhe ekonomik. Në një kohë krize, ne jemi të infektuar nga pasiguria. Por ka të paktën shtatë gjëra që e bëjnë këtë krizë, shumë të ndryshme nga ato të mëparshmet.


Mësimi i parë është se, ndryshe nga kriza financiare e viteve 2008-2009, koronavirusi do të imponojë kthimin e Big Government (qeverisë së fortë). Pas rënies së Lehman Brothers, shumë vëzhgues besuan se mosbesimi tek tregu që shkaktoi kriza, do të çonte në një besim më të madh tek qeveria. Ky koncept nuk ishte asgjë e re: në vitin 1929, pas fillimit të Depresionit të Madh, njerëzit kërkuar ndërhyrje të fortë të qeverisë për të kompensuar dështimet e tregut. Në vitet 1970, ndodhi e anasjellta: njerëzit ishin të zhgënjyer nga ndërhyrja e qeverisë, kështu që filluan të besojnë përsëri tek tregu. Paradoksi i vitit 2008-2009 është se mosbesimi në treg nuk çoi në kërkesën për ndërhyrje më të madhe të qeverisë. Tani, koronavirusi do ta rikthejë fort qeverinë. Njerëzit mbështeten tek qeveria për të organizuar një mbrojtje kolektive kundër pandemisë, dhe ata mbështeten tek qeveria për të shpëtuar një ekonomi që po fundoset. Efektiviteti i qeverive tani matet nga aftësia e tyre për të ndryshuar sjelljen e përditshme të njerëzve.

Mësimi i dytë është që koronavirusi ofron një tjetër demonstrim të mistikës së kufijve, dhe do të ndihmojë në rishfaqjen e rolit të shtetit-komb brenda Bashkimit Evropian. Dikush mund ta shohë tashmë këtë gjë, në mbylljen e shumë prej kufijve midis shteteve – dhe në faktin se çdo qeveri në Evropë është përqëndruar tek populli i vet. Në rrethana normale, shtetet anëtare nuk

do të bënin asnjë dallim midis kombësive të pacientëve në sistemin e tyre shëndetësor, por, në këtë krizë, ata ka të ngjarë t’u japin përparësi të shtetasve të tyre mbi të tjerët (nuk flas këtu për emigrantët nga rajone të tjera, por evropianët me pasaporta të BE-së). Prandaj, koronavirusi do të forcojë nacionalizmin, megjithëse jo nacionalizmin etnik. Për të mbijetuar, qeveria do t’u kërkojë qytetarëve të ngrenë mure jo vetëm midis shteteve, por midis individëve, pasi rreziku i infektimit vjen nga njerëzit që takohen më shpesh. Nuk është i huaji por ata më pranë jush, që paraqesin rrezikun më të madh.

Mësimi i tretë i koronavirusit lidhet me besimin tek ekspertiza. Kriza financiare dhe kriza e refugjatëve në vitin 2015 krijuan një pakënaqësi të madhe tek ekspertët. Kjo tendencë, e cila ka qenë një nga sukseset kryesore të politikanëve populistë në dhjetë vitet e fundit, do të zhbëhet nga koronavirusi. Shumica e njerëzve janë shumë të hapur për t’u besuar ekspertëve dhe t’i kushtojnë vëmendje shkencës, kur jeta e tyre është në rrezik. Dikush mund të vërejë legjitimitetin në rritje që kjo u ka dhënë profesionistëve që udhëheqin luftën kundër virusit. Profesionalizmi është rikthyer në modë.

Mësimi i katërt është i hapur për interpretim, por megjithatë shumë i rëndësishëm. Fatkeqësisht, koronavirusi mund të rrisë joshjen prej autoritarizmit të Big Data, që janë përdorur aq shumë në këtë krizë nga qeveria kineze. Dikush mund të fajësojë udhëheqësit kinezë për mungesën e transparencës që i bëri ata të reagojnë ngadalë ndaj përhapjes së virusit, por efikasiteti i reagimit të tyre dhe aftësia e shtetit kinez për të kontrolluar lëvizjen dhe sjelljen e njerëzve, kanë qenë mbresëlënëse. Në krizën aktuale, qytetarët krahasojnë vazhdimisht përgjigjet dhe efektivitetin e qeverive të tyre me ato të qeverive të tjera. Dhe nuk duhet të çuditemi nëse, një ditë pas krizës, Kina duket si një fituese dhe Shtetet e Bashkuara duken si humbëse.





Mësimi i pestë ka të bëjë me menaxhimin e krizave. Ajo që mësuam qeveritë në trajtimin e krizave ekonomike, krizës së refugjatëve dhe sulmeve terroriste, ishte se paniku ishte armiku i tyre më i keq. Nëse, për muaj të tërë pas një sulmi terrorist, njerëzit ndryshonin sjelljen e tyre të përditshme dhe nuk largoheshin nga shtëpitë, kjo do t'i ndihmonte terroristët të arrinin qëllimet e tyre. E njëjta gjë ishte e vërtetë në vitet 2008-2009: një ndryshim në sjellje shpesh rriti kostot e krizës. Kështu, udhëheqësit dhe qytetarët u përgjigjën me mesazhe për të “ruajtur qetësinë”, “vazhduar me jetën”, “injoruar rrezikun” dhe “mos tepruar”. Tani, qeveritë duhet t’u tregojnë qytetarëve që të ndryshojnë sjelljen e tyre, duke qëndruar në shtëpi. Suksesi i qeverive në këtë gjë, varet shumë nga aftësia e tyre për të trembur njerëzit të bëjnë siç udhëzohen. “Mos u frikëso” është mesazhi i gabuar për krizën e Covid-19. Për të frenuar pandeminë, njerëzit duhet të panikosen – dhe ata duhet të ndryshojnë në mënyrë drastike mënyrën e të jetuarit.

Mësimi i gjashtë është se kriza Covid-19 do të ketë një ndikim të fortë në dinamikën e brezave. Në kontekstin e debateve për ndryshimin e klimës dhe rrezikun që ai paraqet, brezat e rinj kanë qenë shumë kritikë ndaj të moshuarve, duke i akuzuar se kanë qenë egoistë dhe nuk kanë menduar seriozisht për të ardhmen. Koronavirusi e anulon këto dinamike: tani, anëtarët e moshuar të shoqërisë janë shumë më të prekshëm dhe ndjehen të kërcënuar nga mosgatishmëria e dukshme e të lindurve

në fillimin e mijëvjeçarit, për të ndryshuar mënyrën e tyre të jetesës. Ky konflikt ndërbreznor mund të intensifikohet nëse kriza zgjat për një kohë të gjatë.

Mësimi i shtatë është se, në një pikë të caktuar, qeveritë do të detyrohen të zgjedhin ndërmjet frenimit së përhapjes së pandemisë me koston e shkatërrimit të ekonomisë, ose tolerimit të një kostoje më të lartë njerëzore, për të shpëtuar ekonominë.

Ende jemi shumë herët për të speculuar mbi ndikimin politik të Covid-19. Kriza ka justifikuar frikën e anti-globalistëve: aeroportet e mbyllura dhe individët e izoluar duket se janë “ground zero” të globalizimit. Por, në mënyrë paradoksale, ky moment i ri anti-globalist mund të dobësojë aktorët politikë populistë, të cilët, edhe kur kanë të drejtë, nuk kanë zgjidhje. Kriza e Covid-19 gjithashtu do të riformulojë në mënyrë dramatike reagimin e BE ndaj të gjitha krizave të tjera me të cilat është përballur në dekadën e fundit. Disiplina fiskale nuk është më mantra ekonomike as edhe në Berlin, dhe nuk ka asnjë qeveri evropiane që, në këtë moment, dëshiron të mbrojë hapjen e kufijve për refugjatët.

Mbetet të shihet se si saktësisht kriza do të ndikojë në të ardhmen e projektit Evropian. Por është e qartë se, në fund të fundit, koronavirusi do të vërë në dyshim disa nga supozimet themelore mbi të cilat është themeluar BE-ja.

Botuar më parë nga Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë – Bota. al



FANTAZMAT E SË SHKUARËS KËRCËNOJNË TË ARDHMEN E PËRBASHKËT TË EUROPËS

CONSTANZE STELZENMÜLLER


Tregohej një anekdotë e famshme në epokën sovjetike. Një dëgjues telefonon *Radio Jerevanin* për t'u drejtuar një pyetje: "A është e mundshme," pyet ai, "të parashikohet e ardhmja?" I përgjigjen: "Po, sigurisht. Ne e dimë saktësisht si do të jetë e ardhmja. Problemi e kemi me të shkuarën: e shkuara na ndryshon vazhdimisht." Vitin e shkuar, përvjetori i revolucioneve të 1989-s të cilët i dhanë fund regjimit komunist në Europë, shërbeu si një kujtesë sesi e shkuara mund të transformohet. Episode të errëta të historisë që mendoheshin të ishin goposur, iu kthyen sërish opinionit publik si të ishin antagonistë të pavdekshëm.

Dhënia e çmimit Nobel për Letërsinë autorit Peter Handke shkaktoi valë zemërimi nëpër Ballkan dhe më gjerë. Austriaku mbahet si një prej shkrimtarëve më të mirë të ditëve të sotme të gjuhës gjermane. Mirëpo, ai

ka zvogëluar vrasjet në masë të myslimanëve prej serbo-boshnakëve gjatë luftërave jugosllave të viteve 1990. Ai mbajti një fjalim në varrimin e Slobodan Milloshevic, presidentit të Serbisë gjatë kohës së luftës, i cili vdiq ndërsa ishte në proces gjyqësor për krime lufte. Në një reagim të zemëruar, shkrimtari boshnjako-amerikano Aleksandar Hemon e quajti Z. Handke "Bob Dilani i apologjetëve të genocidit".

Në Gjermani, një çift i pasur sipërmarrësish teknologjik blenë *Berliner Zeitung*, një gazetë ish-gjermano-lindore. Në një numër special që përkoi me 30-vjetorin e rënies së Murit të Berlinit, Holge dhe Silke Friedrich, të lindur në Gjermaninë lindore, shokuan shumë lexues me një editorial ku nxisnin një rivlerësim gjithëpërfshirës të së shkuarës dhe së tashmes së vendit të ribashkuar.

Më vonë rezultoi që Z. Friedrich kishte qenë një informator për Stasi-t, policinë e frikshme sekrete gjermano-lindore. Një ekzaminim i hollësishtëm i dosjes së tij nga ish-kreu i arkivave të Stasi-t dhe një historian, e



cilësonte bashkëpunimin me Z. Friedrich si të shkurtër, hezitues dhe më së shumti jo-produktiv. Megjithatë u theksua që dokumentat e disponueshme nuk e tregojnë kurrësi në mënyrë të besueshme historinë e plotë.

Manifestoja e Friedrichs-ëve ishte ndoshta zbulimi më shpërthyes. Manifestoja fajësonte mungesën e vullnetit të Perëndimit për t'i "mbajtur dorën" presidentit rus, Vladimir

Putin, për aneksimin e Krimesë dhe luftën në Ukrainën lindore. Ata argumentonin gjithashtu se gjermanët duhet t'i ishin mirënjohës Egon Krenz, liderit të fundit komunist të Republikës Demokratike Gjermane, për faktin që nuk dha urdhër të qëllohej mbi protestues paqësorë.

Disa prej burrave më të fuqishëm të botës e kanë kthyer në sport lojën me faktet, kohët e fundit. Në konferencën e tij vjetore, maratonë, me mediat në mes të dhjetorit, Z. Putin mbrojti paktin e neutralitetit Molotov-Ribbentrop të 1939 mes Rusisë dhe Gjermanisë, me pretendimin e pavërtetë që Bashkimi Sovjetik ka qenë shteti i fundit në Europë që nënshkroi një pakt jo-agresioni me Gjermaninë naziste.

Z. Putin gjithashtu ndau qëndrimin e tij mbi nxjerrjen para gjyqit të Presidentit amerikan Donald Trump, për të cilin tha: "sipas mendimit tim, gjykimi i tij po bëhet për arsye plotësisht të fabrikuara" – një citim ky i përdorur dhe nga Z. Trump në një tweet triumfant ku e cilësonë gjykimin e tij si "Një gjueti shtrigash!" Sakaq databaza e verifikimit të fakteve e *Washington Post* numëron aktualisht "15413 pretendime false apo çorientuese në harkun kohor të 1055 ditëve" prej Z. Trump.

Fjalimi i pranimit të Çmimit Nobel të Z. Handke në Stokholm mund t'i avitej aq shumë politikës sa që iu afrua fushës dhe me aforizmat përkatës ("tregoji ngjyrat e tua të vërteta derisa ta vërtetosh që ke të drejtë" tha ai). Por për kritikët e tij me përvojë, kjo deklaratë përsëriste tropin e pesimizmit kulturor që përshkon veprën e tij: i cili ka në thelb natyrën si burimin e vetëm të së vërtetës, jetën e fshatit si bërthamën e përkatësisë dhe korrupsionin e jetës moderne.

Megjithatë pati dhe një Nobel të dytë në letërsi që u dha atë natë. Vitin e shkuar, academia suedeze e shtyu dhënien e çmimit për shkak të një skandali ngacmimi seksual. Prandaj, vitin që shkoi, çmimi i vitit 2018 në Letërsi iu dha shkrimtares polake Olga Tokarczuk, e cila është kërkeshur me nacionalistët e vendit të saj mbi çështje si ksenofobia dhe anti-semitizmi. Në fjalimin e saj Nobel, Znjsh. Tokarczuk trajtoi problemin e thënies së të vërtetës në mënyrë të drejtpërdrejtë. Fragmentimi kulturor, tha ajo, rrezikon të na kthejë në "ndjekës të forcave të thjeshta: qofshin këto fizike, shoqërore apo ekonomike – dhe që na diktojnë lëvizjen, si të ishim zombi".

Megjithatë, argumentoi ajo, krizat klimaterike dhe politike të cilat ne po dëshmojmë ditët e sotme nuk janë rezultat i "kapriçove të fatit", por janë pasojat e vendimeve të marra nga njeriu. Organizimi i fakteve, përcaktimi i shkakut dhe pasojës, shtoi ajo, është detyrë e shkrimtarit – por varet gjithashtu dhe sesi shoqëritë e rimarrin veten nga një e shkuar e përbashkët dhe sesi reagojnë përballë mundësisë së një të ardhmeje të përbashkët.



SECILIT NDONJËHERË

Secilit ndonjëherë i vdes ndonjë i afërt,
midis të qenit dhe të mos qenit
detyrohet të zgjedhë këtë të dytën.

Vështirë të pranohet si një fakt banal (ta
pranojmë se ky është një fakt banal),
që përfshihet në rrjedhën e ngjarjeve,
në përputhje me procedurën;



herët a vonë në rendin e ditës
të mbrëmjes, të natës ose agimit të zbehtë;

e qartë si parulla në indeks,
si paragrafi në kodeks,
siç është e para e mbarë
është data në kalendar.

E tillë është ligjësia dhe paligjësia e natyrës.
I tillë, si të ndodhë, është amen dhe amin i saj.
Se e tillë është evidenca dhe onnipotencia e saj.

Vetëm nganjëherë
mirësjellja e saj e vakët -
për të afërmit tanë të ndjerë na fut në gjumë.

Wisława Szymborska



POEZI



KOHA E SHKRIMEVE

ISMAIL KADARE

Qysh se kishim nisur të bënim vjersha me Ilirin, me mësimë nuk shkonim mirë. Veçanërisht e filluam keq javën e dytë të semestrit. Ishte vërtet një ditë e mbrapshtë për të dy ajo e martë. Që orën e parë mora një dysh në aritmetikë dhe në pushim po rrija i mërziur në një kënd, kur erdhën çunat e klasës tjetër për të na njoftuar se mësues Nastoja kishte bërë prapë gabim politik në mësim, duke thënë se në Amerikë ka stepa. Atyre u kishte shpëtuar pa e kritikuar, por ne, po të kishim mendjen, mund ta bënim këtë, meqenëse orën tjetër kishim gjeografi.

Dy javë më parë, sekretari i rinisë, Arturi ose Turi, siç e thërritnin të gjithë, na kishte mbledhur edhe ne të vegjlit për të na thënë se duhej



të ishim syçelë, meqë një pjesë e mësuesve, si borgjezë që ishin, flisnin prapësira në mësim.

I zemëruar siç isha ende nga dyshi i porsamarrë (Turi na kishte dhënë të kuptonim se një pjesë e dyshave mund të viheshin pa të drejtë prej mësuesve), kur në orën e gjeografisë zoti Nasto tha fjalët, që ne të gjithë po i prisnim: “në Amerikë ka stepa të gjera”, unë ngrita dorën.

- Me leje?

Mësuesi i gjatë dhe me fytyrë mospërfillëse ktheu kryet nga banka ku unë rrija me Ilirin.

- Hë! - tha ai. - Ç'pate?

Unë u gëlltita me vështirësi.

- Në Amerikë nuk ka stepa, zoti mësues. Stepa ka vetëm në Bashkimin Sovjetik.

Sytë e mësuesit u egërsuan, pastaj një dritë shpotitëse e përshkoi egërsimin.

Tregimi “Koha e shkrimeve” është botuar në “Zërin e Rinisë” më 31 mars 1984 dhe ka fituar çmim të parë vjetor të gazetës.

- Pa shih, pa shih, - ia bëri ai. - E ç' do të thuash me këtë ti, mistrec?

Iliri, përbri meje, u ngrit, gjithashtu.

- Stepa ka vetëm në Bashkimin e madh Sovjetik, - tha dhe ai me një zë të mbytur koke.

Mësuesi, me hapa të gjatë erdhi drejt nesh dhe na kapi të dyve nga veshët. Pastaj na afrooi kokat, duke na i cikur me njëra-tjetrën.

- Se ku ka stepa e ku ka male, atë e di unë, morët vesh, majmunë, - tha ai, pa na i lëshuar veshët.

Në klasë u bë zhurmë. Ca zëra u ngritën në mbrojtjen tonë, por mësuesi ulëriu: "Qetësi!" dhe në klasë ra heshtja.

Në pushim gjysma e klasës vrapoi te Turi për t'i treguar ç'kishte ndodhur. Turi, nervoz siç ishte, ndërta dëgjonte, kafshonte gishtat.

- Sabotim, - thirri ai, më në fund, dhe shkëputi një fletë nga blloku. Sipër saj shkroi shpejt e shpejt disa fjalë, midis të cilave ne dalluam fjalën "sabotim" dhe na tha që ta çonim me vrap në Komitet të Rinisë.

U nisëm. Iliri, unë dhe një djalë tjetër. E dorëzuam letrën atje ku na tha Turi dhe, duke dihatuar me vështirësi, pritëm përgjigjen, domethënë një copëz letër tjetër, që na e dhanë sakaq.

Rrugës, Iliri u bë kureshtar dhe e hapi ta lexonte. Për habinë tonë, në të nuk kishte ndonjë sharje kundër mësuesit të gjeografisë, gjë që na dëshpëroi. Por më shumë na dëshpëroi fundi i pusullës: "Shoku Artur, mos harro se të kemi kritikuar edhe një herë tjetër për sektarizëm".

Kur mbërritëm në shkollë, mësimi kishte filluar, por Turi na tha se kishte lajmëruar mësuesin e botanikës për vonesën tonë. Ne ia dorëzuam pusullën dhe vrapuam në klasë.

Zoti Vehap, që jepte botanikën dhe historinë, ishte imcak, i lëvizshëm

dhe, ndryshe nga mësuesit e tjerë, pothuajse çdo mësim e lidhte me kohën e sotme. Edhe përgjigjet tona ashtu i kërkonte. Mezi i durohej që ne, pasi flisnim për drurët, avullimin e ujit apo për kryengritjet fshatare të bënim krahasimin midis kohës së vjetër dhe së sotmes. Kur ndokush e vononte këtë, ai ngrihej nga tryeza, lëvizte, vinte rrotull dhe, së fundi, pasi afronte dy pëllëmbët e mbledhura si kupë me njëra-tjetrën, thoshte me padurim: "tani lidhe, lidhe pak".

Ende merrja frymë me zor nga gjithë ai vrap, kur ai thirri emrin tim dhe unë u ngrita.

- Na fol ti, djalë, për asimilimin klorofilian.

U hutova në çast. Krallëherë më kishte ndodhur që të mos më vinte ndër mend pothuajse asgjë nga mësimi. Më kujtohej vetëm që kishte lidhje me blerimin, me pemët dhe asgjë tjetër. Por ndoshta s'kisha faj. Gjithë ai vrap, ajo tërheqje nga veshët, për të mos përmendur dyshin në aritmetikë, ma kishin bërë kokën dhallë.

- Asimilimi klorofilian, - fillova të belbëzoja unë, duke u përpjekur të gjeja diçka sa të vinte çasti shpëtimtar kur zoti Vehap të më thoshte: "tani lidhe", se pastaj dija vetë si të flisja. - Asimilimi klorofilian, domethënë dihet që blerimi i pemëve dhe i drurëve, si dhe i bimëve të tjera...

- Vazhdo... - tha mësuesi.

Unë u gëlltita disa herë.

- Këto të gjitha, domethënë pemët, si dhe bimët, si dhe lulishtet, janë të gjelbra, sepse këto...

- He, - tha zoti Vehap, - sepse këto...

- Sepse këto... ushqehen nga toka dhe janë të gjelbra.

Mësuesi ngriti supet.

Dreq o punë, thashë me vete, duke e ndier që nuk u kënaq.

- Kur hedhim sytë në natyrë, - fillova të flisja prapë dhe zoti Vehap tundi kokën për të më dhënë kurajë, - kur hedhim vështrimin, shikojmë livadhet dhe drurët, të cilët, këta...

- He, - tha ai, - vazhdo.

Ç'më tund kokën ashtu, mendova. Pse s'më thotë "lidhe tani".

Belbëzoja një copë herë, duke përsëritur po ato fjalë: drurë, gjelbërim, asimilim, klorofilim, duke pritur më kot që ai të shqiptonte fjalët shpëtimtare "lidhe tani". Ç'ka pësuar, mendoja, pse e la atë zakon të bekuar?

Më në fund, kur e pashë se ai s'kishte ndër mend, vendosa ta bëja lidhjen vetë.

- Asimilimit klorofilian, - rifillova me një zë të vendosur, - në regjimet e kaluara nuk i jepej rëndësia e duhur. Pemët dhe gjelbërimi, si dhe lulishtet e ndryshme...

Përpara se të dëgjoja zërin, pashë sytë e zotit Vehap që u picërruan si t'u kishte hedhur kush një grusht pluhur.

- Ç'janë këto? - më ndërpreu ai. - Me kë tallësh ti, zorzop?

- Unë, zoti mësues, unë aspak...

- Po të pyes, me kë tallësh ti, mistrec?

- Jo, zoti mësues... s'e kisha për tallje.

- Ulu, dysh. Të të vijë turp. Do t'i them dhe tyt eti.

Shkova kokulur në vend. Veshët më dogjën prapë, njëlloj si një orë më parë, kur m'i shkuli mësuesi i gjeografisë. Me bisht të syrit vështrova Ilirin, fytyra e të cilit ishte po aq e ngrysur sa imja. Paskësh qenë vërtet e prapë kjo ditë. Sikur të mos mjaftonin dyshat, isha sharë e fyer nga të dy mësuesit, qoftë nga ai "borgjezi", Nastoja, qoftë nga "proletari", siç e kishte namin zoti Vehap, për të mos përmendur këtu pusullën, nga e cila, për shkakun

tonë, i qe hequr vërejtja Turit. Zi nga të gjitha anët. Dhe të mendoje se dita e shkollës s'kishte marrë fund ende. Po, për fat, që orën e fundit kishim mësim sendesh, me zotin Jorgaq, nga i cili s'kishte frikë askush. Për të na e bërë mësimin sa më të kuptueshëm, ai e lidhte me shtëpinë e vet, duke sajuar gjithfarë ngjarjesh, sidomos me gruan. Kështu, për të shpjeguar tretjen e shpejtë të disa ushqimeve (kursesi nuk dihej si qe futur kjo pjesë në mësim sendesh), ai na tregonte se si pasdite e mori befas uria dhe i tha gruas t'i përgatiste diçka. Jorgaq, të rëntë pika, më tha gruaja, vazhdonte ai, ti para dy orësh hëngre drekë. Ne shqyeshim gazit dhe ai shpjegonte më tej: kjo ndodhi, të dashur nxënës, se në drekë kisha ngrënë lakra, pra, një ushqim që tretet lehtë. Dhe kështu shpjegohej pesha e lehtë e tymit (Jorgaq, pse s'tërheq tubi i stufës sot?), bymimi i ujit kur ngrinte (Jorgaq, të shpëlaftë mortja, ti e ke thyer këtë gotë?) etj., etj.

Tingulli i ziles më shkëputi nga kujtimet qetësuese të orës së zotit Jorgaq. Përse nuk ishin të gjithë mësuesit si ai? Jo mësues, po balsam.

Pushimi kaloi shpejt, me rrëmujën e zakonshme në oborr, përmes të cilit kaloi si furtunë Turi. Ç'të ishte vallë ajo fjala "sekt..." apo "seks...", që e kishte plagosur aq shumë?

Ra prapë zilja dhe hyri zoti Jorgaq, i shkurtër e i shëndoshë, me faqet e kuqe të fryra dhe sytë e çelët, që i jepnin fytyrës së tij diçka nga kukulla. Dukej i kënaqur, si zakonisht, dhe fërkonte duart. Atë ditë kishim përsëritje dhe as unë, as Iliri s'kishim mësuar, po faqet si mollë dhe sytë e kthjellët të zotit Jorgaq shpërndanin çdo ankth të mundshëm. Kështu që, kur Iliri dëgjoi të thirrej emri i tij, u ngrit pak a shumë i qetë.

- Sot kemi përsëritje, apo jo? - tha

RËNIE

Vdekja e njeriut është si rënia e shtetit të fuqishëm

E cila pati një armatë luftarake, prijës dhe profetë, port të pasur, dhe në të gjithë detet anije,

Derisa tani askujt nuk do t'i vijë në ndihmë
Dhe me asnjë nuk do të lidhë aleancë.

Sepse qytetet e tij janë të pabanuara

Dhe njerëzit të shkapërderdhur,

Gjembaçi mbulon tokën e tij që dikur

dha të korra e fryte,

Dhe misioni i tij i harruar, gjuha e humbur,

Dhe dialekti i fshatit diku larg në malet e pambërritshme.

Czesław Miłosz

mësuesi i qeshur. - Bukuri, bukuri. Na fol ti, djalë, për bymimin dhe tkurjen e sendeve.

Iliri uli një grimë sytë, pastaj, kur zoti Jorgaq, kushedi pse, ktheu kryet nga dritarja, Iliri vështoi nga klasa, me sy të çakërritur, si të pyeste: ç'është ky bymim e kjo tkurje që s'i kam dëgjuar kurrë?

Ne i bëmë ca shenja, por ai s'kuptonte, gjersa Ilia kokëmadhi, që e thërritnim kështu për shkak të kokës, nga banka e parë arriti t'i pëshpëriste: kur theu gotat, kur u grind me gruan...

- Fol, djalë, - tha mësuesi, duke i hequr sytë nga dritarja.

Iliri u kollit disa herë.

- Përgatitemi për arie, hë? - tha zoti Jorgaq shakanë e zakonshme, që e bënte sa herë që ndonjë nxënës pastronte zërin. - Jepi, djalë, është fare e thjeshtë, oburra, - dhe buzëqeshi me mirësi.

Iliri mori, siç dukej, guxim dhe hapi gojën të fliste.

- Atë ditë që zotrote... domethënë

që ju thyet gotat në shtëpi dhe që gruaja juaj...

Buzëqeshja në fytyrën e zotit Jorgaq erdh e u ftoh, gjersa u zhduk fare.

- Çfarë, çfarë?

Sytë e Ilirit e vështronin ngultas.

- Domethënë, atë ditë që ju ishit i pirë... dhe që... thyet gotat... domethënë që plasi grindja me gruan...

Mësuesi brofi në këmbë.

- Pizeveng, - thirri me një zë të mprehtë që s'ia kishim dëgjuar kurrë, - si guxon të marrësh nëpër gojë mua dhe gruan time? Shpifës, thashethush.

Iliri u nxi në fytyrë.

- Thashethush jeni vetë, - bërtiti ai.

- Ju na i keni thënë vetë të gjitha këto.

- Jashtë! - ulëriu zoti Jorgaq dhe faqet e tij nga mollë të kuqe u kthyen në ftonj. - Jashtë, horr. Dhe dysh.

Iliri doli kokulur.

Një copë herë mësuesi mezi e mori veten nga tronditja. Diçka më pengonte të zemërohesha me të, tek

ia dëgjoja frymëmarrjen e tij të rëndë, të trazuar, që arrinte gjer në bankat e fundit. Për çudi, pamja e shëndoshë e tij të zgjonte keqardhjen, sikur të ishte e kundërta e shëndetit.

Por keqardhja u bë e përgjithshme, kur ai shpjegoi mësimin e ri. Ishte herë e parë që nuk e lidhte me shtëpinë e tij dhe me gruan dhe kjo, me sa dukej, i shkaktonte një brengë të madhe, saqë dy-tri herë na u duk se do të ngashërehej mu në mes të shpjegimit. Atëherë të gjithë e kuptuam se, për shkak të Ilirit, mësimi i tij e kishte humbur përgjithmonë magjinë e deriatëhershme. E kishte humbur dhe, për këtë, ishim fajtorë të gjithë ne, që s'kishim ditur ta ruanim atë gjë të brishtë e të thyeshme lehtë, që s'dinim me ç'emër ta quanim.

2

Iliri më priste te rrugica.

- Ama ç'ditë, - tha.

Unë s'u përgjigja. Një copë rrugë e bëmë kokulur të dy.

- Sikur të hiqnim dorë nga ato vjershat, - tha Iliri. - Më duket se gjithë kjo prapësi prej tyre po na vjen.

S'dija ç't'i thosha dhe ashtu pa folur u ndamë parë portës së shtëpisë sime. Një copë herë u vërtita nëpër shtëpi pa ditur ç'të bëja. Tek po soditja pullazet nga dritaret e katit të tretë, m'u duk se tymtari i shtëpisë së zotit Jorgaq nxirrte tym më të dendur se zakonisht. Me siguri, ishte duke i treguar së shoqes atë që kishte ndodhur dhe ajo nga zemërimi hidhte dru të lagëta në zjarr.

U largova nga dritarja, por mërzia m'u shtua më tepër kur m'u kujtua ajo puna e vjershave, prej të cilave duhej të hiqja dorë. Shumë vargje dhe strofa të lëna përgjysmë i kisha shkruar me laps andej-kënde

nëpër muret e shtëpisë, në vendet prapa dyerve, që të mos binin në sy. Me një ndjesi mallëngjimi, që ma shkaktonte braktisja e tyre, shkova t'i shikoja edhe një herë, duke u përpjekur që t'i lëvizja pa zhurmë flegrat e dyerve. Ishin aty, të fshehura pas tyre, shumica të lëna përgjysmë, me ndonjë rimë të rrallë që e kisha gjetur me aq mundim. Mendimi se do të më duhej të hiqja dorë prej tyre bëri që të më hipte një dëshirë e zjarrtë për të plotësuar ndonjë nga ato strofa gjysmake. Nxora lapsin dhe nën rreshtin "Kush punon", që mund të merrej edhe si titull i një vjershe, shkrova vazhdimin: "Rehat shkon". U habita dhe vetë nga lehtësia me të cilën e gjeta vargun bashkë me rimën. Por habia do të bëhej më e madhe, kur pas gjysmë ore mundimi të skëtërrshëm arrita ta plotësoja gjithë strofën:

Kush punon

Rehat shkon

Detin e kalon

Njeri s'e ndalon.

I mrekulluar, s'ngopesha së lexuari vargjet, pa u besuar syve se si kisha mundur ta shkruaja atë që më dukej si kulmi i artit poetik.

Pa e zgjatur më, e kopjova strofën dhe, duke i zbritur shkallët nga tri e nga katër, renda si i marrosur nga shtëpia për të thirrur Ilirin. Ai doli tërë hundë e buzë te porta, sikur të thoshte: fillove prapë ti, s'të mjaftoi gjithë ajo lemeri që na panë sytë.

Kështu u duk, por, kur ia lexova strofën, harroi gjithçka, u mrekullua më shumë se unë dhe, duke i rënë ballit me dorë, nisi të thoshte herë me zë të lartë, herë me pëshpërimë: "pupu, ç'kryevepërl".

Zemra m'u bë mal nga ngazëllimi dhe u ktheva prapë në shtëpi për të vazhduar atë që u quajt prej të

dyve si "vjersha më e bukur e gjithë poezisë shqipe".

Iliri tregohej më i paduruar se unë. Ndërsa unë kafshoja herë gishtat dhe herë lapsin për të shkruar vazhdimin e vjershës, ai erdhi nja pesë a gjashtë herë për të parë si vente puna. Më në fund, aty buzë mbrëmjes çatisa te porta e Ilirit. Na merrej fryma të dyve, mua nga vrap, atij nga tronditja, dhe ashtu me frymë të marrë lexova strofën tjetër:

Kush nuk punon

Rehat nuk shkon

Detin s'e kalon

Njeri e ndalon.

Iliri mbeti një grimë i mekur, pastaj zuri kokën me duar:

- Kulmi, - tha me zë të çuditshëm, një zë i shprishur, që s'ia kisha dëgjuar ndonjëherë. - Madhështore, gjeniale. la kalove krejt poezisë franceze.

Isha pothuajse i sigurt për një gjë të tillë, megjithatë më erdhi mirë kur e dëgjova nga goja e një tjetri.

- Lexoma dhe një herë, - tha ai dhe, kur unë përsërita leximin, ai u mahnit edhe më tepër.

- Francezen e vure poshtë, - tha. - Të ka mbetur vetëm poezia bullgare, pastaj...

Nuk guxova ta pyesja se ku bazohej për një gjykim të tillë, që nuk ia kisha dëgjuar ndonjëherë.

- Duhet ta nisësh menjëherë për botim, - tha pas pak.

- Po ku?

- As unë s'e di. Të pyesim.

Të nesërmen morëm vesh se në Tiranë kishte një Lidhje të Shkrimtarëve, e cila botonte një gazetë dhe një revistë letrare. Vendosi ta dërgonim vjershën në të dyja, madje Iliri mendonte ta dërgonim në të gjitha gazetat e Shqipërisë.

E kopjova prapë disa herë vjershën,

SHPIRTI

Ne e dime nuk na lejohet të përdorim emrin tënd.
Ne e dimë ti je i padeshifrueshëm,
pa gjak, i brishtë dhe i dyshuar
për shkelje misterioze si një fëmijë.
Ne e dimë ti tani nuk lejohesh të jetosh
në muzikë ose tek pemët në perëndim të diellit.
Ne e dimë ose të paktën na kanë thënë
se ti nuk ekziston fare, askund.
Po ne ende dëgjojmë zërin tënd të këputur
në një jehonë, në një ankesë, në letrat që marrim
nga Antigona në shkretëtirën greke.

Adam Zagajewski

i vura nën të emrin tim, emrin e tim
eti dhe mbiemrin dhe të dy me Ilirin
shkuam me vrap në postë. Ishim
krejtësisht të sigurt se vjersha do të
botohej në faqet e para të revistës e
të gazetës njëkohësisht.

3

Kudo që ndodhesha, në mësim, në
lojë, përpara gjumit, ose pas zgjimit,
mendja më rrinte te vjersha. Ilirit
gjithashtu, madje nganjëherë më
dukej se ai që më i ndezur se unë. E
sillja ndër mend me ngazëllim, me
shpresë, me mallëngjim bukuroshen
e vogël, që kishte ikur e vetme larg,
atje nëpër redaksira, dhe që do t'i
mahniste të gjithë. Kur qëllonte
që merrja ndonjë dysh ose ndonjë
qortim nga mësuesi apo nga im atë,
me vete thosha: punë e madhe, le të
marr dysha, le të më tërheqin veshin,
ajo ndërkaq është atje dhe askush
nuk mund ta kthejë mbrapsht.

Të dy me Ilirin numëronim ditët,
duke u përpjekur të gjenim nëse
kishte mbërritur apo jo. Pastaj
përfytyronim se si do të shtangeshin
redaktorët kur ta lexonin, si do
të mblidheshin kokë më kokë, të

thërritnin shokët nga zyrat e tjera,
madje nga redaksitë e tjera, ta lexonin
prapë, t'i binin ballit me dorë, të
kërkonin aspirina, ujë etj., etj.

Ndërkaq, duke qenë në pritje, nuk
rrininim duarkryq. Iliri kishte lexuar
diku parullën “të mos dehemi nga
sukseset” dhe çdo ditë vinte me
nga një ide të re. Ai vazhdonte të
ngulte këmbë se tani që poezinë
franceze e kisha vënë përfund,
duhej synuar patjetër ajo bullgare.
Asnjëherë s'arrita ta kuptoja se nga
i vinte kjo, veç ishte kaq i bindur,
saqë, kur përfytyronim çmeritjen e
redaktorëve atje në Tiranë, aspirinat,
ujin etj., Iliri ishte i sigurt se midis
klithmave të tyre, e para do të ishte
“ah, sikur t'ia kalonte dhe poezisë
bullgare!”.

Një pasdite, ai erdhi tek unë me
një libër të çuditshëm: “Metrika
shqipe”, që kushedi ku e kishte
gjetur dhe që ma bëri mendjen
dhallë, kaq i vështirë m'u duk. Një
ditë tjetër më tha se e kishte gjetur,
më në fund, se ç'duhej të bëja: duhej
të shkruaja gegërisht. S'e mora vesh
se si i kishte lindur ky mendim, por
nuk u desh të kalonte as gjysmë ore,

që të më dukej i vetmi mendim i
arsyeshëm.

Kuptohej që me kalimin në
gegërisht, mundimet e vjershërimit
m'u dyfishuan. Gjumin e bëja të
turbullt, në mësimë mezi mbahesha,
ndërsa mbulesat e fletoreve dhe
muret pas dyerve po mbusheshin
me vargje të një lloji tjetër. “Vrik asht
çue partizani”, ose “Shka ka thanë
nj' ai trim i lokes”.

Ndërkaq, ditët kalonin. Pas
mendjes sonë, vjersha duhej të kishte
mbërritur në Tiranë dhe për ne nisën
ditët e padurimit. Midis tyre, i lehtë,
por këmbëngulës, shfaqej herë-herë
tisi i parë i trishtimit.

4

Të dielën në mëngjes isha duke
dremitur me kokën mbi detyrat e
aritmetikës, kur e çrregullt, marroke,
ashtu si dhe çdo gjë tjetër e Ilirit, më
zgjoi trokitja e tij. Midis trokitjeve
diçka thërriste me zërin e tij, që në
këso rastesh i dilte tjetërfarësh: as
i hollë, as i trashë, por i përzier, zë
koke e gryke njëkohësisht, që nuk
mund të të ndillte veç për gjëra të
marra.

S'u besoja veshëve, aq e
mrekullueshme m'u duk britma e
tij: “U botua! U botua!”. Me duart
që më dridheshin hapa portën dhe
atëherë gëzimi m'u përplas në fytyrë
në trajtën e një gazete, që Iliri e kishte
shpalosur të gjithën, duke e zbardhur
gjithë botën. Ishte i ndërkryer i gjithi,
merre frymë me zor dhe u desh një
copë herë sa ta gjente vendin ku që
vjersha. Zhgënjimi që nuk e pashë me
shkronja të mëdha, që të zinte krejt
faqen, por në një kënd, saqë mezi
dukej, u davarit në çast, kur afrova sytë
dhe, oh, mrekulli, pashë vargjet që i
kisha shkruar te muri, prapa derës së
mesores, pikërisht ato, jo mbi gëlqere
tashmë, por mbi letër, me shkronja të

vërteta, dhe sipër tyre emri im, emri i babait dhe mbiemri. Krejt si në libra, Leon Nikollajeviq Tolstoj. Foqion Postoli. Shekspiri.

U desh të kalonte ca kohë që të mblidhnim veten dhe të kuptonim se në të vërtetë nuk qe botuar krejt vjersha, por vetëm strofa e parë e saj, madje dhe kjo jo më vete, por në rubrikën e përgjigjeve “Posta e redaksisë”, në faqen e katërt.

- Po prit, - thashë unë, - ç’kanë shkruar këtu?

- S’ka fare rëndësi, - tha Iliri dhe i hodhi sytë gjetkë, por unë, ndërkaq, kisha nisur të lexoja rreshtat që më drejtoheshin mua si përgjigje: “Morëm vjershën tuaj ‘Kush punon’ dhe të themi të që në këso rastesh i dilte tjetërfarësh: as i hollë, as i trashë, por i përzier, zë koke e gryke njëkohësisht, që nuk mund të të ndillte veç për gjëra të marra.

S’u besoj veshëve, aq e mrekullueshme m’u duk britma e tij: “U botua! U botua!”. Me duart që më dridheshin hapa portën dhe atëherë gëzimi m’u përplas në fytyrë në trajtën e një gazete, që Iliri e kishte shpalosur të gjithën, duke e zbardhur gjithë botën. Ishte i ndërkryer i gjithi, merrte frymë me zor dhe u desh një copë herë sa ta gjente vendin ku qe vjersha. Zhgënjimi që nuk e pashë me shkronja të mëdha, që të zinte krejt faqen, por në një kënd, saqë mezi dukej, u davarit në çast, kur afrova sytë dhe, oh, mrekulli, pashë vargjet që i kisha shkruar te muri, prapa derës së mesores, pikërisht ato, jo mbi gëlqere tashmë, por mbi letër, me shkronja të vërteta, dhe sipër tyre emri im, emri i babait dhe mbiemri. Krejt si në libra, Leon Nikollajeviq Tolstoj. Foqion Postoli. Shekspiri.

U desh të kalonte ca kohë që të mblidhnim veten dhe të kuptonim se në të vërtetë nuk qe botuar krejt vjersha, por vetëm strofa e parë e

saj, madje dhe kjo jo më vete, por në rubrikën e përgjigjeve “Posta e redaksisë”, në faqen e katërt.

- Po prit, - thashë unë, - ç’kanë shkruar këtu?

- S’ka fare rëndësi, - tha Iliri dhe i hodhi sytë gjetkë, por unë, ndërkaq, kisha nisur të lexoja rreshtat që më drejtoheshin mua si përgjigje: “Morëm vjershën tuaj ‘Kush punon’ dhe të themi të drejtën u habitëm pak. Ju shkruani një gjuhë që as në prozë nuk përdoret. Për shembull: Kush punon, rehat shkon, detin e kalon, njeri s’e ndalon. Po të ishte kështu, do të bëheshin të gjithë shkrimtarë dhe poetë. Megjithatë, mos e humbisni kurajën. Vetëm kini parasysh një këshillë: lexoni përpara se të vendosni të shkruani”.

Një grimë mbeta si i mpirë, por Iliri ma rrëmbeu gazetën nga duart.

- Ç’më rri ashtu? - tha ai. - Nuk gëzon që të ka dalë emri dhe vjersha është botuar?

I çova sytë prapë te strofa e botuar dhe tek emri i shtypur me shkronja të zeza, për besë, Foqion Postol, Eskil, Aleksandër Dyma (biri), dhe në çast e harrova tekstin e përgjigjes dhe të dy me Ilirin nisëm të hidheshim përpjetë nga gëzimi.

Në drekë babai hyri në shtëpi i vrenjtur. Pa thënë asgjë, m’u afrua, më zuri nga veshi dhe ma tërhoqi një copë herë.

- Ti, more mistrec, ke guxuar të vësh emrin tim në ato shkarravinat e tua, hë? More kastravec, që më bëre të më skuqet faqja sot në kafene. More birbo, që kemi jetuar gjithë jetën me nder dhe erdhe ti të na turpërosh, dhe ku pa, në gazetë... Bëre ç’bëre, të mos të shoh më të merresh me turpëri të tilla, more vesh?

veten, ndihej menjëherë që vrulli i poezisë na kishte rënë. Përherë e më rrallë flisnim për vjershat e reja që unë duhej të shkruaja, për dërgimin e tyre, për mahnitjen e redaktorëve në Tiranë, aspirinat, barnat etj.

Iliri ca kohë u dha pas një problemi vetjak: trashjes së zërit. Kohët e fundit, pas një grindjeje me Ilia kokëmadhin, i cili dihej që në shtëpi e lidhte kokën me rrip që të mos i rritej dhe që në zemërim e sipër i tha Ilirit se e kishte zërin si laraskë, Iliri ra në të zeza. Nuk e di nëse e këshilloi dikush apo e shpiku vetë mënyrën me të cilën besonte se do të trashte zërin. Nisi të vërtitej gjithë ditën nëpër shtëpi me një tufe gazeta në duar, duke thirrur me sa kishte në kokë: “Arriti gazeta ‘Bashkimi’ me lajme të reja, të freskëta. Arriti ‘Bashkimi’”.

Ti shkoje, si zakonisht, për të këmbyer dy fjalë, kurse ai, në vend që të fliste si njeri, mu në turirin tënd vazhdonte të ulërinte: “Ministri i Jashtëm sovjetik Molotovi deklaroi sot. Ministri i Jashtëm sovjetik!”.

Edhe në shkollë ndihej njëfarë rënieje e zjarrmisë. Qe hequr nga Komiteti i Rinisë Turi dhe ishte zëvendësuar nga Agim Ciu, një djalë i sjellshëm, me faqe të shëndetshme dhe që i nderonte mësuesit. Ithtarët e Turit e thërritnin djalë mamaje.

Turi vetë, i shkarkuar nga çdo përgjegjësi, ishte hequr krejtësisht mënjandë. Vinte fare i vetëm në shkollë, veshur me një pallto të vjetër, që nuk ia kishim parë kurrë, dhe vështronte gjithçka me sytë e tij të akullt, që nga zemërimi i përhershëm ngjanin tani si të vëngër.

Ç’është e vërteta ne kishim mall për kohën e Turit dhe na vinte keq kur e shikonim ashtu, me atë pallto që të trishtonte. Na merrte malli për veprimet e tij të papritura, të marra dhe shumë herë të pakuptueshme,

por që kishin, megjithatë, në kokëkrisjen e tyre një magji të fshehtë.

Sa për mësuesit, shumica e tyre e tregonin hapur gëzimin për rënien e Turit. Kishin nisur të vinin prapë borsalinat, që i kishin hequr, siç dukej, nga frika e Turit dhe fytyrat u ndritnin nga ngadhënjimi. Flitej se kohën e Turit e quanin midis tyre “kohë e majtizmit”, që tani kishte marrë fund, qëkurse në krye të Komitetit të Rinisë, në vend të demonit Tur, qe vënë ai engjëlli, Agim Ciu. Ishte e qartë se tani mund të bënin ç’të donin me ne dhe këtë e tregonin haptas. Në mësimin e botanikës zoti Vehap rrallë e më rrallë na thoshte “lidhe!”, kurse në orën e gjeografisë zoti Nasto, duke marrë, pa dyshim, guxim nga rënia e Turit, me sytë që i vezullonin nga një ndriçim hakmarrës, thoshte se ka stëpa jo vetëm në Amerikën e Veriut,

por edhe në Argjentinë, Meksikë, madje dhe në Australi.

Ne i shihnim e i dëgjonim të gjitha këto dhe mu në mes të mësimin, ashtu padashur, na shkëputej nga gjoksi një psherëtimë.

Pikërisht në një ditë të tillë, Iliri, me një zë që mezi i dëgjohej nga ngjirja, më tha:

- Sikur ta lëmë atë punën e poezisë dhe të merremi me tjetër gjë. Si thua ti?

Diçka ma bëri “trak” si një thyerje në gjoks.

- Po me çfarë? - thashë me zë të humbur.

- Po ja, me prozë. Kam qejf të shkruaj edhe vetë. Fillojmë ashtu... si i thonë... romak.

- Roman, më duket.

- E pra, romak, roman, e njëjta gjë është. Si thua?

- Mirë, - u përgjigja hutueshëm. Ajo thyerje në gjoks sa vente bëhej

më e dhimbshme. Domethënë, kot ishim hequr sikur nuk e kuptonim ç’kishte ndodhur. Kaq kohë kishim mbyllur sytë për të mos parë talljen, por ajo ishte atje, e shkruar e zezë mbi të bardhë dhe mjaftuan fjalët e Ilirit “sikur ta lëmë atë punën e poezisë”, që e vërteta të shfaqej lakuriq. Domethënë, redaktorët s’do të merrnin më letrat tona me duart që u dridheshin nga tronditja, atje në Tiranë, dhe as do të vraponin në farmaci për vitamina ose aspirina, dhe poezia bullgare do të sundonte mbi botë e pakërcënuar nga askush... Eh, ishte vërtet për të qarë.

- E pra, - tha Iliri, - ç’më shikon ashtu? Do ta bëjmë apo jo atë romanin?

Unë bëra “po” me krye.

- Mirë, ahëre, - tha Iliri. - Meqenëse romanet janë të trasha, mendoj që ta bëjmë bashkë. Si thua?

Unë bëra prapë “po” me kokë, por mendjen e kisha gjetkë.

6

RËNIE

Vdekja e njeriut është si rënia e shtetit
të fuqishëm

E cila pati një armatë luftarake,
prijës dhe profetë,
port të pasur, dhe në të gjithë detet
anije,

Derisa tani askujt nuk do t’i vijë në ndihmë
Dhe me asnjë nuk do të lidhë aleancë.

Sepse qytetet e tij janë të pabanuara
Dhe njerëzit të shkapërderdhur,
Gjëmëbaçi mbulon tokën e tij që dikur
dha të korra e fryte,
Dhe misioni i tij i harruar, gjuha e humbur,
Dhe dialekti i fshatit diku larg në malet
e pambërritshme.

Czesław Miłosz

Ndonëse e filluam si rastësisht,
ethet e romanit nisën dalëngadalë të
na zinin.

- Filluat prapë ju? - na tha nëna e
Ilirit, kur e pa që i dendësua vajtjet
e ardhjet pasditeve të njëri-tjetri. -
Ç’proçkë tjetër do të na bëni?

Por neve na kishte filluar dehja
dhe aq na bënte ç’mendonte ajo
apo të tjerët. Kishim gjetur titullin e
romanit, si edhe frazën e fundit të tij
(që, në të vërtetë, ishin e njëjta gjë),
dhe kjo na mbushte me një lumturi
përqethëse. Në skenën e fundit të
romanit, heroi i tij do të tregonte
me dorë diellin që shndriste mbi
lëndinat e fshatit dhe do t’u thoshte
fshatarëve: e shikoni diellin që ndrit?
Kjo është fitorja!

Kështu, pra, do të quhej romani:
“Kjo është fitorja!” dhe ne

s'ngopeshim së adhuruari titullin e porsagjetur, duke e shkruar e stërshkruar nëpër mbulesa fletoresh, librash, mbi kartona apo çdo copë letër që gjenim. Pupu, ç'titull, thoshim duke i rënë ballit, dhe përfytyronim prapë mahnitjen që do të shkaktonte te njerëzit, habinë, çoroditjen, të fikëtit, me gjithë ato të tjerat pas, aspirinat, gjilpërat etj. Nganjëherë mendonim se sa e tmerrshme do të ishte sikur të mos e kishim gjetur dhe, gjithsesi, nuk e mendonim dot botën pa atë titull, kaq e varfër e pa shije na dukej.

Kaq shumë ishim magjepsur pas titullit, sa kishte rrezik të ngopeshim vetëm me të, por një ditë Iliri u kujtua e tha: "Tani duhet filluar vetë romani".

Duhej filluar... Një fjalë goje ta thoshe, po provo ta nisësh një roman. Kishim lexuar katër a pesë libra secili dhe nisëm t'i sillnin e t'i risillnim ndër mend për të parë se si shkruheshin librat, por kurrësi nuk e pranoni se mund të ndikoheshim sadopak prej tyre. Në këtë kohë Iliri se ku kishte gjetur "Ana Kareninën" e Tolstojt dhe, ndërsa unë po ngjitja me tel fletoret, ku do të shkruanim romanin, ai e lexonte.

Pasi përgatita fletoret, sipas reklamave që kisha parë në mbulesat e prapme të librave, nisa t'i mbushja fletët e para me reklama për romanin tonë. "Shtëpia botuese 'Zonja e Papërlyeme' porsa nxori në shitje romanin gjenial 'Kjo është fitorja', shkruar nga pena demoniake e më të famshmëve shkrimtarë të kohës (këtu vinte emri im dhe i Ilirit)" Ose: "Vraponi në libraritë e Tiranës. Janë duke u shitur kopjet e fundit të romanit 'Kjo është fitorja', kryevepra postume e dy gjigantëve të penës... Çmimi 2 fr. ar".

Ndërkaq, Iliri kishte arritur t'i hidhte një sy "Ana Kareninës" dhe

tha se nuk kishte parë roman më të mërzitshëm e pa vlerë. S'kishte dyshim që yni do të ishte dhjetë herë më i mirë.

- Një roman me kotësira, më kupton? - vazhdonte ai. - Histori se si ndahet një grua nga burri. Me një fjalë, gjeputura. Të ishte ashtu, vetëm në lagjen tonë duhej të ishin shkruar nja pesëdhjetë të tilla.

Puna e "Ana Kareninës" na dha zemër që t'i përvisheshim romanit më me vrull. Iliri i lexoi reklamën e mia, të cilat i pëlqeu mjaft dhe, i përndezur prej tyre, thirri: tani, oburra, t'ia nisim!

T'ia nisim, po si?

- Ti mund ta nisësh nga fillimi, unë nga fundi... domethënë nga pjesa e dytë... në mënyrë që të shkurtoj më kohën.

- Po si? - pyeta unë. - Thua s'do të ngatërrohem? Ai më vështroi një hop si i zënë në befasi.

- Ke të drejtë, mund të ngatërrohem. Ndoshta është më mirë që në fillim të bëjmë planin dhe pastaj secili të shkruajë nga një copë, atë që i pëlqen.

Vetvetiu erdhëm prapë te puna e historisë që do të rrefenim, të cilën, të tërhequr prej titullit dhe reklamave, e kishim lënë mënjanë. Tani ishte e qartë ç'duhej bërë: së pari të gjenim përmbajtjen.

Kuptohet që gjithë ato ditë vajtjet tona te njëri-tjetri arritën një dendësi të paparë. Ikën këta nga mendja, lajthitën, dëgjonim të thuhej në rrugicë, po neve aq na bënte. Të lajthitur na dukeshin ata, që i kalonin ditët aq mërzitshëm pa roman, pa tituj, pa kurrjë.

Iliri, pasi kishte kaluar një natë pa gjumë, kishte gjetur, më në fund, fillimin e ngjarjeve. Heroi i romanit detyrohet prej beut të fshatit, që ishte aleat me gjermanët e ballistët, të gjuajë me shigjeta një mollë

vendosur mbi kokën e djalit të vet.

- Po kjo sikur ngjan me... - e ndërpreva unë me druajtje.

Sytë e Ilirit u egërsuan.

- Me çfarë ngjan? - thirri ai. - Me asgjë nuk ngjan. Po të jetë ashtu, të gjithë librat ngjajnë.

- Ke të drejtë, - i thashë. - Edhe mua ashtu më duken nganjëherë librat, kopje të njëri-tjetrit.

Ilirit i ndriti fytyra dhe nga gëzimi nisëm të flisnim të dy me vrull. Kështu pra, romani kishte, më në fund, një fillim të bukur. Tërheqës dhe me kuptim të lartë. Heroi i hipën urrejtja kundër beut, gjermanëve e ballistëve. Më bukur s'kishte si të niste një roman.

Të nesërmen ishte radha ime të trokisja si i tërbuar te porta e Ilirit.

- Kam gjetur vazhdimin, - thashë me një frymë. - Dëgjo ç'mrekulli. - Dhe nisa t'i tregoja atë që kisha shpikur, domethënë që heroji, i cili burgoset prej beut, pasi rri katërbëdhjetë vjet në burg, arrin të hapë një vrimë nën muret e burgut me ndihmën e abatit Far... Far...

Iliri më shikonte vëmendshëm me ca sy të zvogëluar.

- Me ndihmën e një abati që quhej Farudin, - thashë unë, duke bekuar fatin që më solli ndër mend emrin e shokut tonë të klasës, Farudinit apo Didinit, siç e thërritnim shkurt.

- Shumë bukur, - tha Iliri. - Dhe nuk ngjan fare... Dhe shumë mirë të ka shkruar ndër mend që t'i vësh emrin Farudin atij abatit, që të mos thonë se...

Ishim të lumtur të dy që historia po dilte e qartë dhe tërheqëse. Tani heroji, pasi të arratiset nga burgu, e kishte rrugën të hapur për të dalë partizan. U lëkundëm ca kohë nëse duhej ta vinim apo jo atë punën e thesarit që abati Far...udin, në prag të vdekjes, ia tregonte heroit. Një herë na u duk se thesari na ngatërronte,

po pastaj Iliri u kujtua se ai mund të përdorej për të ndihmuar Lëvizjen Nacionalçlirimtare, kështu që e lamë. Po kështu, patëm mendime të ndryshme në fillim për atë pjesë ku heroi ndihmonte të varfrit dhe zezakët (këta banonin te kasollja e Xha To... les), sepse mua m'u kujtua që zezakë s'kishte në Shqipëri. Ku e di ti? tha Iliri, mund të ketë andej tutje nga Tirana ose nga Shkodra. Por edhe kur na thanë se s'kishte asgjëkund në Shqipëri zezakë, Iliri nguli këmbë ta linim atë pjesë, sepse, në qoftë se nuk kishte zezakë, kishte evgjitë, dhe, në fund të fundit, kjo ishte pothuajse e njëjta gjë, një çikë më shumë lëkurë e zezë, një çikë më e bardhë.

Pasi sheshuam dhe punën e zezakëve dhe ca hollësira të tjera, e kuptuam se periudha përgatitore kishte marrë fund dhe kishte trokitur çasti i madh i fillimit të vërtetë të romanit.

Një të diel, të ulur të dy në nimin e dhomës së madhe të shtëpisë sonë, njëri në një kënd, tjetri në tjetrin, nisëm të shkruanim, unë kapitullin e dytë (burgun, abatin Far... udin etj.), Iliri të parin (gjuajtjen e mollës me shigjetë).

Të shkruarit në prozë m'u duk më i vështirë se ç'mendoja. Ndryshe nga poezia, ku frazat këputeshin prej rimave, këtu të zgjateshin e të ngatërroheshin keq, ngjitnin si mastiç me njëra-tjetrën, ti përpiqueshe t'i shpleksje, ato plekseshin më keq. Veç kësaj, nuk e di pse, mendja të ikte në gjithfarë kotësish që s'kishin asnjë lidhje me romanin. Më kujtoheshin faqet e kuqe si mollë të zotit Jorgaq, arkëmorti i gjyshit të vdekur, kur e kishim zbritur nga shkallët një vit më parë, një njollë boje në fletoren e diktimit të Mama Belgjikës. (Ky ishte një shok i klasës që i kishte mbetur kjo nofkë që nga

PASDITET E GJATA

Ato ishin pasdite të gjata kur poezia më braktiste.
Lumi rridhte me durim shtynte anijet përtace drejt detit. Pasdite të gjata, një bregdet prej fildishi.
Hijet bjeraditëshin rrugëve, manekinët arrogantë nëpër vitrina m'i ngulnin sytë me vështrimin e paturpshëm dhe armiqtësor.

Profesorët linin shkollat me fytyrat boshe, sikur *Iiada* ishte hakmarrë përfundimisht me ta.
Gazetat e mbrëmjes sillnin lajme shqetësuese, por asgjë nuk ndodhte, askush nuk shpejtonte.
Nuk kishte njeri nëpër dritare, ti nuk ishte atje; madje dhe murgeshat ngjanin të turpëruara nga jeta e tyre.

Ato ishin pasdite të gjata kur poezia zhdukej dhe mbetesha vetëm me demonin e padepërtueshëm të qytetit, si një udhëtar i varfër i nxjerrë jashtë nga *Gare du Nord* me baulen e fryrë lidhur me një spango dhe shiun e zi të shtatorit që binte.

Oh, tregomë si të kurohem nga ironia, shikimi që vështron, por nuk përshkon; tregomë si ta kuroj veten nga heshtja.

Adam Zagajewski

7

dita kur, i dëshpëruar që dikush i kishte rrëmbyer një pullë poste të Belgjikës, mu përpara portës së shtëpisë kishte ulërirë: mama, dil se më morën Belgjikën, mama, më iku Belgjika, mama, Belgjika!)

Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, herë pas here Iliri kthente kokën të shikonte ç'bëja unë (ai u ankua më pas prej meje për të njëjtën gjë), duke ma hequr edhe atë çikë përqendrim që kisha. Shkurt, e kuptuam se ishte e vështirë të punonim në të njëjtin vend dhe vendosëm të shkruanim veç e veç, secili në shtëpinë e vet dhe të nesërmen t'ia tregonim shokut atë që kishim bërë.

Ç'ishte ky gëzim që as prishej, as dëmtohej nga asnjë, përkundrazi, sa më tepër që na qortonin apo na dënonin në shkollë e në shtëpi, aq më shumë përndritej e përtëritej? Gjumi na zinte me të dhe në mëngjes, si të ishte grumbulluar e shtuar gjatë natës, shpërthente gëzueshëm për të na e bërë ditën të lumtur. Si jetonin të tjerët pa këtë gëzim, thoshim nganjëherë të dy, si nuk hidheshin në përroin e Ficos?

Në shkollë s'i kishim punët mirë, po neve aq na bënte. Jetonim vetëm për pasditet dhe gjithçka që ndodhte

mëngjeseve në shkollë na dukej e kotë dhe plot mërzë.

Ishte hequr nga komiteti i rinisë Agim Ciu dhe ca ditë mësuësi i hoqën borsalinat, pastaj, kur e panë se Turi s'u rizgjodh, i vunë përsëri. Kishte dhe ngjarje të tjera të parëndësishme, që neve na dukeshin dhjetëfish të tilla, për arsyen që dihet. Flitej se një djalë nga klasa e shtatë, njëfarë Llukan "kishte rënë në dashuri", ose hiqej kështu, dhe në pushim shumica e nxënësve, sidomos vajzat, hetonin me kujdes fytyrën e tij për të parë shenjat e dashurisë.

Po neve të gjitha këto na dukeshin gjepura dhe të padenja për vëmendje.

- Ç'bëni ju të dy fshehtazi? - më tha një ditë Mama Belgjika, ndërsa dilnim prej shkollë.

Unë bëra sikur s'kuptova dhe ngrita supet.

- He, ti kujton se unë s'e di se ç'bëni? - dhe ia plasi të qeshurit. Pastaj sytë e tij u bënë djallëzorë.

- Mollë dhe pjepura apo fruta majë kokës dhe gjuaj pastaj me shigjetë, hi-hi-hi, këtij i thoni roman ju?

M'u errën sytë nga turpi. Ishim betuar të dy me Ilirin që ta mbanim të fshehtë punën e romanit dhe ja tani, jo vetëm që ajo ishte marrë vesh, por diheshin edhe hollësisht.

- Rrush e fiq majë kokës, shpoji pastaj me shigjetë, uh, ç'vete! - vazhdoi të tallej Mama Belgjika. - Po pse, shkrimtarë jeni ju, që dashkeni të bëni romane?

- Shkrimtarë jemi, ke smirë ti? - ia prita, ngaqë s'dija ç't'i përgjigjesha.

Ai lëshoi një vërshëllimë habie.

- Po shkrimtarët janë të vdekur, or qyq, ende s'e ditkeni ju?

I ktheva krahët për të mos dëgjuar fjalët e tij të hidhura. Po më shumë se talljet e tij më shqetësuan fjalët e fundit dhe kjo për arsyen e thjeshtë se kisha dyshuar edhe vetë për këtë.

Ilirin e takova pasdite.

- Ti i paske treguar Mama Belgjikës për romanin? - i thashë gjithë helm.

Ai u prish në fytyrë dhe mohoi me krye.

- Ahere, kush i ka treguar?

- Me siguri ti, - tha Iliri pa pikë turpi.

U deshën jo më tepër se dy minuta që të grindeshim keq me njëri-tjetrin. S'ishte herë e parë që ndodhte kjo dhe puna e parë që bënim pas grindjes ishte ndarja e gjërave të përbashkëta: pullat e postës, llastiqet e zogjve apo monedhat e bakërta me të cilat loznim. Këtë herë kishim një tjetër gjë të përbashkët, romanin dhe, ndonëse në fillim ideja e ndarjes së tij m'u duk katastrofike (pata përshtypjen se po kështu i qe dukur dhe Ilirit), e ndjeva, megjithatë, se që të dy, qoftë edhe kundër vullnetit tonë, po i afroheshim greminës. Pasi i ndamë pullat, llastiqet dhe monedhat turke (asnjëherë s'e kishim bërë kaq shpejt ndarjen, gjë që tregonte se që të dy e kishim mendjen gjetkë), midis nesh ra një heshtje e shkurtër, shurdhuese dhe plot pritje. Pastaj, siç na ndodhte shpesh, që me një vrull të verbër bënim pikërisht atë që nuk dëshironim, në kohën kur u duk se e lamë fisnikërisht në harresë, pa e prishur urën e fundit, pothuajse të dy në një gojë, me një tërbim të pashpjegueshëm, shkatërrimtar, thamë: po romanin?

Merrej me mend se gjersa fjala "roman" u përmend, kjo do të thoshte se atij i kishte ardhur fundi. E ndamë pa asnjë mëshirë, duke i shqyer kapitujt dhe fletët në kundërshtim me çdo logjikë dhe, ngaqë e ndienim dhe vetë se po bënim diçka të marrë, të ndërkryer nga kjo dhe nga pamundësia për të frenuar veten, në krye të disa minutave e çuam plojën gjer në fund.

Pas pak, me një tufë fletësh në duar hyra në shtëpi. Një ditë më parë as që mund të më shkonte mendja se

ëndrra e bukur do të merrte fund kaq barbarisht. Pas pak, kur m'u duk se e mora veten nga tronditja e parë, dëshpërueshëm nisa të shfletoja atë që më parë kishte qenë romani ynë dhe që tani s'dija me ç'emër ta quaja. Ishte një gjysmëroman, ose më keq, s'ishte as gjysmë, por copa kapitujsh të ndryshëm, të prera siç pritet një pulë. Dhe befasi, duke i kaluar dhe një herë nëpër duar, nuk e di pse m'u krijua bindja se Ilirit i kishin mbetur copat më të mira.

Pa e menduar më gjatë, brofa në këmbë dhe me shukun e fletëve në duar u gjenda te porta e Ilirit. Thirra një copë herë, por ai nuk zbriti poshtë. Se nga u shfaq te një dritare e vogël e katit të dytë, me një fytyrë që m'u duk djallëzore.

- Ti ke marrë pjesën më të mirë të romanit, - i thashë. - Zbrit ta ndajmë dhe një herë.

- S'dua, - tha Iliri.

Një përgjigje e tillë pritej. Të njëjtën do të jepja dhe unë, sikur Iliri të trokiste te porta ime.

Filluam të shaheshim me ç'na vinte në kokë. Unë i thashë veshllapush, kokëgjatë, ai më tha dyshanjës, dhëmbëçatall. Pastaj të sharat u rënduan, kur ai më tha qorr, dhe unë ia ktheva zëlaraskë, fjalë që, me sa duket, e pezmatoi fort, sepse u zhduk një grimë nga dritarja për të gjetur, siç dukej, ndonjë sharje të re. Dhe vërtet, u shfaq shumë shpejt dhe në fytyrën e tij, përveç prapësisë gërnjare, m'u duk se dallova një ndriçim qesëndisës.

- Ju shkruani një gjuhë që as në prozë nuk përdoret, - tha me zë të çjerrë dhe mua m'u duk se më ra pika. E ndjeva veten të pafuqishëm për t'iu përgjigjur fyerjes dhe vetvetiu u përkula për të rrëmbyer një gur. Por ai u tregua më i shpejtë dhe guri u përplas në flegrenë e dritares, që ai kishte arritur ta tërhiqte.

Në atë çast në murin e shtëpisë përballë u hap një dritare dhe në të doli teto Haxhekoja.

- Plasja ju preftë! - thirri ajo. - Ç'keni, more zorzopër, që ju rëntë një kolerë, ju rëntë, ç'ke, more ti, djali i filanit, që na more mendjen e kokës me të thirrura e me gurë. Do t'i them tyt eti, po fol!

- Më ka rrëmbyer romanin, - u përgjigja unë.

- Po pse, për një copë koromane ngrite mëhallën në këmbë, o i paudhë. Eja të të jap unë koromane sa të duash.

Shurdhe e dreqit, thashë me vete. Edhe ti duheshe tani.

- Jo koromane, moj gjyshe

Haxheko, po roman të thashë.

Po në vend që të më linte të qetë, tani që e mori vesh që nuk ishim grindur për një copë bukë, ajo u zemërua më keq.

- Po pse, për një kroman apo tortoman, vjen e na bën lemerinë në mes të ditës, more nxirak, more majmun, more kukudh...

Kisha nisur të largohesha nga rrugica i mundur, po të sharat e saj më ndiqnin pas, të tilla që asnjë shkrintari, sado i dështuar, s'besoj se i ishin bërë ndonjëherë.

Ktheva kokën dhe një herë dhe e pashë se ishte ende te dritarja, një hije e stërmadhe ogurzezë, që më tundte gishtin kërcënueshëm.

Isha krejt i dërrmuar kur kalova ndanë përroit të Ficos, valët gjithë shkumë të të cilit dukej se po kërkonin diçka prej meje. Më kot dora ime nisi t'i shtrëngonte edhe më fort fletët e romanit të porsasharë, ndërsa ecja buzë përroit. Unë e ndieja se vendi i tyre ishte atje dhe, sa më tepër që i shtrëngoja, aq më qartë e kuptoja se s'kishte shpëtim për to. Dhe vërtet, pikërisht kur dora ime ishte shtrënguar më fort, ajo u hap papritur dhe me një lëvizje të beftë i hodhi fletët në përrua.

Nuk ktheva kokën për të parë valëvitjen apo përpirjen e fletëve prej ujërave. Kujtova se do t'ia plasja të qarit, por, për çudi, jo vetëm s'e bëra këtë, por e ndjeva veten disi më të qetë. Përpara portës së kako Pinos, stolisëses së dikurshme të nuseve të qytetit, më përshkoi vetëtimthi keqardhja që nuk isha më i madh në moshë, që të martohesha e t'i harroja ndoshta të gjitha këto. Pastaj m'u kujtua befas ngazëllimi dehës i disa ditëve më parë, shija e të cilit ishte e pakrahasueshme me asgjë, dhe turbull, fare turbull, e kuptova se gjithë ai gëzim nuk mund të vinte në botë i vetëm, pa dhembjen e vet.

NË TRONDITJE

Jam kush jam.

Një rast i pakuptimtë
si çdo rast.

Të tjerë paraardhës
mund të kishin qenë të parët e mi,
por nga një tjetër fole
do të kisha fluturuar,
nga fundi i një tjetër trangu
jam shpërfaqur në luspa.
Në garderobën e natyrës
ka mjaft kostume.
Kostumi i merimangës, i pulëbardhës, i miut të
fushës.
Secili menjëherë të shkon për shtat
dhe mbahet lirshëm
derisa grisët.

Edhe unë nuk përzgjodha,
Por nuk ankohe.
Mund të kisha qenë dikush
krejt më pak e veçantë.
Dikush prej stome, prej milingonash, prej një
luzme bletësh që gumëzhijnë,
një grimë panorame zhvatur nga era.

Dikush krejt më pak i lumtur,
mësuar për të bërë futro
për të shtruar tryezë festash
me diçka që lëvrin nën xham.

Wisława Szymborska
Përktheu Pandeli Çina

GRAZHDI NË BARDO

OLGA TOKARCZUK

Bardo gjendet në Sudete, në një rën nga luginat që këtu janë veçanërisht me shumicë; rrudha të vogla në fytyrën e tokës, sa këmbët e pulës. Ky vend ka historinë e vet të hershme, shumë e shumë kohë më parë, këtu nxirreshin xeherorë të çmuar, ametist dhe nefrit. Qarkullojnë legjenda që ka edhe ar. Sepse shkëmbi i zakonshëm në brendësi të malit, nënshtruar presionit të madh dhe disa forcave të misterhme, pastrohet vetiu nga materia e zakonshme, destilohet po vetiu, me pika në errësirë shndërrohet në ar të pastër, i cili do të mbetet atje në jetë të jetëve. Mbase edhe për shkak të këtij floriri të nëndheshëm, këtë vend e zgjodhi figura e magjishme e Shën Mërisë, më e vjetra e këtij lloji në Silezinë e Poshtme.

Një herë e një kohë këndej kalonte rruga tregtare nga Silezia për në Bohemi dhe pikërisht falë saj lindi edhe kjo qytezë. Precipitoi në luginë dhe nuk mëton t'u ngjitet shpateve të pjerrët. Disa herë në histori për shkak të shirave, mbase edhe lëkundjeve të lehta sizmike, shpatet kanë rrëshqitur rrezikshëm, duke shkatërruar shtëpi e duke vararë banorët e tyre. Sot mbi qytet sundon dhe i kuq- ngaqë edhe pemët nuk kanë guxim të rrezikojnë jetën e tyre- dhe i kuq përzier me shkëmbinj e që duket që përtej, si plagë në jeshillëkun e pyjeve. Qyteti i ngucur në luginë, pra, ngjet si të jetë shtrenguar nga një korsë ortopodike, sikur pa prezencën e shpateve të



Tregimi me titull "Grazhdi në Bardo", është nxjerrë nga vëllimi me tregime Sonatë për shumë tamburë, botuar nga IDK në vitin 2019. Autorja polake, Olga Tokarczuk është fituese e çmimit Nobel 2018

mprehta që e mbajnë nga të dyja anët, kishte për t'u shkërmoqur dhe asgjësuar menjëherë.

Në fund të luginës rrjedh një lumë i vogël, kështu që shtëpitë ngjishen pranë tij dhe hyjnë tek njëra tjetra. Urat e vogla e mbërthejnë të gjithën

si me tokëz. Këtu ka dy kisha, një manastir, një restorant dhe disa bare të vegjël që ofrojnë specialitetin e zonës- troftë me bajame, ka dy shkolla të arsimit bazë, një shkollë profesionale dhe pak industri të lehtë. Ka natyrisht edhe një qendër

balneare- dikur tek këto burime ujërash minerale vinin shumë mysafirë- sot nga ajo kohë ka mbetur shëtitorja, disa plepa tashmë me myk dhe burimi i ujit mineral, rrethuar me stola guri. Ka mbetur po ashtu edhe një pjesë e parkut me rododendronë. Padyshim edhe grazhdi.

A e dini që Krishtlindjet i ka festuar për herë të parë Papa Liberius më 25 dhjetor të vitit 345? Që tri shekujt e gjysmë të parë nga lindja e Zotit kanë kaluar pa rënë në sy, që epifania e përvitshme kryhej pa zhurmë si rënia e një gjetheje të tharë?

Ditën nuk e zgjodhën rastësisht, kanë mbajtur me siguri parasysh trishtimin njerëzor, kur ditët janë më të shkurtra, kur fryjnë erërat dimërore të veriut, kur duket se dielli nuk do të ngrihet kurrë guximshëm në lartësitë e qiellit. Pikërisht atëherë përftohet përshtypja që e gjelbra është ngjyrë e ëndërruar, që nuk ekziston në realitet, që çdo lulëzim ishte një anomali e moçme.

Dikujt i ka shkrepur në kokë të ndërtojë grazhdin e parë, mbështetur në disa fjali të biblës, ka zbuluar disa vizione në shkrimet e shenjta të ekzaltuara, ka kujtuar ca historira të rrëfyera në apokrifë.

Grazhdi po ngrihej si një qytet-ngadalë, me durim, duke nisur nga një shenjë e vetme që përcaktonte vendin e shenjtë- fillimisht nëpër kisha u vendos vetëm djepi- ky vend çuditërisht banal i lindjes së Zotit, më pas në të vendosën edhe figurën e fëmijës. Akoma më vonë u shfaq edhe nëna e tij – një grua ulur me fëmijën në krahë, nga fëmija godet e bardha, gjë që e bën fytyrën e femrës të duket më e errët. Mirëpo me këtë kishte nisur procesi i përshtatjes, i cili kishte për të vijuar pafund- duhej edhe një burrë përderisa ishte gruaja me fëmijën, duheshin dëshmitarët e kësaj ndodhie, njerëz dhe kafshë, do

të duhej edhe natyra e mrekulluar nga kjo lindje – guvë, qiell, yje, engjëj që dukeshin interesantë përtej perdeve të kupës qiellore.

Qysh nga ajo kohë kau dhe gomari që janë duke vështruar foshnjën lakuriq në sy kanë një pyetje memece: mos vallë Zoti njerëzor ka lindur edhe për kafshët? Po, po, ashtu është, u përgjigjej butë gruaja duke treguar me dorë dashin. Atë moment në grazhd kishin hyrë tre Mbretërit- ylli polar u pat treguar udhën. Engjëjt u vëllazëruan pa protesta me pastorët interesantë. U bënë shumë, potere, si në çdo panair vjetor.

Shën Françesku ishte regjisori i parë- e uli Jezusin e vogël në kashtën erëmirë dhe me këtë gjest të thjeshtë e hapi grazhdin për emocione njerëzore. Atje ku brishtësia e trupit njerëzor mplekset me fuqinë e ngjarjes kozmike, koha përtërihet. Dhe duke qenë se koha pa rrëfim është e vdekur dhe mund të mos ekzistonte fare, kërkohet që në këtë moment të thirret për të luajtur në një ritëm unazor po një engjëll- i cili do të paralajmërojë ndodhinë; arratinë me gomar, kërkimin e strehëzës, gjetjen e guvës, momentin e errësirës, në të cilin kryhet lindja sekrete nga trupi i femrës, madje edhe drita qysh nga ky çast ka për të ndërruar vend shumë herë me errësirën. Në qiell duhet të jetë ylli udhërrëfyes, suita e Tre Mbretërve, një sasi marramendëse detajesh, përndërimi i tyre bëhet mekanik që të mund të riprodhohet pafundësisht- sa i ëmbël është për syrin ky akt përkore! Por është edhe hapësira- edhe ajo dëshiron të ketë diçka për të thënë- Lizbona, Saragossa, Praga, Mynihu, Viena dhe Ollomunieci, Brno dhe Krakovi, Lvuvi dhe Buennos Aires-i i largët- çdo vend i tokës dëshiron të jetë dëshmitar i

lindjes së Zotit dhe ta blatojë atë me diçka konkrete- bimët e zonës, mollë apo shegë, fusha gjeometrikisht të përsosura të mbjella me patate apo plantacione me portokalle... Dhe përderisa kemi hapësirën, duhet edhe materia- lënda duhet të përfshihet në lindje- Jezusi do të lind prej dylly dhe qelqi, nga terakota dhe briri i elefantit, nga druri dhe guri. Do të jetë në përmasat e një purteke, në dimensionet e një fëmije normal, por edhe më i madh, ngaqë është Zoti dhe masat njerëzore nuk kanë të bëjnë me të.

Grazhdi në Bardo përmendet për herë të parë në vitin 1591 në dokumentin e jezuitëve “Excursio Glacensis, do të thotë Konvertimi i Tokës së Klloxkit”. Nuk dihet megjithatë si dukej atëherë dhe kur u krijua. Jezuitët kundërreformatore me siguri patën vendosur ta zmadhonin dhe shenjtëronin. E kanë pasur obsesion shenjtërinë. Përfytyronin skena të lëvizshme, të ndryshueshme- që engjëlli të paralajmëronte bindshëm duhej të shfaqej dhe zhdukej, Jezusi i vogël le të mësonte në tempull duke lëvizur dorën, edhe ylli le të zhvendosej nëpër kubënë qiellore të drunjtë në ritmin e një kërmilli qiellor. Kishin sjellë nga Tiroli një specialist për grazhdet e lëvizshme- njëfarë Ksavery Nisa, i cili pat kaluar këtu ca mote të mirë, duke e ribërë dhe përsosur grazhdin, por që pat vdekur para kohe. Kishte lënë për fat një çirak shumë të zotë, - endacak,- Mihal Klahrën- i cili kishte marrë përsipër vijimin e punimeve. Nëse figurat e Nisa-s ishin jashtëzakonisht realiste dhe të përpunuara në çdo detaj, këto të Klahri-t, për shkak të ndryshimit të shpirtit të kohës, ishin të stilizuara dhe të thjeshtëzuara. Me kohë ato dukeshin sikur botën e grazhdit e popullonin dy raca

njerëzish dhe dy lloje kafshësh. Me vdekjen e Klahr-it plak, veprën e vazhdoi i biri, Mihal Ignaci, por edhe ai kishte dorë tjetër dhe duke qenë se porositesit e dikurshëm tashmë kishin vdekur, nuk dihej mirë cilës ide t'i përmbahej. Grazhdi sikur po rritej për hesap të vet, duke iu afruar në mënyrë diskrete rregullit, pa pyetur tashmë për vdekjet e krijuesve të tij. Më vonë ishte shfaqur njëfarë Jeschke, usta altarësh, i cili i dha grazhdit thellësi më të madhe, duke ngritur skena të tjera, por edhe qiell. Pas tij shtoi të vetën edhe një çek nga rrethinat e Kralikut, çka atëbotë ishte koncept më i avancuar european i grazhdeve dhe, në frymën e modës së Tirolit, e shndërroi të tërën në një lloj teatri kukullash. Figurat e dikurshme tani gjendeshin në transmise të lëvizshme, në qarqe të padukshme për syrin e njeriut dhe lëviznin me ndihmën e një maniveli. Ky çeku, apo pasuesi i tij, shtoi edhe disa skena të tjera, të tilla që po ajo guvë me Fëmijën dhe Familjen e Shenjtë sikur gjendeshin në në plan tjetër, ajo duhet qëmtuar dhe nxjerrë nga turma me ngjyrat e njerëzve, kafshëve, shtëpive, drurëve, objekteve. Gjithë kjo masë shtillej, lëvizte në formë rrethore, dilte dhe kthehej në të njëjtin vend. Kështu që kur u shfaq një specialist i shquar i grazhdeve nga shekulli XIX, murgu Helbig, i kishte mbetur vetëm ta zmadhonte në hapësirë Grazhdin e Bardo-s. E bëri në një mënyrë shumë origjinale- e futi në kub të madh prej xhami, e rrotulloi rreth bishtit të vet, lidhi fillimin me fundin, do të thotë bëri diçka që skualifikonte një herë e mirë kohën lineare.

Këto njoftime të hollësishme i përfshiu në punimin e saj një femër, banore e Bardo-s, të cilën le ta quajmë thjesht Maria Kovalska, duke fshehur kësajsoj emrin e saj të vërtetë,

gjë që në dritën e fakteve të mëtejme ka për t'u dukur me siguri manovër e goditur. Ajo ishte një mësuese nga Grodno, piktoresh, që kishte ardhur në këto anë pas lufte, sikundër edhe banorë të tjerë, dimrin e vitit dyzetë e gjashtë. Gjatë transferimit nga Lindja, me gjasë pat humbur fëmijën e vogël, ka shumë mundësi që kjo të ketë ndodhur në Vigjiljen e acartë. I shoqi i kishte rënë disa vite më herët, i kapur nga rusët dhe i shpënë në Lindje. Për fat të keq nuk di asgjë të sigurtë për këtë temë. Di veç një gjë që ajo kishte një arsimim të lartë artistik, kështu që natyrshëm i ra asaj për hisë të siguronte këtë objekt antik. Me këtë rast kishte marrë edhe shtëpi në po atë godinë ku ishte vendosur grazhdi- një ndërtesë e zymtë, dykatëshe mbështetur në skarpat.

Sot vështirë të thuhet si dukej grazhdi menjëherë pas lufte. Mund të mbështetemi kryesisht në punimin e asaj gruas Kovalska, e cila me shumë ndjeshmëri dhe merak kishte mbërritur tek të gjitha burimet e mundshme, në masën më të madhe gjermane. Përshkrimin e saj të hollësishëm e mbështeste me fotografi, cilësia e të cilave lë shumë për të dëshiruar- pjesa dërrmuese e detajeve në ato foto as që duken fare.

E sigurtë është që grazhdi zinte pothuaj gjithë hapësirën. Ishte një kub prej xhami që nuk i linte asgjë mangët një cope të stërmadhe akulli. Në qendër, në një shtyllë druri të latuar, fshihej një mekanizëm. Çdonjëra prej katër skenave ishte pothuaj dy metra e gjerë, teksa hapësira e grazhdit dukej shumë më e madhe, ngaqë artistët e mëparshëm këtë hapësirë e kishin shumëfishuar duke e prerë me një perspektivë dramatike, realizuar me të njëjtin truk si kori i vendosur në podiumin e skenës bën që "largësia" të thotë

thjesht "më pranë qiellit". Ndjijmi i thellësisë e përforconte edhe më këtë gjënë e vogël të jashtëzakonshme në muret e brendshme që fshihnin mekanizmin që vinte në lëvizje figurat- në ajrin e bojatisur ngjiteshin trajta gjysmë të tejdukshme të të gjitha qenieve të mundshme: kafshë, njerëz, djaj, engjëj, insekte, hibridë, përbindsha që vjellin zjarr. Konturet hynin tek njëri tjetri, njollat e ngjyrave përziheshin dhe shumëfishoheshin si të kapura në një lëvizje të përjetshme transformimesh të pandalshme. Një lloj teknike transparente piktore bënte gjithsesi që ato të ishin përherë të dallueshme dhe të dilnin guximshëm nën të tjerat në mënyrë të atillë që përfitohej përshtypja që hapësira e rrafshët ka thellësi dhe që shumica e qenieve zgjatet në një dimension tjetër, këtë radhë të pafund. Qielli ishte plot e përplot me këto trajta fluide. Mbinin nga çdo copë e vogël e hapësirës duke mbushur tablonë me një mijë fluska sapuni. Bebet e tyre të syrit fiksonin qiellin. Gjithçka vëzhgohej ndërsjelltazi, asnjë lëvizje nuk i shpëtonte vëmendjes së syrit të çdokujt. Dhe ky vështrim i amplifikuar fiksohej tek shikuesi një mijë herë, ndërgjegjshëm, vëmendshëm.

E gjitha kjo shërbente si sfond për qiellin, panoramën, skenat dhe figurat, ndoshta madje edhe për kohën, e cila këtu ishte pak e mangët ngaqë i mungonte disi lineariteti dhe rregulli, sillej rrëmujshëm brenda këtij kubi të qelqtë si një pështjellim ajri.

Në mesin e këtij kaosi të hareshëm ngulitej Adami me Evën pranë një molle, të dy golomeshë, plot hire, duke parë njëri tjetrin edhe me dashuri, ende para mëkatit. Sakaq në faqen ngjitur shfaqej një kokërr molle në madhësinë e manit të tokës dhe një shpatë e praruar shndërriste nga përtej reve. Me këtë mbyllet turpshëm linja e rënies për të dalë

në skenë vëllezërit e sherrosur ku aty për aty, pa kurrfarë paralajmërimi, shfaqet plaku që shtyn drejt barkës një kafshë ekzotike. Pranë tij Moisiu që godet me stap në shkëmb, ndërsa më tej profetët dhe do farë figurash jo fort të qarta, që kërkojnë identifikim, të rreshtuara në radhët e dymbëdhjeta, të dhjeta dhe të shtata. Figurinat në taracat e sipërme po vogëloheshin- ato në majë fare, pranë qiellit, do të thotë, larg, ishin bërë si ca toptha druri të përafuar në dukje vetëm me njerëz, mirëpo që të mund të zbuloje këtë marifet, këtë mashtrim të vogël, do të duhej të hiqje xhamin, të fusje kokën dhe më e mira ta shihje këtë gjë me lupë.

Turistëve, atyre që u kishin ardhur në majë të hundës vizitat dhe që tani kishin ardhur për të parë grazhdin, u mjaftonte veç kërshëria plot admirim, mirëpo Maria Kovalska, që këtu ishte e vetmja guidë, i shtynte përpara, do të thotë të bënin rrethin e plotë; ishin nisur nga një pikë dhe aty duhej të përfundonin- fëmijë që mbeteshin gojëhapur nga mrekullia, pëshpërimita plot mahnitje të të rriturve.

Në sfondin e këtij qielli të shturrur, në plane të tjera, të cilat me lehtësim të shkoqur i kishin çliruar nga kontekstet fetare, ishte ndërtuar me dru dhe letër-mâché një maket tridimensional i kodrave, fshatrave dhe qytezave, minierave dhe fabrikave. Në këtë nivel figurat kishin fituar befasisht jetë konkrete, ndonëse ende të palëvizshme. Figurinat njerëzore të bëra me finesë, kominoshet e minatorëve të sajuara për bukuri, fustanet e damave (kapelat në miniaturë ngjanin me ëmbëlsirat e krishtlindjeve), kostumet e burrave, veshjet popullore jo fort të përcaktuara, mbushnin panoramën. Këtu, në këtë palëvizshmëri kozmike, ndodhnin dhjetëra histori njëherazi – nga

DËSHMI

Megjithatë njohe flakët e skëterrës.
 Madje mund të thuash, se çfarë janë: të vërteta,
 Të mbaruara me kanxhë e mprehta,
 që ta copëtojnë mishin
 Pjesë-pjesë, deri në asht.
 Dhe shkove rrugës
 Dhe është bërë ekzekutimi, gjakderdhja,
 goditja me kamxhik.
 A thua mban mend, ndaj nuk dyshon
 Me siguri ekziston Ferri.

Czesław Miłosz

poshtë Magët ndiqnin yllin, i cili pas një rrethi i shpie tek Foshnja në djep. Në të njëjtën kohë pranë është Jezusi, tanimë i rritur që i zgjat Judës faqen për puthje, kurse Ponc Pilati lan duart në një lavaman që imiton takëmet viktoriane. Pas tij një kërriç me turi qesharak prej miu ngrinte para Herodit Familjen e Shenjtë në mesin e minatorëve që dukeshin duke punuar në shpatet e një mali prej letre. Miniera hapej drejt zemrës së malit si sezam, nga brenda shndriste qymyri, që për ç'arsye digjej kuqërremsh. Përqark shtëpive të fshatit kullotnin lopët, ndërsa pas tyre një fabrikë ngjyrë tulle dhe një rrugë plot me vetura të vogla démodé në një afërsi të rrezikshme me grupin e shqytarëve që adhurojnë Fëmijën.

Nuk kishte të sosur ky rrëfim me figura, por nuk kishte as parim, skenat kalonin tek njëra tjetra, mplekseshin papritur me një element të vetëm. Historitë plotësoheshin në anën e kundërt si një këngë me dy zëra.

Mekanizmin e vinin në punë me kursim, dy apo tri herë në ditë në varësi të sezonit. Grazhdi atëherë gjallërohej dhe ishte e vështirë ta përshkruaje, sepse lëvizja i jepte gjithë kësaj edhe një dimension

tjetër, doza të vogla të kohës rrethore, nëse në njërën anë ngrihej në fluturim mjelma e rezervatit, në anën e kundërt lepuri hynte në strofkull. Goditjet e çekanëve në kudhër ishin lidhur me përkundjen monotone të djepit të Jezusit, lëvizja e makinave në rrugë në një farë mënyre nxirrte minatorët nga miniera, ndërsa vallja e fshatarëve me veshje popullore provokonte procesionin e dymbëdhjetë Apostujve. Lopët ngrinin kokat, nga Varri i Perëndisë dilte një zvarranik, barprerësit merrnin hov me kosat në duar, dielli rrëshqiste në horizont, në kodër rrotulloheshin krahët e mullirit me erë. Vënia në punë e mekanizmit po lëvizte figurat, mirëpo ndalte vizitorët- befasoheshin dhe përpiqeshin aty për aty të vështronin gjithë rendin e lëvizjes të kuptonin si funksiononte mekanizmi. Kur doradës nishin të ndërgjegjësoheshin se sasia e figurave dhe skenave ishte tepër e madhe për t'u përmbledhur, nishin sërish t'i vinin qark duke zbuluar me zor lidhje të veçanta. Por asesi gjithë misterin e grazhdit.

Shënimi i parë që pat gjetur Maria Kovalska lidhur me grazhdin në gazetën e dikurshme sileziane, kishte

qenë një artikull i shkurtër i paraluftës mbi atraksionet turistike të qytezës. Në të ishte shkruar: “Grazhdi bën përshtypje aq të madhe tek besimtarët saqë nuk mundën të mbajnë dot lotët.” Mund të përfytyrohet se Kovalska me këtë fjali të jetë ndjerë e çliruar nga mëkati. Ka mundësi që – siç tregonte zoti M., ndihmës dhe mbikëqyrës- të ketë qarë teksa shihte funksionimin e grazhdit.

Kishte qenë verë, një vit pas mbarimit të luftës, kur zoti M., kishte riparuar mbulesën dhe kishte sajuar një çelës të posaçëm për kurdisjen e mekanizmit.

Atë që për herë të parë kishin parë të dy bashkë, mekanizmin, e di nga zoti M., i cili për fat të keq nuk është gjallë. Kishin ngritur mbulesën metalike dhe parë si në pus me elektrik dore lëvizjen e sustave, ingranazheve dhe transmisionit. Të përbrëndshmet e pluhurosura të një sahati. Mund të imagjinohet se një pamje e tillë të mbetet në mendje. Ka shumë mundësi që ndoshta çprej asaj dite Maria Kovalskës t’i ketë dalë në ëndërr, çdo herë ndryshe, -ose i hiperbolizuar në përmasat monstroze të ndonjë qyteti, apo e kundërta – brendësia përndritëse në miniaturë e orës së grave.

Herë tjetër kishin parë brendësinë e grazhdit kur mekanizmi ishte ndalur, kishte çarë atëherë nëpër borë për tek zoti M., i vetmi njeri që mund ta këshillonte për gjësend, ndërsa ai i përgjumur, me xhubin hedhur mbi pizhama, ngrinte çantën me vegla. Në të vërtetë nuk dihet si mundi ta riparonte mekanizmin. Thoshte që fillimisht me një pompë gome (me siguri që kishte mbetur nga vdekja e ndonjë foshnje) kishin hequr pluhurin dhe pastaj me pambuk ngopur me alkool kishin pastruar mekanizmin. Zoti M. kishte spostuar me pincë një cep llamarine dhe

KUR HËNA

Berkeley, 1966

Atbotë kur hëna dhe gratë shëtisnin
Me fustane shumëngjyrëshe,
Mahnitë me sytë e tyre, qepallat
dhe tërë rregullimin e botës.
Dhe gjithnjë më duket se nga ajo
prirje e madhe reciproke
që më në fund mund të rrjedh
e vërteta përfundimtare.

Czesław Miłosz

gjithçka kishte lëvizur. Megjithatë Kovalska e dinte që një ditë defekti do të përsëritej, nuk përjashtohej që këtë radhë i gjithë Grazhdi i Bardo-s të ngecte përgjithmonë. Zoti M. ishte i mendimit që në të ardhmen gjithçka të bëhej elektrike, që të hiqej dorë nga maniveli primitiv, mirëpo një ndryshim i tillë do të kërkonte remont serioz. Poqese përmbushej ideja e zotit M. do të mjaftonte vetëm një shtypje butoni. Sa të hidhej ideja do të përfshiheshin specialistët nga Vrocllavi që do të ndalonin çdo lloj ndërhyrjeje arbitrare.

Kjo Kovalska bënte sa mundejmbante për shembull në gjithë mjedisin të njëjtën temperaturë, dhe kjo ishte vërtet e vështirë- furnizimi me qymyr nuk ishte gjithmonë i mjaftueshën në dimrat e acartë, ndërsa në verë çatia e keqizoluar bënte që brenda të ishte zheg i padurueshëm.

Në vitin e dytë të paqes në Bardo nisën të vinin ekskursionistë nga shkollat, fillimisht nga rrethinat, më pas nga e gjithë Polonia- turmë që rritej çdo pasdite në pritje për t’u bërë tridhjetë vetë. Bënte kujdes që të mos vihej në punë mekanizmi për

një numër më të vogël vizitorësh-hera herë i duhej të vetëpërmbahej për të mos u thënë të mbanin frymën, të mos lëshonin avull nga goja, të mos çlironin dioksid karboni, të mos e shtonin lagështinë e ajrit. Ca kohë më vonë në hyrje kishte sajuar një dyqan të vogël suveniresh- kishte porositur kartolina me grazhdin, një seri fotosh të lidhura fizarmonikë. Donte të kishte gjithashtu edhe guida në Sudete, mirëpo të tilla nuk ekzistonin ende në polonisht, përkthimet sapo kishin nisur dhe dihet që në këto raste nuk bëhet fjalë vetëm për përkthim. Grazhdit i duhej dhënë frymë sllave, prezencë polake.

Kjo ishte e gjitha çfarë mund t’u ofronte ekskursionistëve të shkollave dyqani i vogël pranë Grazhdit të Bardo-s. Kur në mbrëmje mbyllte dyert e godinës së grazhdit me çelësin e madh pothuaj antik, drithërohej nga frika e hajdutëve, zjarrit, shkarjes së dheut, përmbytjes, rrufeve, stuhisë, suferinës që mund t’i vërviste çatinë.

Zoti M. tregonte sesi ajo kalonte në grazhd ditë të tëra. Shpesh e shihte sesi përkulej para ndonjëres prej

faqeve të murit dhe me tundje koke ndërronte pikëvështrim. Zoti M. e merrte me mend ku e kishte hallin në një numër kaq të madh planesh aty edhe një diferencë e imtë e perspektivës mund të ndryshonte aq shumë fushën e shikimit sa që mund të shfaqej një kuptim i ri i skenës.

Le të marrim për shembull Tre Mbretërit. Kur i sheh si përkulin kokat para Fëmijës në grazhd, si ulin madje kuajt dhe devetë e tyre, ishte e qartë se bëhej fjalë për Lindje. Por ata mund të shihen edhe në sfondin e peizazhit, shkëmbor, shkretinor dhe pakëndshmërisht shkretor- në këtë rast përftohej përshtypja se kishim të bënim me një kamp cirku, i cili ka pushuar për një çast dhe tani të gjithë po përkulen mbi burimin e ujit për të shuar etjen. Apo edhe më ndryshe akoma- më lart, në një plan tjetër, duken koret qiellorë, qindra engjëj që qëndrojnë në rresht krahëhapur, kryengjëjt e artë dhe fronat mbretërorë në kornizën qiellore dhe atëherë këta tre burra me rroba të shtrenjta dhe me suitën dukeshin si të ishin donatorët e tablosë së shenjtë, të cilët, sipas zakonit, vendosen në këmbët e shenjtëve. Dhe kësaj mund të argëtoheshe me ditë të tëra. Gjë që e bënte gjithashtu edhe kjo Kovalska.

Zoti M. fliste për të me keqardhje. Me gjasë asgjë nuk zgjon tek meshkujt një keqardhje të tillë sa një grua e vetmuar. I kthehej me ngulm fëmijës së humbur, nga e cila nuk mund të ngrihej dot asnjë nënë. Ndoshta për këtë shkak kishte për të respekt në distancë pavarësisht atyre alarmeve të natës kur e thërriste të shkonte pas orarit të punës, ndonjëherë edhe gjatë natës, për të kontrolluar nëse gjithçka ishte në rregull, se mos mungonte gjësend, apo nëse diçka nuk ishte në vendin ku duhej të ishte. Zoti M., një njeri

i thjeshtë, që gëzonte kënaqësitë e jetës, e konsideronte grazhdin si një objekt të bukur e të ndërlikuar, falë të cilit kishte punë të përhershme. Merrej me pastrimin e mjedisit, kujdesej për gjithë godinën, kryente riparime të vogla, mbante kopshtin e vogël para hyrjes. Grazhdin e njëjtte mjaft mirë, e kishte të regjistruar në tru, megjithatë asnjëherë të gjithin. Mbante mend figura të veçanta, për shembull njeriun me hejbe dhe qen ose grupin e minatorëve që luanin damë. Nuk mundej gjithsesi ta tregonte të gjithin. Ndaj edhe ndihej i pasigurtë tek dëgjonte ankesat nervoze të Kovalskës se në grazhd diçka mungonte nga ato që ishin. Nuk ishte e mundur që ndokush të mund të hynte në godinë, të hapte kutinë e mbyllur prej qelqi dhe të nxirrte prej andej ndonjë figurë. Kështu që ankesat e saj i merrte si histeri të shpirtit të saj të molepsur, si simptoma të një çmendurie të lehtë jokërcënuese. “Vërtet nuk ka pasur rosa në pellgaçe?”, e pyeste me nervozizëm. “A nuk notonin në ujë rosat e vogla me ngjyra?”. Zotit M. nuk i vinin ndërmend kurrfarë rosash. Mirëpo ngaqë ajo këmbëngulte aq shumë edhe ai fillonte të dyshonte se ndoshta me të vërtetë mund të kishte pasur rosa por që më herët nuk i kishte vënë re, pellgaçja ishte në madhësinë e një monedhe. Ndoshta tek pastronte herën e fundit kasetën mund të kishte rrëzuar me mëngën e këmbës pjesë rreth pellgaçes dhe ato të uruara rosa, në madhësinë e një kokrrë gruri, siç e përfytyronte, mund t'i ishin ngjitur tek leshi i ashpër i trikos dhe të kishin rënë.

Rosat. Bëzhdila të vogla druri të lyera me penel tepër të hollë. Me qafa të gjelbra dhe sqepa të kuq- të tilla u shfaqën një ditë prej ditësh në grazhd. Po u gëzohej rosave. U bë më

mirë që u shtua diçka sesa të hiqej.

Ajo, kjo Kovalska, shkonte shpesh atëkohë në Vrocllav, seç regjistrohej në disa kurse, mësonte gjermanisht. Zoti M. ndizte stufën në shtëpinë e saj që të mos i ngrinin lulet. Tregonte se atje ajo kishte një atelie të vogël-bojëra, beze, gjithë çkanë artistët. Në shkollë në Bardo drejtonte rrethin e pikturës. Kohë pas kohe i sillte ndonjë gjë nga ato që i kishte me tepri: ndonjë trajse me arra të mbledhura në kopësht, ndonjë kosh të vogël me luleshtrydhe, në vitin kur bëheshin me bollëk në bahçen e tij, ndonjë kavanoz me reçel ftoi nga duart e gruas së tij. Gjithsesi me të nuk merrej vesh me tamam. Me tamamdo të thotë të kishte raporte të tilla që të ulej ndonjë natë në tavolinë, të hapte ndonjë shishe vodkë dhe të llafosej. Do të ishte gjë tjetër po të ishte burrë, ajo për të gjithë rreth e qark mbetej një grua e vetmuar që kishte humbur dikur fëmijën dhe burrin. Nganjëherë ndonjë fatkeqësi të mban larg përgjithnjë. Dora e perëndisë, thoshte, u zgjatet njerëzve të prekur nga fatkeqësi dhe i vendos ata disi më lart se të tjerët, apo pak mënjane, me qëllim që të dojë t'i bëjë duart hinkë dhe t'i thërrasë e t'i ftojë sërish.

Vetëm pas një farë kohe, gjatë riparimeve të vogla, zoti M. vërejti, se në grazhd gjithmonë diçka shtohet, diçka ndryshon. Për shembull treni ecte lart, tamam nën koret qiellorë në sfondin e panoramës dimërore bojatisur me të shpejtë. Ishte gdhendur saktësisht në dru, më pas i lyer- një lokomotivë e vogël dhe disa vagonë, por jo për pasagjerë, vetëm vagona mallrash. Për këtë ishte i sigurt- treni më parë nuk ekzistonte dhe kur shkoi tek ajo për t'i treguar i emocionuar, në çast kuptoi faktin evident- ishte ajo që e kishte bërë trenin, më herët edhe rosat. Atë moment edhe ai qëndroi në vend,

ELEFANTI

Në të vërtetë elefantët janë shumë të ndjeshëm dhe nevrinë. Kanë një fantazi të zhvilluar, që u lejon nganjëherë ta harrojnë pamjen e tyre. Kur hyjnë në ujë, i mbyllin sytë. Kur shohin putrat, i kaplon hidhërimi dhe qajnë.

Kam njohur një elefant, që ra në dashuri me një kolibër. U dobësua, nuk flinte dhe në fund vdiq nga zemra. Ata, të cilët nuk e dinë natyrën e elefantëve, thanë: sa i trashë ishte.

Zbigniew Herbert

ndezi një cigare dhe iu kthye me ngë punëve të tij, për të rregulluar një ulluk të dëmtuar, pastruar oborrin apo edhe të digjte gjethet. Më vonë nuk i ra në sy që e dinte. E pranoi trenin si të ishte atje gjithmonë. Hera herës merakosej se mos e merrte për idiot, megjithatë në fund i dha dum që është tashmë aq plak sa të mos e çaj kokën për gjëra të tilla. Përse t'i bëhej vonë ç'mendonte ajo për të? Në fund të fundit ajo ishte një grua që kishte humbur fëmijën, njerëzve të kësaj prejaje u takon një lloj i posaçëm mirëkuptimi. Kështu që vitin pasardhës, e pastroi trenin nga pluhurat njëlloj si Jezusin, Shën Mërinë dhe Tre Mbretërit, njëlloj si minatorët pendëpupël, shtëpizën me kopësht, në ballkonin e së cilës familja e vogël qëndronte në tavolinë, njëlloj si togën e ushtarëve dhe tankun që vinte pas tyre, njëlloj si Jezusin-fëmijë që mësonte në faltore, mullirin me erë, çiftin që vallëzonte në dasmë, njëlloj si skeleritë përreth rrënojave dhe muratorët që punonin. Madje as që mendonte fare çfarë kishte qenë e çfarë ishte shtuar. Kishte përshtypjen që çfarëdo t'i shtohet grazhdit do ta gjente vendin e vet, do të shkrihej në peizazhin plot e përplot me engjëj. Po, kështu është, këtu shkonin edhe figura të vogla njerëzish me njolla gjaku në këmishat e bardha, tehet e

vegjël të trikëmbshave, figurat gri në sheshin rrethuar me tela me gjemba, kullat e vrojtimit mbushur me tyta karabinash të vogla. Le të jetë edhe kështu, thoshte me vete. Le të gjejnë vendin e tyre edhe fshatrat e djegur dhe rrënojat e qyteteve, pse jo edhe varrezat në miniaturë me kryqe më të hollë se kunjat e shkrepes. Le ta ketë, mendonte, është duke bërë një gjë të mirë, nuk prish, por shton, edhe më shumë madje nga ç'mund të riparonte. Më tepër nga ç'mund të kujdesej.

Dhe kështu rrodhën disa vjet, gjatë të cilëve mekanizmi kishte ngecur disa herë, një herë vërtet seriozisht, sa që u desh të thirrej një specialist nga Polonia qendrore, por edhe ai nuk qullosoi ndonjë gjë të madhe. Tha të mbyllej grazhdi dhe të mos vihej në punë me manivelë. Sigurisht që zoti M., nën përgjegjësinë e Kovalskës, riparoj kushinetën e dëmtuar, ndërroi ndërkaq edhe dy rrota të dhëmbëzuara si dhe krikun e vogël. Për grazhdin shkruan gazetata, larg, në Varshavë, dhe qysh prej asaj kohe turistët që bridhnin maleve zbrisnin posaçërisht në Bardo për të parë grazhdin. Madje edhe kalimtarët, të gjithë ata që shkonin në Çeki apo në të kundërt, ekskursionistë dhe udhëtarë të zakonshëm që vizitonin familjarët,

edhe nëpunësit me shërbim, ba, aty edhe shoferët e trajlave që kalonin këtyre anëve tranzit, të gjithë që kalonin këtej, shkonin të shihnin grazhdin. Kovalska paraprakisht u kishte nxjerrë librin e përshtypjeve që të mund të hidhnin impresionet e para, duhet të ketë qenë e sigurtë se do të ngazëlleshin, nevoja e nënshkrimit në grazhd, qoftë edhe në formën çuditërisht banale të librit të përshtypjeve, i shtyn ata drejt tavolinës për të kapur lapsin e lidhur dhe të shkruajnë "Jam nga Krakovi, deri tani kam parë shumë grazhde, por ky i kaloi pritshmëritë e mia më të mëdha", ose "Marisha nga Gdanjsku, jam tetë vjeçe. Më shumë më pëlqen çifti i ri dhe dasma që kërcen", apo "Ich heisse Thomas Schultz, das ist schön".

Ky libër është i vetmi suvenir që ka mbetur nga Grazhdi i Bardo-s. Në vitin 1957, pas shirave pranverore skarpati rrëshqiti sërish, sikundër kishte ndodhur disa herë në të shkuarën. Ndërtesa ku ishte montuar grazhdi u dëmtua seriozisht- kishte rënë një nga faqet e murit që kishte shkatërruar gjithë konstruksionin. Specialistët nga Universiteti i Vrocllavit arritën të shpëtonin fare pak. Shkencëtarët çmontuan atë çka kishte shpëtuar, nxorën nga balta pjesët e mbetura, i shpunë në muzeum dhe i konservuan në arka. Grazhdi në copa përfundoi nëpër magazina dhe atje është duke pritur kohë më të mira. Me siguri nuk ribëhet dot i gjithi, sidomos që pas vdekjes së Kovalskës askush nuk e di si dukej. Nga ajo kishte mbetur ky punim i shkurtër me disa fotografi të paqarta, disa copa gazetash, pak shënime nga para lufta dhe kujtesa e dobët e zotit M., i cili atëbotë ishte ende gjallë.

Mund të gjendet megjithatë njëfarë skice apo ideje, nëse ndokush në të

VRASËSIT E MBRETËRVE

Sikundër pohon Regis-i ngjajnë me shoshoq
porsi binjakë Ravallac-u dhe Princip Clément-i dhe Caserio-ja
rrjedhin kryesisht nga familje epileptikësh dhe vetëvrasësish
gëzojnë megjithatë shëndet të kënaqshëm
zakonisht të rinj shumë të rinj dhe të tillë mbeten në përjetësi

vetmia e tyre muaj vite mprehin thikat
dhe në pyjet jashtë qytetit mësojnë të shtijnë me saktësi
shtjellojnë planin e vrasjes janë të vetëm punëtorë dhe shumë
të ndershëm
ua japin nënave kacidhet që fitojnë kujdesen për vëllezër e motra
nuk pijnë

pa mikështa dhe shokë

pas vrasjes dorëzohen pa bërë qëndresë
i durojnë torturat burrisht nuk kërkojnë mëshirë
nuk pranojnë gjatë hetimeve se patën bashkëpunëtorë
as bëhet fjalë për komplot vepruan krejt të vetëm

thjeshtësia dhe çiltërsia e tyre çnjerëzore
i acaroon gjykatësit avokatët publikun e uritur për mallëngjim

ata që dërgojnë shpirtra
në jetën e përtejme habiten me atë gjakftohtësi në çastet e fundit
para vdekjes

qetësi mungesë zemërimi madje edhe urrejtjeje

Zbigniew Herbert

ardhmen do të donte ta ringrinte.
Në të duhej të ishte gjithçka. Sepse
përderisa lindjet hyjnore ndodhin
gjithnjë dhe kudo, përderisa kanë
të bëjnë deri me gjërat më të vogla,
me çdo ndodhi- befas bëhet e qartë
se nuk është momenti i lindjes së
Zotit që i duhet dhënë botës, por
e kundërta- gjithë bota duhet t'i
paraqitet lindjes, bota të sillet në
dyert e grazhdit dhe në të të futet me
radhë gjithçka – çdo send, çdo gjë

e imët, çdo njeri duhet të paraqitet
para portretit të Fëmijës dhe të
thotë: ja ky është, Jan apo Marisha,
Pavell apo Thomas, njihuni. Po
kështu edhe çdo kafshë, nga insekti
deri tek elefantët dhe xhirafat ata
duhen futur në grazhd si në arkën
mitologjike. Ndërsa në fund fare
duhet tërhequr këtu gjithçka që
ekziston në botë, pavarësisht në është
e mirë, apo e keqe- e vetmja arsye le
të jetë vetë fakti i ekzistencës- do të

thotë luftërat dhe nxjerrja e qymyrit,
ndeshjet e futbollit dhe përmytjet,
bankat dhe stacionet e trenave,
zgjedhjet demokratike, inflacioni,
dhuna në familje, demonstratat e
1 majit, haute couture, pushimet
me kuaj, koleksionimi i makinave
të vjetra, psikoanaliza dhe fizika
bërthamore, letërsia dhe artet
moderne- gjithçka i duhet treguar
grazhdit dhe duhet besuar se rregulli
që të lë pa gojë i shkrin të gjitha në
një tablo të vetme, i lidh në një
mekanizëm të vetëm, i ledhaton në
një lëvizje të përsëritshme, e cila do
të mbërthejë përgjithmonë të gjithën
me gjithçkanë.

Në fund do të shtoja vetëm këtë
që kjo Kovalska vdiq dy vjet pas
katastrofës. Sipas zotit M. nga
kanceri. Ai vetë kishte humbur
punën e mirë në grazhd dhe çprej
atëherë i shtonte ndonjë gjë pensionit
duke bërë një punë të çuditshme:
trembte fëmijët në të ashtuquajturën
dhomën e tmerit në një lunapark, i
cili kushedi për ç'arsye kishte gjetur
stacionin dimëror në Bardo. Veshur
me një pelerinë të zezë, fytyrën lyer
me bojë të bardhë, dilte nga përtej
perdeve dhe tringëllinte një zinxhir.
Duke qenë se në guida që ndryshojnë
me vështirësi dhe ngadalë, turistëve
u rekomandohej gjithnjë Grazhdi
i Bardo-s, vizitorët të zhgënjyer
disi ngaqë u kishin besuar guidave,
përfundonin në këtë lunapark.
Vështirë të thuhet sa frikë ngjallnin
figurat e përçudnuara të ndriçuara
nga llampa e kuqe apo që dilnin
papritur nga kthinat. E rëndësishme
është që më pas, kur dilnin në
dritë, i hidhnin të gjitha pas, gjithë
luginën e thellë, gjithë atë lunapark
të çuditshëm dhe premtimet e
pambajtura të guidave, për të
vazhduar rrugën drejt qëllimeve të
tyre të padeshifrueshme.

Përktheu: Astrit Beqiraj

IMITIMI I NJË TJETËR MOSHE

YLLI RAKIPI

S'më kishte shkuar asnjëherë ndërmend se do të vinte një ditë që fare papritur të takoja Liljanën. Zakonisht me njerëzit me të cilët nuk të lidhin kujtime të mira, jo vetëm që nuk ke dëshirë të mendosh se mund ta sjellë rasti që të takohesh, po në përgjithësi i harron. Dhe këtë harresë e nxiste deri edhe fakti që familja e saj ishte transferuar para shumë kohësh në Tiranë. Por ja që me Liljanën më ndodhi krejt ndryshe. Ajo më thirri që nga larg, ashtu si dymbëdhjetë vjet më parë, si të ishim në një rrugicë fshati dhe jo në shëtitoren më të madhe të Tiranës.

Pas heshtjes ajo e gjeti e para fjalën. Dhe filloi të më pyeste për të gjithë. Se ne ishim shumë. Ndërsa ajo një. Ndoshta e vetnja nga shoqet e fëmijërisë që për dymbëdhjetë vjet s'kishte takuar asnjërin prej nesh.

Taqoja, mësues në Veri, Gramozi oficer, Bujari jep matematikë në ato banka ku dikur uleshim ne. Loli, po Loli, si gjithmonë, partizan i forcës. Punon në minierë. Xikja ban me shumë autoritet, rrezik të pëlçasë nga shëndeti. Ethem i gjatë në minierë, Stavri...

— Po vajzat? — Pyetja e saj ishte mëse e natyrshme.

— Vajzat? Hë... po, vajzat s'janë më vajza. Ka vetëm një përjashtim, pastaj

të gjitha me kuadrat në letërnjoftim. E para, Lulja, si atëherë. Gjithmonë e shpejtë dhe e papërtuar. Tani ka tre fëmijë. Valja është martuar këtu në Tiranë. Xhuli në Përmet.

— Po përjashtimi? — Qe fjala për Ritën.

— Punon infermiere në një fshat aty afër. E takoj shpesh. E di, Liljana? Të vjen vërtet keq të thuash, po Rita vazhdon të jetë po ajo Ritë e lehtë, shpirtvogël dhe e pasinqertë që ke njohur dikur. Edhe sot ajo nuk ka asnjë shoqe.

Pasai një heshtje e gjatë. Po binte mbrëmja dhe gjallëria e shëtitores po rritej nga çasti në çast. Vetvetiu edhe ne filluam të lëviznim bashkë me turmën.

— Sa interesante do të ishte sikur të mblidheshim një ditë në këtë moshë, pas 12 vjetësh... E kupton? Do të ishte diçka e mrekullueshme, — dhe ndali në vend si e përhumbur.

— Liljana!...

Befas përfytyrimi u shkund nga sytë e saj dhe, si të kishte qenë brenda meje, ajo tha:

— E di ç'do të thuash, Genci. Atë ngjarje unë nuk e kam harruar. Nuk e kam harruar sepse ajo është një moshë që nuk harron.

— Ai ishte një trill, Liljana. Një trill që e përlligj moshë.

— Jo, Genci! Ai s'ishte trill. Ajo ishte një moshë kur neve na dukej vetja të mëdhenj dhe, ngaqë na dukej e tillë, improvizuam, ose, më mirë

imituam një tjetër moshë.

— Imituam?!

— Po. Ndryshe unë do t'ju kisha mbajtur mëri, mëri për gjithë jetën.

Heshta. Për një çast m'u duk se të gjitha fjalët m'i rrëmbeu një dorë e padukshme, për të mos m'i kthyer më. Ajo kishte të drejtë. Ne vërtet kishim imituar një tjetër moshë. Po nga na kishte ardhur ai ngacmim i çuditshëm që s'ngjante me asnjë nga shtigjet ku të vërtit fëmijëria?! Po sidoqoftë brenda saj ngjarja ka diçka që të prek dhe të mallon njëkohësisht. Tek ai imitim, ndoshta disi qesharak në dukje, zë fill ai shqetësim sa naiv aq edhe i çiltër, për t'u rritur të pastër dhe të ndershëm në ditët që do të vinin...

— Kthehemi nga shtëpia, — tha Liljana duke vështruar orën.

— Faleminderit, Liljana, po sot s'mundem. E kam lënë me një shok në orën tetë dhe...

— Nesër, — tha ajo dhe, si për të mos më lënë kohë ta kundërshtoja, zgjati dorën të më takonte.

Tunda kokën në shenjë pranimiti dhe ne vend të fjalës «Mirupafshim», ashtu si pa kuptuar edhe vetë e pyeta:

— Liljana, po ti?

— E kam edhe unë një djalë, Genci. Së shpejti do të vëmë edhe atë kuadratin në letërnjoftim, — dhe fytyrën ia mbuloi ajo e qeshura e dikurshme, e përmbajtur, por që tani ishte bërë edhe e menduar.

Pasi bëri disa hapa, duke ndier që

Tregimi "Imitimi i një tjetër moshe" është botuar në "Zërin" e Rinisë" më 25 korrik 1987 dhe ka fituar çmim të parë vjetor të gazetës.

unë po e vështroja, u ndal, u kthye në drejtësinë tim dhe si për të ngulitur në mendje një gjë që s'do ta harroja, tha:

— Mos harro për nesër, do t'u them edhe në shtëpi. — Dhe iku ashtu e menduar, e gjatë, e drejtë, e bukur, me atë hapin e ngadaltë, tepër të ngadaltë, ashtu si dymbëdhjetë vjet më parë, kur ne të gjithë thoshim se Liljana i numëronte hapat.

Liljana erdhi në shkollën tonë me vonesë, kur ne kishim një javë që kishim filluar klasën e pestë. Katër vitet e fillores ajo nuk i kishte bërë në fshatin e saj të vogël me njëmbëdhjetë shtëpi, po në Tiranë, te një tezja e vet. Ndoshta nga ky shkak, fillimisht ne u bëmë shumë kureshtarë dhe e ndjemë veten inferiorë ndaj saj. Kuptohet që pozitat tona do të ishin krejt ndryshe sikur ajo të kishte mësuar ato katër vite në fshatin me njëmbëdhjetë shtëpi. Por ja që ajo vinte nga Tirana, dhe Tirana fshihej në përfytyrimin tonë pas një perdeje të magjishme, që asnjëri prej nesh s'kishte mundur ta kalonte deri atëherë. Përveç këtij fakti, Liljana ishte e veshur me rroba të prera më bukur se tonat. Po mbi të gjitha ajo i kishte sytë të kaltër dhe në shkollën tonë, edhe pse bëheshin gati 200 nxënës, asnjëri nuk kishte sy të tillë. I nisur nga ky fakt, Stavri, një shoku ynë i klasës, që përtonte shumë edhe për të folur në mësim, e lidhi ngjyrën e syve të saj me Tiranën.

Liljana ishte vërtet një vajzë e urtë dhe e afërt me të gjithë, kështu që të ne u shkri shumë shpejt ai inferioriteti që ndjemë në fillim për vajzën që kishte mësuar në Tiranë katër vite. Sepse, tekefundit, ajo s'kishte ndonjë ndryshim nga vajzat e tjera të fshatit me njëmbëdhjetë shtëpi.

Ngjarja e pazakontë, që tronditi aq fort marrëdhëniet e saj me

ne, ndodhi në fund të klasës së shtatë. Në klasën e tetë ishte një djalë i zgjuar dhe i hedhur, po disi mendjemadh, karakteristikë e atyre tipave që mësojnë me hope. Quhej Milo dhe ishte nga një fshat i vogël afër fshatit tonë. Tipa të tillë, mbi të gjitha, duan të duken dhe Milos i pëlqente të dukej te vajzat. Kur rastiste, për shembull, që ndonjë ndeshje ta ndiqnin edhe vajzat, ai çohet e ndahej me topin dhe me ne, vetëm e vetëm që të tërhiqte vëmendjen e tyre.

Fjalën që Liljana dashuronte Milon nuk e di kush e hapi, por te ne e solli Ethem i gjatë. Ethem in ne e gjetëm në klasën e shtatë. Ai kishte qenë edhe dy herë përsëritës në klasa të mëparshme dhe ky fakt, së bashku me atë zgjatjen e panatyrshme, ia kishin kyçur mbiemrin e vërtetë në regjistër, ku e përdornin vetëm mësuesit, pasi për ne ishte i pavlefshëm.

Mëngjesin e asaj së Hëne, ne, djemtë e klasës ishim mbledhur grumbull në një cep të oborrit të shkollës dhe, duke pritur rënien e ziles, po diskutonim me zjarr për kampionatin e futbollit. Ethem i gjatë u afrua ngadalë, priti sa u fik biseda për futbollin dhe me një ndjenjë gëzimi, njëlloj si të na thoshte «sot mungon mësuesja e algjibrës», na tha:

«Liljanën e gjetën me Milon.»

Ne të gjithë u stepëm. Pastaj unë iu afrova, e mbërtheva me duar te pjesa e barkut, jo më lart se kërthiza, sepse duart e mia s'mund të ngjiteshin më lart te ai alamet zdapi dhe duke e shkundur me sa fuqi kisha, bërtita:

— Gënjen! Ti je gënjeshtar, Ethem!

“Unë vërtet në mësim nuk ia them, por për të gënjer nuk gënjej, sepse s'jam i vogël,” - tha, duke më shtyrë lehtë, me njëfarë nënvlefësimi dhe bëri të largohej si i fyer.

— Prit, Ethem, — tha Bujari, duke i dalë përpara.

— Po ç'të pres, o derëbardhë, — ju nuk besoni!

— Ku i ke parë ti?

— Ku i ke parë, thotë, lëre, ore, të parën mënjane ti, pse, pak djem jeni ju, që të dashurojë Milon ajo?! E ç'ka Miloja më shumë se ju?

Me këto fjalë Ethem i gjatë na preku në sedër sa s'tuhet dhe asnjëri prej nesh nuk e vazhdoi më bisedën.

Këtë ngjarje e morën vesh edhe vajzat dhe në klasë u dha alarmi. E thirrëm Liljanën, por ajo s'tha asgjë. Bëmë mbledhje pas mbledhjes dhe e pyetëm sa u lodhëm, i thamë ç'mundëm, por ajo vetëm sa ngriej në këmbë dhe rrinte si e ngrirë e gojëkyçur. Hera-herës në sytë e kaltër seç i shkrepse një dritë e keqe, që ishte shumë më e madhe se mëria dhe inati bashkë. Disa herë ajo qau dhe Ethem i gjatë tha se fajtori qan. Nga ana tjetër Miloja na vështronte me ca sy të tillë sikur nga çasti në çast do të na hidhej në grykë. Këto fakte na bindën se të gjitha sa thuheshin duhej të ishin të vërteta.

— T'i themi mësueses kujdestare, — tha Valja, e bindur se me forcat tona ne s'mund ta zgjidhnim dot këtë problem.

— Jo, — tha Bujari, — ne tani jemi të rritur, për një muaj marrim taserën e rinisë dhe mirë është që këtë problem ta zgjidhim vetë.

— Atëherë t'u bëjmë letër prindërve, — tha Taqoja, që fliste shumë rrallë.

— Bëni, po të doni, dhjetë letra ditën, — u hodh menjëherë Ethem i gjatë, — letrat dhe gazetat atje i shpien vetë nxënësit. Ajo ka për ta grisur.

— Po sikur të dërgojmë një delegacion në familje, — tha Gramozi, që s'linte pa përdorur fjalë të mëdha e të vështira edhe në

UNË SHËTISJA NË QYTETIN MESJETAR

Unë shëtisja në qytetin mesjetar në mbrëmje ose në agim.

Isha shumë i ri ose tepër i vjetër.

Nuk kisha orë

apo kalendar, vetëm gjaku im kryeneç

maste hapësirën e pafund.

Unë mund ta filloja jetën, timen

apo jo timen, gjithsesi,

gjithçka dukej e lehtë,

dritaret e apartamenteve ishin pjesërisht hapur,

fate të tjerë ishin krejtësisht hapur.

Ishte pranverë apo verë e hershme,

mure të ngrohta,

ajër i butë si një lëkurë portokalli;

isha shumë i ri ose shumë i vjetër,

unë mund të zgjidhja, unë mund të jetoja.

Adam Zagajewski

ato raste kur nuk ua dinte kuptimin. Sidoqoftë te fjala e fryrë *delegacion* ne e gjetëm më në fund zgjidhjen.

Aty për aty u zgjodh një grup prej pesë vetash, që do të shkonte në shtëpinë e Liljanës. Nga të pesë ne që u zgjodhëm, vetëm Taqoja s'deshi të vinte, ngaqë familja e tij kishte miqësi me pjesën më të madhe të fshatit me njëmbëdhjetë shtëpi. Në vend të Taqos morën Ethemën e gjatë, vetëm ngaqë ishte i rritur dhe të nesërmen, pas mësimit, u nisëm.

Udha na iku ashtu si pa u ndier, por, kur arritëm mbi fshat, te korija e vogël me lisa te rrallë gjunjët na u prenë dhe s'na bëhej të lëviznim më tutje. U ulëm për t'u çlodhur, ngaqë asnjëri nuk e dinte se si do t'ia bënim, Sa e thjeshtë na ishte dukur puna në fillim, aq e vështirë po na bëhej tani. Kush duhej të fliste, kjo pyetje po na mundonte të pesë.

— Unë s'flas dot, — thashë, duke thyer heshtjen e gjatë që na kishte mbërthyer. — S'flas dot, sepse ju e

dini që babai im punon në Sharra dhe babai i saj është drejtor i Sharrave.

— Do të flasë Ethem, — tha Bujari, që në raste të tilla tregohej tepër i shkathët, për t'ua hedhur të tjerëve barren e punëve të vështira.

— Unë?! — Ethem u ngrit i revoltuar, futi duart në xhepat e pantallonave, u dha fort anash si për të treguar se që aty niste kundërshtimi, dhe tha:

— E para, mua s'më takon, sepse s'jam mirë me mësime.

— Atëherë pse erdhe? — iu kthye Bujari.

— Ju vetë më morët dhe, e dyta, ju e dini se unë s'flas dot as nëpër mbledhjet e klasës.

Edhe Gramozi s'mund të fliste për shkak të atyre fjalëve të mëdha e të pakuptimta që përdorte. Kështu që e vetmja zgjidhje mbetej Valja dhe ne të katër vështruam atë.

— Po të më kishit thënë që në mëngjes, do t'i kisha mësuar të gjitha

fjalët dhe flisja, — tha Valja, me njëfarë keqardhjeje, ngaqë tani s'kishte kohë për të mësuar përmendsh asgjë. Pa arritur asnjë përfundim, zbritëm te çezma e madhe mbi fshat. U lamë e u shpëlamë si të shihnim për herë të parë ujë me sy.


— Nisemi, se do të flas unë, — u thashë, ngaqë s'kishte tjetër rrugëdalje, pasi dielli ishte varur shumë poshtë dhe, ashtu siç e kishim nisur, kish rrezik të laheshim deri në darkë. Qëndruam te shkolla dhe thirrëm Sofikën, një shoqe klase nga ky fshat dhe e dërguam të thërriste Liljanën e të ëmën, pasi e dinim që i ati kthehej vonë nga puna. Sofika iku duke kthyer disa herë kokën mbrapa si e trembur dhe ne pritëm në heshtje. Ishte një pritje e mundimshme, torturë e vërtetë. Vetëm Ethem i gjatë rrinte si sheleg, pa asnjëfarë shqetësimi. Më vështirë nga të gjitha e kisha unë, që do të flisja. Ndieja që një vorbull e pazakontë mendimesh më vërtitej në tru, po kjo më acaronte si të isha fare bosh. Sofika u vonua shumë. Ajo erdhi pas pesëmbëdhjetë minutash duke dihatuar si të vinte nga fundi i botës.

— Hë... — e pyetëm me ankth të gjithë, gati njëherësh dhe u çuam në këmbë.

— Nënës së Liljanës i ra të fiktë. Liljana s'është... s'ka ardhur fare... — dhe, duke ia shkrepur të qarit, tregoi me dorë përroin e madh poshtë fshatit, që i thërritnin lumë.

Në fillim ne ngrimë, pastaj vështruam njëri-tjetrin si të zgjoheshim nga një ëndërr e keqe, ku ankthi e lë kujtesën pa funksion. Dhe të tjetërsuar, si të mos kishim qenë ne të pak çasteve më parë, u lëshuam poshtë kodrës për të gjetur Liljanën. Prapa nesh mbeti si i mbjellë ai trupi hollak si i pleptë i Ethemit të gjatë, që s'dinte ku të shkonte...

Vladislav Bajac Kronikë me dyshime



KRONIKË ME DYSHIME është një rrëfenjë mjaft e gjallë, që buron nga bindja se e gjithë letërsia dhe poezia jonë duhet dokumentuar në një vend. Aty ka një zinxhir faktesh të ndërthurura, që tregojnë se si i shkoj filli një familjeje të veçantë dhe pastaj, një vendi të zhdukur. Vladislav Bajaci na tregon një histori të rritjes, pjekurisë dhe rënies, të shembjes së një bote dhe pikave të saj kulmore, të muzikës dhe ritmeve të një epoke, të gabimeve të mëdha dhe shkatërruese të baballarëve, si edhe dështimin e thellë të bijve të tyre, për të kuptuar se si bota e prindërve të tyre përplasej në veshët e tyre. Kronikë me dyshime është "Bota e djeshme" e Bajacit, përveç se Bajaci nuk është Stefan Cvajgu dhe as Jugosllavia nuk është Perandoria Austriake. Ndryshe nga Cvajgu, iluzionet e atyre që jetojnë atje mbeten lokale, por çdo copëz është material letërsie dhe tragjedi. Përtej iluzioneve, siç na tregon Bajaci, është jehona e poetit të varfër: "Gabimet këndojnë këngët më të bukura" është motoja e padukshme e librit Kronikë me dyshime.

Por le të jemi të qartë: ky nuk është një leksik tjetër familjar për jugo-nostalgjinë, por krejt e kundërta. Shkrimtari bën çdo përpjekje për të mos rënë në grackën e sentimentalizmit, për ta shpëtuar veten duke shpëtuar rrëfimin e tij. E pakta që duhet thënë është se ai krijon struktura që janë të pazakonshme. Me personazhin kryesor, që quhet "Personi" (autori flet në vetën e tretë për vete) ai shfrytëzon të gjitha mundësitë që i jep gramatika serbe. Kronikë me dyshime ka një aromë unike dhe befasuese. Aty ka dhimbje, por edhe gëzim.

Miljenko Jergovic



NEW ISSUE **OUT NOW**



ALBANIAN INSTITUTE FOR
INTERNATIONAL STUDIES

www.tiranaobservatory.com